



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Krujë

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

të ushtruar në

BASHKINË KRUIJË

Tiranë, 2023

PËRMBAJTJA

SHKURTIME.....	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	21
II. HYRJE.....	24
1. Objekti i Auditimit.....	24
2. Qëllimi i auditimit.....	24
3. Identifikimi i çështjes.....	24
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	24
5. Përgjegjësitë e audituesve	25
6. Kriteret e vlerësimit	25
7. Standardet e auditimit	27
8. Metodatat e auditimit	28
9. Dokumentimi i auditimit.....	29
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	30
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Krujë.....	30
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	31
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	31
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	41
2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.....	54
2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	76
2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.....	115
2.6. Mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).....	120
2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	122
2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit	126
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	127
A. MASA ORGANIZATIVE.....	127
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI	141
C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR	142
V. ANEKSET	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.....	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi Njësinë e Auditimit të Brendshëm	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi pasqyrat financiare	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi prokurimet publike.....	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi Lejet e Ndërtimit	Error! Bookmark not defined.
Aneksi mbi zbatimin e rekomandimeve.....	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit	Error! Bookmark not defined.

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga audit i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Krujë dhe Ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230-231 “investime”, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Krujë nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022, etj.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 11 Akte Konstatimi dhe 2 Akte Verifikimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 3,779,616 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 2,374,876 mijë lekë, ose në masën 63%.</p> <p>Vlera e mosrealizimit në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë, tregon se planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale;</p> <p>Nga ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2022, rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor; <p>Kryetari i Bashkisë Krujë për vitin 2022.uk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.</p>	<i>Pika 2.2., faqe 41-55</i>	E lartë	Bashkia Krujë të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda afateve, të dokumentoj se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.
2	<p>Nga analizimi rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE, rakordohet me degën e thesarit për vlerën 17,602,310 lekë, por nuk përputhet me vlerën e në dokumentet analitike që bashkia disponon nuk rakordon as në total as sipas zërave specifik dhe rezulton që detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 të jenë në vlerën 31,581,206 lekë.</p>	<i>Pika 2.2., faqe 41-55</i>	E lartë	Bashkia Krujë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
3	Për vitin 2022 rezultojnë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore në vlerë 652,160 lekë, si dhe Bashkia Krujë në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese.	<i>Pika 2.2., faqe 41-55</i>	E lartë	Bashkia Krujë, Drejtoria e Financës dhe Sektori i Buxhetit të hartojë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojë me rigorozitet radhën e regjistrimit të tyre në bashki kur të kryejë likuidimet e tyre.
4	<p>Bashkia Krujë ka lidhur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 24 akt marrëveshje për vitin 2022 për të ndihmuar subjektet debitore në likuidimin e detyrimeve me këste për vitin 2022, 19 subjekte dhe familje debitore i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes dhe nuk i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes 5 prej tyre. - Si dhe akt marrëveshje të lidhura në vitin 2021 me afat deri në vitin 2022, ga të cilat 10 subjekte dhe familje debitorë prej këtyre akt marrëveshjeve nuk i kanë zbatuar kushtet e kontratës. <p>Nga auditimi i dokumentacionit dhe i akt marrëveshjeve për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se ka mangësi nga ana e DTTV në lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste, përkatësisht;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në dy rast rezulton se, afati i aktmarrëveshjes është lidhur për një periudhë prej 24 mujore por afati nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës, pas momentit të hartimit të marrëveshjes; <p>Nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 2, 3, 4, 5.</p>	<i>Pika 2.2., faqe 41-55</i>	E lartë	Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë, gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë, të marrë masat që këto akt marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtare si dhe të plotësojnë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste.
5	<p>Nga auditimi, u konstatua se:</p> <p>1. Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 22,672,572 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 31,836,370 lekë, me një rritje në vlerën 9,163,798 lekë. Nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se automjetet në vlerën 61,161,138 lekë, sipas Aneksit PF17 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, nuk janë mjete transporti, por makineri, të cilat duhet të regjistrohen në llogarinë përkatëse, 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”. Rrjedhimisht, llogaritë 215 “Mjete transporti” dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, nuk paraqesin vlerën reale në bilanc.</p> <p>2. Nga auditimi dhe testimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, u konstatua se në regjistrat/librat e kontabilitetit të këtyre llogarive, për një pjesë të konsiderueshme të zërave nuk është pasqyruar vlera fillestare e aktiveve, por vetëm vlera e shpenzimeve</p>	<i>Pika 2.3., faqe 55-76</i>	E lartë	<p>1. Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p> <p>2. Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot,</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>të mëpasshme, për rikonstruksione ose përmirësimin e gjendjes së këtyre aktiveve. Kryesisht, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Gjithashtu, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p> <p>3. Për llogaritë 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, nga Bashkia Krujë nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së asetëve. Nga ana e Drejtorisë së Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Fakti që nuk ka një regjistër kontabël për të gjitha AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.</p>			<p>si dhe saktësimin e asetëve të inventarizuara, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë vlera fillestare dhe kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës, sipas rastit.</p>
6	<p>Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Krujë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë “I. S.H.A.”, me NUIS L.....M e cila është shoqëri aksionare me objekt “Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit, etj.”. Numri i aksioneve është 2,000 me vlerë nominale 1,750 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 3,500,000 lekë. 	Pika 2.3., faqe 55-76	E lartë	<p>Nga Bashkia Krujë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të regjistruar dhe sistemuar në kontabilitet, në aktivitet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2023, konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapital e veta”, për vlerën totale 198,048,332 lekë shoqëritë:</p> <p>1. “I. S.H.A.”, me NUIS L....M, për 100% të aksioneve, gjithsej 2,000 aksione, me vlerë nominale 1,750 lekë/aksion, me vlerë totale 3,500,000 lekë;</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>- Aksionare me 3,45% të aksioneve të shoqërisë “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës S.H.A.”, me NUIS M.....M e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij, etj.”. Numri i aksioneve është 100,000 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 10,000,000 lekë. Pjesa takuese e Bashkisë Krujë është 3,448 aksione, në vlerën totale 344,800 lekë.</p> <p>- Aksionare me 25% të aksioneve të shoqërisë “Klubi Sportiv K. S.H.A.”, me NUIS L.....V e cila është shoqëri aksionare me objekt “Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit, etj.”. Numri i aksioneve është 2,000 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 2,000,000 lekë. Pjesa takuese e Bashkisë Krujë është 500 aksione, në vlerën totale 500,000 lekë.</p> <p>- Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Krujë S.H.A.”, me NUIS J.....J e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij, etj.”. Numri i aksioneve është 1 me vlerë nominale 193,703,532 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 193,703,532 lekë. Këto vlera nuk janë paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2022, konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”.</p> <p>Për sa më sipër, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” nuk paraqet vlerën reale për shumën 198,048,332 lekë (3,500,000 lekë nga shoqëria “I. S.H.A.”; 344,800 lekë nga shoqëria “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës S.H.A.”, 500,000 lekë nga shoqëria “Klubi Sportiv K. S.H.A.” dhe 193,703,532 lekë nga shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Krujë S.H.A.”.</p>			<p>2. “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës S.H.A.”, me NUIS M.....M, për 3.45% të aksioneve, gjithsej 3,448 aksione, me vlerë nominale 100 lekë/aksion, me vlerë përkatëse 344,800 lekë;</p> <p>3. “Klubi Sportiv K. S.H.A.”, me NUIS L.....V, për 25% të aksioneve, gjithsej 500 aksione, me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, me vlerë përkatëse 500,000 lekë.</p> <p>4. “Ujësjellës Kanalizime Krujë S.H.A.”, me NUIS J.....J, për 100% të aksioneve, gjithsej 1 aksion, me vlerë nominale 193,703,532 lekë/aksion me vlerë totale 193,703,532 lekë.</p>
7	<p>Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2022 paraqitet përkatësisht 0 lekë për llog. 230 dhe 1,542,248,174 lekë për llog. 231, në total 1,542,248,174 lekë.</p> <p>Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2022 ka qenë 1,081,941,366 lekë, nga të cilat 741,265,068 lekë me fonde të deleguara dhe 340,676,298 lekë nga të ardhurat e veta. Vlera e kontraktuar (me Tvsh), për investimet në proces gjatë vitit 2022 ka qenë 991,766,258 lekë, nga të cilat 734,813,881 lekë me fonde të deleguara dhe 256,952,377 lekë nga të ardhurat e veta. Planifikimi total për vitin 2022 ka qenë 1,130,166,929 lekë, nga i cili 762,623,413 lekë me fonde të deleguara, me realizim në vlerën 732,291,956 lekë dhe</p>	Pika 2.3., faqe 55-76	E lartë	Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë, të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>367,543,516 lekë nga të ardhurat e veta, me realizim në vlerën 179,765,285 lekë.</p> <p>Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2022. uk paraqet vlerën reale, e cila duhet të përmbante shumën e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Krujë.</p>			
8	<p>Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 44,656,180 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 79,488,357 lekë ose me rritje në vlerën 34,832,177 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Në mënyrë analitike, Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në fund të vitit 2022 është paraqitur në Aneksin PF28, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.</p>	<p>Pika 2.3., faqe 55-76</p>	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Krujë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejohet likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.</p>
9	<p>Për vitin 2022, janë planifikuar investime të reja në buxhet në vlerën 234,590,210 dhe investime nga vitet e mëparshme në vlerën 105,704,476 lekë. Gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 94,838,015 lekë nga investimet e mbartura dhe vlera 65,101,398 lekë nga investimet e vitit. Në total janë likuiduar 159,939,413 lekë.</p> <p>Me fonde Buxhetore kanë qenë gjithsej 3 objekte, në vlerën totale 103,699,945 lekë të likuiduar gjatë vitit 2022. Nga fondet e rindertimit janë 5 objekte, në vlerën totale të likuiduar 615,692,179 lekë.</p> <p>Për vitin 2022 janë lidhur 87 kontrata, në vlerën totale 991,766,258 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR, etj.</p> <p>Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave.</p>	<p>Pika 2.3., faqe 55-76</p>	E lartë	<p>Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.</p> <p>Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.</p> <p>Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2022 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t'u përdorur”. Kontratat e lidhura për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin PF39, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.</p> <p>Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 32.</p>			<p><i>investime</i>” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.</p> <p>Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t'u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.</p> <p>Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.</p> <p>Me kapitalizmin e aktivitetit, (për aktivitetin e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t'u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.</p>
10	<p>1. Nga auditimi i 18 procedurave të prokurimit publik për vitin 2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 16 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat janë devijime nga përcaktimi në legjislacionin për prokurimin publik ose nuk janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76, pika 2, neni 77, pika 4, neni 82, pika 2 dhe pika 5, germa a), neni 89, pika 1, neni 92, pika 3, neni 98, pika 1, germa a) dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pikat 1 dhe 3, neni 74, pika 3, germa gj), neni 79, pika 3 dhe neni 82, pika 2.</p> <p>2. Në të gjitha rastet e audituara, u konstatua se një pjesë e procesverbaleve dhe Dokumentet e Tenderit</p>	Pika 2.4., faqe 76-116	E lartë	<p>1. Kryetari i Bashkisë Krujë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.</p> <p>2. Kryetari i Bashkisë Krujë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Krujë dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	nuk janë protokolluar në protokollin e Bashkisë Krujë.			
11	<p>Nga auditimi i 18 procedurave të prokurimit publik për vitin 2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 3 raste u konstatua se OE të shpallur fitues kanë pasur devijime të vogla nga kriteret e përcaktuara në DT, devijime të cilat nuk janë listuar në Raportet Përmbledhëse përkatëse dhe në 8 raste u konstatua se OE janë shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në DT, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76, pika 2, neni 77, pika 4, neni 82, pika 2 dhe pika 5, germa a), neni 89, pika 1, neni 92, pika 3, neni 98, pika 1, germa a) dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pikat 1 dhe 3, neni 74, pika 3, germa gj), neni 79, pika 3 dhe neni 82, pika 2.</p>	Pika 2.4., faqe 76-116	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Krujë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.</p>
12	<p>1. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 4159 prot., datë 06.07.2022, me objekt “Shërbim i pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane për qytetin Fushë Krujë”, të lidhur me OE R. SHPK, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raportimet: Kontraktori nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi, në mospërputhje me kontratën, neni 13, pika 1 dhe pika 2. - Edukimi ambiental: Kontraktori nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik, të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike, si dhe nuk ka kryer programin e edukimit ambiental nëpërmjet një spoti televiziv një herë në 6 muaj, në mospërputhje me kontratën, neni 18, pika 1 dhe pika 2. Në kushtet e mosrealizimit të programeve të edukimit publik dhe ambiental, nga mbikëqyrësi nuk janë aplikuar penalitetet ndaj kontraktorit, në mospërputhje me kontratën, neni 28. - Moskryerja e zërit të punimeve: Sipas procesverbalit të datës 31.08.2022, të mbajtur nga grupi për monitorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit për qytetin e Fushë-Krujës, është konstatuar moskryerja e zërit të punimeve “grumbullim e ngarkim në mjet mbetje inerte barishte dhe transport mbetje inerte, barishte, materiale të ngurta”. Sasia e planifikuar e këtyre mbetjeve është në sasinë 91.25 ton, Këto veprime janë në mospërputhje me kontratën, neni 10, pika 1. - Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit: Grupi i punës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratës së pastrimit në qytetin e Fushë-Krujës, si dhe OE mbikëqyrës, nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratë, 	Pika 2.4., faqe 76-116	E lartë	<p>1. Grupet e punës të ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave të pastrimit dhe OE mbikëqyrës, të marrin masa për rritjen e kërkesës së llogarisë për detyrimet që kanë OE sipërmarrës, në lidhje me pasqyrimin me përpikëri të përmbushjes së specifikimeve të kontratës në të gjitha elementet, pa përjashtim.</p> <p>2. Grupet e punës të ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave të pastrimit dhe OE mbikëqyrës, të marrin masa për mbikëqyrjen ditore të shërbimit të pastrimit duke pasqyruar në akt kontrollat përkatëse të gjithë elementet e kontratës, si dhe të japin vlerësimet përkatëse për përmbushjen e metodologjive të aplikuara si dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.</p> <p>3. Bashkia Krujë të marrë masa duke aplikuar gjobat përkatëse në raport me llojin e detyrimeve kontraktuale të papërmbushura nga OE R. SHPK për qytetin Fushë Krujë dhe BOE D. SHPK & S. SHPK për qytetin Krujë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>neni 22, pikat 2, 5 dhe 6.</p> <p>2. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 2208 Prot., datë 15.04.2022, me objekt “<i>Shërbim i pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane për qytetin Krujë</i>”, të lidhur me BOE D. SHPK & S. SHPK,</p> <p>- Raportimet: Kontraktori nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi në mospërputhje me kontratën, neni 13, pika 1 dhe pika 2.</p> <p>- Edukimi ambiental: Kontraktori nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike, si dhe nuk ka kryer as programin e edukimit ambiental, i cili duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj, në mospërputhje me kontratën, neni 18, pikat 1 dhe 2.</p> <p>- Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit: Grupi i punës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratës së pastrimit në qytetin e Krujës, si dhe OE mbikëqyrës, nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratë, neni 28, germa f.</p>			
13	<p>Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve për kontratat:</p> <p>- “<i>Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë</i>”,</p> <p>- “<i>Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë</i>”.</p> <p>- “<i>Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë</i>”,</p> <p>rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë, nuk ka kryer oponentin teknike për investimet për objektet e mësipërme.</p>	<p><i>Pika 2.4., faqe 76-116</i></p>	E lartë	<p>Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Oponentin Teknike për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.</p>
14	<p>Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve për kontratat:</p> <p>- “<i>Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë</i>”,</p> <p>- “<i>Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë</i>”,</p> <p>- “<i>Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë</i>”,</p> <p>rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë, nuk ka dhënë Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit.</p>	<p><i>Pika 2.4., faqe 76-116</i></p>	E lartë	<p>Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Leje Ndërtimore Infrastrukturore për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.</p>
15	<p>Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve për kontratat:</p> <p>- “<i>Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë</i>”,</p>	<p><i>Pika 2.4., faqe 76-116</i></p>	E lartë	<p>Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Leje Ndërtimore Infrastrukturore për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>- “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”,</p> <p>- “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”,</p> <p>rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë, nuk ka dhënë Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit.</p>			
16	<p>Nga shqyrtimi i procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes për vitin 2022, rezultoi se nga IMTV, për këto 35 Procesverbale për konstatimin e kundërvajtjes nuk është zbatuar kuadri ligjor, përkatësisht për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procesverbal nr. 120, datë 14.02.2022, subjekti “K.K.” për kundërvajtjen “Brez betoni në afërsi të banesës së shtëpisë” nuk është marrë asnjë masë tjetër; 2. Procesverbal nr. 125, datë 18.03.2022, subjekti “E.S.” për kundërvajtjen “Platformë me strukturë druri” nuk është marrë asnjë masë tjetër; 3. Procesverbal nr. 126, datë 22.03.2022, subjekti “I.T.” për kundërvajtjen “Hapje kanali me efekt shtrirje rrjeti interneti” nuk është marrë asnjë masë tjetër; 4. Procesverbal nr. 127, datë 23.03.2022, subjekti “M.M.” për kundërvajtjen “Rrethim me shufra betoni dhe rrjet teli” nuk është marrë asnjë masë tjetër; 5. Procesverbal nr. 128, datë 23.03.2022, subjekti “Gj.N.” për kundërvajtjen “Shtyllë Druri në pjesën e rrugës së fshatit” nuk është marrë asnjë masë tjetër; 6. Procesverbal nr. 135, datë 15.08.2022, për kundërvajtjen “Konstruksion metalik me panele sanduiç”, është marrë masa prishje objekti me nr. 81, datë 25.08.2022 dhe nuk është marrë masë për gjobë. 	Pika 2.6., faqe 120-122	E mesme	IMTV të vlerësojë me saktësi kundërvajtjet e konstatuara gjatë kontrolleve në terren dhe të sigurohet që në vazhdimësi të aplikojë masën e duhur të gjobës në përputhje me llojin e kundërvajtjes së identifikuar.
17	<p>Nga auditimi, u konstatua se për periudhën në auditim nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë nga gjobat e vendosura nga IMTV. Për gjobat e vendosura në vitin 2022, të cilat nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV ka njoftuar subjektet kundërvajtës me shkresat përkatëse, por nuk ka bërë kërkesë për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, për 12 masa për gjobë.</p>	Pika 2.6., faqe 120-122	E lartë	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave dhe nxjerrjen e titujve ekzekutiv për gjobat e vendosura.
18	<p>Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara</p>	Pika 2.7., faqe 122-126	E lartë	Kryetari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 259/7 Prot, datë 27.07.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara.</p> <p>Bashkia Krujë ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:</p> <p>a. Janë lënë 25 Rekomandime për “<i>Masa Organizative</i>”, të cilat janë pranuar nga subjekti, për të cilat rikërkohet zbatimi për 2 masa të zbatuara pjesërisht, për 1 masë në proces zbatimi dhe për 12 masa të cilat nuk janë zbatuar;</p> <p>b. Janë lënë 4 rekomandime në vlerën totale 957,860 lekë për “<i>Masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara</i>”, të cilat janë pranuar nga subjekti dhe mbeten për t’u zbatuar, pasi deri tani janë zbatuar 2 masa, në vlerën 674,856 lekë dhe janë në proces zbatimi 2 masa, në vlerën 283,004 lekë.</p> <p>c. Janë lënë 5 Rekomandime për “<i>Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia</i>”, për të cilat rikërkohet zbatimi për 1 masë të pazbatuar, 2 masa në proces zbatimi, 1 masë e zbatuar pjesërisht.</p>			<p>marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e masave të pazbatuara dhe ato pjesërisht të zbatuara gjithashtu të përshpejtojë zbatimin e masave në proces si më poshtë:</p> <p>A. MASA ORGANIZATIVE:</p> <p>1.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat në mënyrë që, temat më problematike që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik dhe të dokumentohen takimet e realizuara nga GMS dhe vendimet e marra për diskutimet përkatëse.</p> <p style="text-align: right;"><i>Brenda vitit 2023</i></p> <p>2.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa që në pozicionin e specialistit të NjAB, të punësohet një person që përmbush kriteret për të qenë pjesë e kësaj strukture dhe mundëson funksionimin e auditit të brendshëm në mënyrë efektive.</p> <p style="text-align: right;"><i>Menjëherë dhe në vijimësi</i></p> <p>3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucione të tjera vendore përkatëse me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.</p> <p style="text-align: right;"><i>Menjëherë dhe në vijimësi</i></p> <p>4.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të marrë masat të ngrejë një grup pune për të identifikuar të gjithë familjet që duhet të paguajnë detyrimet e bashkisë lidhur me taksat dhe tarifatat familjare.</p> <p style="text-align: right;"><i>Menjëherë dhe në vijimësi</i></p> <p>5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë gjatë hartimit të akt-marrëveshjeve me subjektet debitorë të marrë masat që këto akt- marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				<p>formën e dokumenteve zyrtarë si dhe të plotësoje dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimeve me këste.</p> <p><i>Menjëherë dhe në vijimësi</i></p> <p>6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë të ngrejë një grup pune për të verifikuar dokumentacionin në dosjet e përfituesve të granteve të rikonstruksionit DS1/DS2/DS3 dhe përfituesve të bonusit të qirasë si dhe të bëhet plotësimi i këtyre dosjeve kur është e mundur.</p> <p><i>Menjëherë</i></p> <p>7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sisternimit kontabël e gjendjes së llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në fund të vitit 2021 të paraqitur gabim, duke përfshirë në mënyrë të saktë vlerat e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit dhe në rakordim me gjendjen në llog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.</p> <p><i>Deri më 31.12.2023</i></p> <p>8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për llogaritjen e amortizimit të aktiveve jo materiale dhe kryerjen e veprimeve kontabël të sistemimit për shpërndarjen e vlerës të studimeve-projektiveve, sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe duke debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plote.</p> <p><i>Deri më 31.12.2023</i></p> <p>9.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese, Bashkia Krujë të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialistë të fushës dhe të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione”. Për aktivet “Ndërtesa e konstruksione NJA</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				<p>Thumanë” në vlerën 104,595,727 lekë dhe për aktivet “Ndërtime para vitit 2001 NjA Fushë Krujë” në vlerën 27,146,269 lekë nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-komuna Thumanë dhe ish-Bashkia Fushë Krujë për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite dhe për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilanc e në rast pasaktësish të behën sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p> <p style="text-align: right;"><i>Deri më 31.12.2023</i></p> <p>10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.</p> <p style="text-align: right;"><i>Deri më 31.12.2023</i></p> <p>11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të marrë masa që në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 të kryejë veprimet kontabël përkatëse për pasqyrimin në PF të investimeve në vlerën 4,000,000 lekë të kryera në vitet e mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në Sha “Klubi Sportiv K.” për vlerën 500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 25% të aksioneve dhe Sha “I. (Klubi i Futbollit Fushë- Krujë)” për vlerën 3,500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve.</p> <p style="text-align: right;"><i>Deri më 31.12.2023</i></p> <p>12.1. Rekomandimi: Në të ardhmen mbikëqyrësi i zbatimit të kontratës të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë për detyrimet që ka OE si dhe pasqyrimin me përpikmëri të përmbushjes së përcaktimeve të kontratës në çdo element të saj, pa anashkaluar ato detyrime që duken të një rëndësie më të ulët.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				<p><i>Menjëherë dhe në vijimësi</i></p> <p>13.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE “D.” ShPK dhe “F.” ShPK për moszbatimin e kushteve të kontratave të pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.</p> <p><i>Menjëherë</i></p> <p>14.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE “R.” dhe “L.” për mos përmbushjen e kushteve të kontratës së pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.</p> <p><i>Menjëherë</i></p> <p><u>C. MASA PER ULJEN E BORXHIT TATIMOR PER TE RRRITUR PERFORMANCEN NE ARKETIMIN E DETYRIMEVE PER TATIM TAKSAT VENDORE, PERFESHIRE DHE DETYRIMET NGA QIRADHENIA (TE ARDHURA TE MUNGUARA).</u></p> <p>1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 614,535,969 lekë nga taksapaguesit privat dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhrat përkates për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitore. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgoje listën e subjekteve debitore të plote dhe të sakte pranë Drejtorisë së Financës.</p> <p><i>Menjëherë dhe në vijimësi</i></p> <p>2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pajisur me autorizimin përkates të pajisen menjëhere me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 7,166,460 lekë ndaj Bashkisë Krujë.</p> <p><i>Menjëherë dhe në vijimësi</i></p>
19	Nga auditimi i kërkesës së z. S.M., datë 24.04.2023, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 391 prot., datë 24.04.2023, për zbatimin e Vendimit nr. 42, datë 27.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, ku ka fituar të drejtën e pagës nga data 01.03.2017, kur është larguar nga puna, deri në rikthimin në detyrë, u konstatua se ky detyrim i	Pika 2.8., faqe 126-127	E lartë	Nga Bashkia Krujë të kontabilizohet menjëherë detyrimi ndaj z. S.M., si dhe të fillojë shlyerja e plotë e detyrimit.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Bashkisë Krujë nuk është kontabilizuar dhe nuk ka filluar të bëhet pagesa.</p> <p>1. Z. S.M. ka bashkëlidhur ankesës kopje të Vendimit të Gjykatës Administrative, i cili është i formës së prerë;</p> <p>2. Nga Bashkia Krujë është pranuar njohja me Vendimin nr. 42 datë 27.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe është argumentuar mosfillimi i pagesës.</p>			
20	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”, me vlerë 16,638,481.20 lekë me TVSH, fituar nga OE “S.U.” SHPK, rezultuan punë të pakryera për zërin e punimeve: “Zëri 7. Shtresë stabilizanti (banikë) t=10cm”, në vlerën 147,330 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2044 prot., datë 21.09.2022 të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe OE “S.U.” SHPK.</p>	<p><i>Pika 2.4., faqe 76-116</i></p>	E lartë	<p>Bashkia Krujë të arkëtojë vlerën prej 147,330 lekë pa TVSh nga shoqëria OE “S.U.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 2044 prot., datë 21.09.2022, me objekt “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”.</p>
21	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”, me vlerë 11,201,052 lekë me TVSh, fituar nga BOE “K.D.” ShPK & “V.” ShPK, rezultuan punë të pakryera për zërat e punimeve: “Gërmim dheu kanal, ekskavator me zinxhir, dhe shkarkim në mjet”; “Transport dheu në distancë 1 km”; “Shtresë stabilizanti (banikë), t=10cm”; “Shtresë binderi, t=5 cm, gur zalli makineri”; “Shtresë asfaltobetoni, t=4 cm, gur zalli makineri”, në vlerën 154,320 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6115 prot., datë 21.09.2022 të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe BOE “K.D.” ShPK & “V.” ShPK.</p>	<p><i>Pika 2.4., faqe 76-116</i></p>	E lartë	<p>Bashkia Krujë të arkëtojë vlerën prej 154,320 lekë pa TVSh nga BOE “K.D.” SHPK & “V.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 6115 prot., datë 21.09.2022, me objekt “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”.</p>
22	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”, me vlerë 21,122,391.52 lekë me TVSH, fituar nga OE “B.” SHPK, rezultuan punë të pakryera për zërat e punimeve: “Mbushje me çakëll makinerie, me makineri”, në vlerën 154,320 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 6145 prot., datë 21.09.2022, të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe OE “B.” SHPK.</p>	<p><i>Pika 2.4., faqe 76-116</i></p>	E lartë	<p>Bashkia Krujë të arkëtojë vlerën prej 154,320 lekë pa TVSh nga shoqëria OE “B.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës Nr. 6145 prot., datë 21.09.2022, me objekt “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”.</p>
23	<p>Nga pagesat që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se, për vitin 2022.uk ka debitorë por detyrimet e viteve të mëparshme janë në vlerë</p>	<p><i>Pika 2.2., faqe 41-55</i></p>	E lartë	<p>Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	63,700,015 dhe në vitin 2022 është paguar vlera 110,210 lekë, vlera e mbetur vazhdon të jetë detyrim që përbën në total 63,589,805 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë.			<i>për legalizimet</i> ” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë 63,589,805 lekë .
24	Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Krujë u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 35 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Nga këto nuk kanë paguar disa subjekte vullnetarisht me vlerë totale të gjobave të vendosura për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 është 7,450,000 lekë. Pra për vitin 2022 të ardhurat e munguara nga mosarkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 7,450,000 lekë.	<i>Pika 2.2., faqe 41-55</i>	E lartë	IMTV dhe Drejtoria e të Ardhurave në Bashkisë Krujë të ndjekin të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 7,450,000 lekë .
25	Rezultoni se nga Bashkia Krujë në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve (bizneseve) është në vlerën 83,003,806 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 613,515,626 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerë 63,589,805 lekë, debitorët familjarë janë në vlerë 109,356,149 lekë, duke rezultuar në total me vlerën e borxhit tatimor 786,461,580 lekë. Gjithashtu, Bashkia Krujë nuk ka të dhëna për numrin e familjeve debitore për periudhën objekt auditimi si dhe nuk ka dokumente analitike ku të jenë paraqitur zërat sipas taksave dhe tarifave dhe numrit të familjeve për taksat dhe tarifatat familjare. Nga Bashkia Krujë pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2022, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë.	<i>Pika 2.2., faqe 41-55</i>	E lartë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 786,461,580 lekë nga taksapaguesit privatë dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatës për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitorë. 2. Bashkia Krujë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të marrë masat për të ngritur një grup pune i cili të identifikojë të gjithë familjarët që paguajnë detyrimet e bashkisë lidhur me taksat dhe tarifatat familjare.
26	Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 28 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 37 pika karburanti), nga të cilat 14 subjekte për 19 pika karburanti janë të autorizuar dhe kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore dhe për 18 pika karburanti janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale 3,341,364 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë.	<i>Pika 2.2., faqe 41-55</i>	E lartë	Drejtorja e Tatim Taksave Vendore të marrë masa që subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet të papajisur me autorizimin përkatës, të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën 3,341,364 lekë ndaj Bashkisë Krujë.
27	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit si më poshtë, u konstatua se, janë lëshuar në mungesë të dokumenteve, pasi nuk është kryer bashkërendimi me institucionet, për lejet e mëposhtme:	<i>Pika 2.5., faqe 116-120</i>	E mesme	Bashkia Krujë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrin masa për miratimin e Lejeve të Ndërtimit për projektet e zbatimit për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, duke plotësuar të gjithë

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>1. “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, me nr. 8319 prot., datë 06.12.2021, e cila është miratuar me Vendimin nr. 1, datë 07.01.2022 për “Hotel 4 Kat + podrum”,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vërtetim nga Instituti i Ndërtimit, - Vërtetim nga Instituti Sizmologjik, - Në mungesë të Oponencës Teknike, - Në mungesë të preventivit të detajuar në mënyrë të saktë, - Vërtetim që subjekti ndërtues “P.” SHPK ka shlyer taksat dhe tarifat vendore, - Vërtetim që subjekti ndërtues “P.” SHPK nuk ka detyrime të papaguara, - Vërtetim që zhvilluesi z. Xh.Rr. nuk ka detyrime të papaguara, <p>2. “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, me nr. 3875 prot., datë 26.06.2022, e cila është miratuar me Vendimin nr. 265/1, datë 22.09.2022, për “Strukturë 1-2 kat, për magazinim dhe tregtim të bojërave plastike”:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vërtetim nga Instituti i Ndërtimit, - Vërtetim nga Instituti Sizmologjik, - Në mungesë të Oponenca Teknike, - Vërtetim që subjekti ndërtues “K.D.” SHPK ka shlyer taksat dhe tarifat vendore, - Vërtetim që subjekti ndërtues “K.D.” SHPK nuk ka detyrime të papaguara - Vërtetim që zhvilluesi bashkëpronarët S.nuk ka detyrime të papaguara. 			dokumentacionin teniko-ligjor, sipas legjislacionit në fuqi.
28	<p>1. Në Bashkinë Krujë nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.</p> <p>2. Kordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është caktuar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve”, pika 1.2.</p> <p>3. Për vitin 2022 Bashkia Krujë nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3 “Aktivitetet e Kontrollit”.</p> <p>4. Bashkia Krujë nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim</p>	Pika 2.1., faqe 31-41	E mesme	<p>1. Nga Kryetari i Bashkisë Krujë të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së auditimit, për hartimin e programeve të trajnimit zhvillimit profesional të stafit dhe një procedure për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizimin e tyre.</p> <p>2. Nga Kryetari i Bashkisë Krujë të merren masa për të caktuar Nënpunësin Zbatues si Koordinator të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ” i ndryshuar, neni 4, pika 20.			
29	<p>Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë të Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Krujë, për vitin 2022, u konstatua se:</p> <p>1. Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.2 “<i>Plani vjetor i Auditimit</i>”, që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Plani vjetor duhet përgatitur duke marrë në konsideratë Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016 Kap III, Formatin Standard nr. 5, “<i>Hartimi i planit strategjik dhe vjetor të NjAB</i>”.</p> <p>2. Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.1 “<i>Planifikimi strategjik</i>” që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Planifikimi strategjik duhet të kryhet duhet përgatitur duke marrë në konsideratë Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016 Kap III, Formatin Standard nr. 5, “<i>Hartimi i planit strategjik dhe vjetor të NjAB</i>”.</p> <p>3. Rekrutimi i punonjësve është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “<i>Për auditimin e brendshëm në sektorin publik</i>”, neni 11, pika 2, shkronjat “b” dhe “c”. Struktura e NJAB funksionon me 3 punonjës.</p>	Pika 2.1., faqe 31-41	E mesme	<p>1. Nga NJAB të merren masa që Plani Vjetor dhe Plani Strategjik për vitin 2023 të jenë në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016, Kapitulli III, Formatin Standard nr. 5, “<i>Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NjAB</i>”.</p> <p>2. Bashkia Krujë të marrë masa që 3 punonjësit në NjAB të kryejnë çertifikimin si Auditues të Brendshëm, në mënyrë që struktura e NjAB të funksionoj në mënyrë efektive.</p>
30	Për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Krujë nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik. Ky veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “ <i>Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024</i> ”, kreu I, pika 13.	Pika 2.2., faqe 41-55	E mesme	Krujë të marrë masa të publikojë në faqen zyrtare Projekt Buxhetin Afatmesëm 2022-2024 sipas kërkesës së Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “ <i>Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024</i> ”.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinion i Modifikuar (Kualifikuar) mbi Pasqyrat Financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të Bashkisë Krujë, për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i primeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

*Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **modifikuar/kualifikuar** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Krujë, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2022, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).*

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik” apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 “Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare, Udhëzues për SAI-n”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **48,682,045** lekë për shpenzimet dhe **60,847,470** lekë për të ardhurat, sipas Aneksit PF1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

1. Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 22,672,572 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 31,836,370 lekë, me një rritje në vlerën 9,163,798 lekë. Nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se automjetet në vlerën 61,161,138 lekë, sipas Aneksit PF17 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nuk janë mjete transporti, por makineri, të cilat duhet të regjistrohen në llogarinë përkatëse, 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”. Rrjedhimisht, llogaritë 215 “Mjete transporti” dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, nuk paraqesin vlerën reale në bilanc.

2. Nga auditimi dhe testimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, u konstatua se në regjistrat/librat e kontabilitetit të këtyre llogarive, për një pjesë të konsiderueshme të zërave nuk është pasqyruar vlera fillestare e aktiveve, por vetëm vlera e shpenzimeve të mëpasshme, për rikonstruksione ose përmirësimin e gjendjes së këtyre aktiveve. Kryesisht, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Gjithashtu, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi

i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Për llogaritë 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, nga Bashkia Krujë nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së aseteve. Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Fakti që nuk ka një regjistër kontabël për të gjitha AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

4. Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” nuk paraqet vlerën reale për shumën 198,048,332 lekë (3,500,000 lekë nga shoqëria “I. SH.A.”; 344,800 lekë nga shoqëria “Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Durrës SH.A.”, 500,000 lekë nga shoqëria “Klubi Sportiv K. SH.A.” dhe 193,703,532 lekë nga shoqëria “Ujësjetës Kanalizime Krujë SH.A.”

II. Opinion i Modifikuar (Kualifikuar) për përputhshmërinë:

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Krujë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Krujë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Krujë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar për përputhshmërinë.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë:

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme¹ për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000) si më poshtë:

Nga auditimi i **18** procedurave prokurimi të përzgjedhura në bazë të nivelit të riskut dhe materialitetit, janë konstatuar shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, nga të cilat: në **16** procedura kriteret nuk janë në përputhje me përcaktimet në legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën e kontraktuar 887,638,776 lekë; veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës; në **3** procedura, OE të shpallur fitues kanë pasur devijime të vogla nga kriteret e përcaktuara në DT, devijime të cilat nuk janë listuar në Raportet Përmbledhëse përkatëse, për vlerën e kontraktuar 185,397,934 lekë; në **8** procedura, OE janë shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në DT, për vlerën e kontraktuar 602,442,759 lekë. Sa më sipër janë veprime/mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë

¹ ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: “Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme”

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në 2 procedura për pastrimin e qyteteve janë konstatuar probleme në lidhje me zbatimin e kontratave, jo në përputhje me kushtet e kontratave të sipërmarrjes, për vlerën e kontraktuar 35,533,665 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Krujë:

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 206/1, datë 10.03.2023 “*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Krujë*”, i ndryshuar me shkresën nr. 206/2, datë 12.04.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “*Bashkia Krujë*”, nga data 13.03.2023 deri në datën 05.05.2023, u krye “*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022, ga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P., *Përgjegjës Grupi*;
2. E.K.;
3. K.H.;
4. S.M., *anëtarë*.

1. Objekti i Auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Krujë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. A.B., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. E.F., Drejtor i Drejtorisë së Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).

- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Krujë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
 - Ligji nr. 154/2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**
- Ligjet përkatëse *“Për buxhetin vjetor”* dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
 - Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 *“Për huamarrjen e qeverisjes vendore”*
 - Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 *“Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”*, i ndryshuar;
 - VKM 783 datë 22.11.2006 *“Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”*;
 - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 *“Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”*;
 - Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”*;
 - UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”*, etj;
 - Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, i ndryshuar;
 - Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”*, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022;
 - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 *“Për shlyerjen e detyrimeve të*

prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117, “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;

Në fushën e mbajtjes së Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në fushën e prokurimeve publike:

- Ligji nr. 43, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 32, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- Ligji nr. 107-2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

8. Metodatat e auditimit

Auditimi i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Peshat specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme,

regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korigjime të shumta të shifrave, etj.

- **Intervista**
- **Raporte dhe Informacione**
- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e Pyetësorëve dhe Testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

- **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Krujë

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Bashkia Krujë kufizohet në veri me Bashkinë e Kurbinit, në perëndim me Bashkinë Durrës, në jug me bashkitë Kamëz dhe Tiranë dhe në lindje me bashkitë Mat dhe Klos. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krujës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Kruja ka 59.814 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 79.608 vetësh. Kruja ka një sipërfaqe prej 339.02 km². Sipas Censurit, densiteti i popullsisë është 176.43 banorë/km²—dërsa sipas Regjistrat Civil dendësia është 234.81 banorë/km².

Të dhëna të tjera: Bashkia Krujë shtrihet në një terren të përzierë fushor dhe malor. Ajo përshkohet në pjesën fushore nga korridori rrugor dhe hekurudhor veri–jug. Në zonën



fushore disponon rezerva të konsiderueshme të gurit gëlqeror, gjë që ka sjellë ndërtimin e disa fabrikave të çimentos si dhe shumë punishteve të prodhimit të gëlqeres, industri të cilat kanë ndikim të madh negativ në mjedis duke qenë industritë më ndotëse në vend. Ndryshe nga zona fushore, qyteti i Krujës, Mali i Krujës dhe Parku Kombëtar i Qafë Shtamës ofrojnë resurse të konsiderueshme të turizmit kulturor, malor, fetar dhe shëndetësor, (Ilixhat në fshatin Bilaj). Qyteti i Krujës me kështjellën mesjetare, tregun e stilit osman, muzeun etnografik dhe muzeun kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” është ndoshta vendi më i vizituar turistik në Shqipëri ndërsa turizmi ka sjellë edhe ruajtjen e traditës së artizanatit në disa zeje të kufizuara në Pazarin e Krujës. Të dyja qytetet, Kruja dhe Fushë-Kruja, kanë si burime kryesore punësimi industrinë e veshjeve dhe këpucëve ndërsa qyteti i Fushë-Krujës siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave edhe nga fabrika e çimentos.

Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimeve të qytetit të Krujës është ndërtuar disa vite më parë, përfshirë kanalet kulluese për shirat e furishëm që përplasen herë pas here në Malin e Krujës. Situata është kreu e kundërta në qytetin e Fushë-Krujës si dhe në zonat rurale.²

Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 114 datë 28.12.2021. Struktura organizative ka në përbërje 548 punonjës, në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë.

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësie	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Krujë	Qyteti: Krujë, Fshatrat: Barkanesh, Picërragë, Brret.
Fushë Krujë	Qyteti: Fushë Krujë, Fshatrat: Fushë Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luz 2, Larushk 2, Arrameras 2

² Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-kruje/pasaporta-e-bashkise-kruje/>

Bubq	Fshatrat: Bubq, Bilaj, Budull, Mazhë e madhe, Mazhë e vogël, Mallkuç, Murqinë
Nikël	Fshatrat: Nikël, Tapizë, Qerekë, Rinas, Virjon, Buran, Mukaj, Kurcaj, Zezë
Thumanë	Fshatrat: Kodër-Thumanë, Borizanë, Derven, Gramëz, Thumanë, Bushnesh, Dukagjin i Ri, Sukth-Vendas, Miliska, Derven Kodër
Cudhi	Fshatrat: Cudhi-Zall, Nojë, Mafsheq, Shqezë, Shkretë, Cudhi-Kant, Kroi Madh, Bruz-Zall, Bruz-Mal, Rranxë

Bashkia Krujë e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për secilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuar në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.

Kryetar i Bashkisë Krujë është z. A.B. dhe Këshilli Bashkiak i Krujës përbëhet nga 31 anëtarë, të cilët janë zgjedhur në vitin 2019.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Bazuar në misionin e vetëqeverisjes vendore “për të siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve” nëpërmjet: zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative; për të rritur cilësinë e jetës si dhe shtuar aktivitetet për t’i shërbyer popullsisë së Bashkisë Krujë; referuar dhe Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, kreu III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, Bashkia Krujë, për çdo vit ka përgatitur “Deklaratën dhe pyetësin e vetëvlerësimit” dhe i ka dërguar në MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar/Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, për vitin 2022. Më poshtë po i analizojmë në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

1.1. Integriteti dhe Vlerat Etike

- Nëpunësit e Bashkisë Krujë duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë z. A.B., me shkresën nr. 3918, datë 10.06.2021 është miratuar Kodi i Sjelljes për Bashkinë Krujë në të cilën janë të përfshirë rregulla të etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.

Konstatim: Nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108 datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.

- Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë Bashkisë, ato regjistrohen pranë Zyrës së Protokollit të institucionit me një ndalesë, nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtoritë përkatëse dhe dhënia e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhërin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

- Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, çdo drejtori ka kryer vlerësimin e punonjësve të saj çdo 6 mujor, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar.

1.2. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

- Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe vepohet në bazë të saj.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë.

- Nuk kemi të protokolluara mbledhjet të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse.

- Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.

- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

1.3. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijojnë strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

- Me Vendimin nr. 10, datë 11.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar rregullorja e brendshme e institucionit.

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Referuar të dhënave të paraqitura nga pyetësi, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat disponohen procesverbale të takimeve të tyre, me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për dëgjuesat me publikun.

- Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

- Me Vendimin nr. 114 datë 28.12.2021 të Këshillit Bashkiak Krujë është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve për vitin 2022 për Bashkinë Krujë, Njësitë Administrative dhe funksionet e deleguara. Struktura organizative ka në përbërje 548 punonjës, në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Realizimi i strukturës organizative për periudhën objekt auditimi është paraqitur sipas muajve në Aneksin MFK1, në anekset bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, nga ku konstatohet se për vitin 2022 struktura është e plotësuar në masën 98%.

1.4. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore:

Nëpunësit e Bashkisë Krujë i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune kriteret për rekrutimin e tyre përcaktohen bashkëlidhur shpalljes së vendit vakant të punës sipas specifikave të secilit pozicion, referuar Kreut III të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, ku përcaktohet:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;
- Një sistem për vlerësimin e performancës;

Mbi politikat dhe praktikat e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregulloren e brendshme të institucionit janë përcaktuar detyrat sipas drejtorive dhe sektorëve si dhe ka një ndarje detyrash dhe përgjegjësish deri në nivel përgjegjës sektori dhe specialisti.

1.5. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale:

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

Me shkresën nr. 432 prot., datë 26.01.2022, dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë z. A.B., është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik në Bashkinë Krujë, i cili përfshin 18 punonjës (Administratorët e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Thumanë, Nikël, Bubq dhe Cudhi), në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, gërma “b”, neni 24, pika 2.

- Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion ky grup (GMS) janë hartuar procesverbalet përkatëse për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma “b”, neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

2. Menaxhimi i riskut:

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontroleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut.

Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës konkretisht nëpunësit zbatues.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

GMS ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut si dhe me shkresën nr. 1384 prot., datë 10.03.2022, është hartuar dhe miratuar Regjistri i Riskut në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "*Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike*", Aneksi 2, "*Regjistri dhe matrica e riskut*", si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, "*Menaxhimi i riskut*".

3. Aktivitetet e kontrollit:

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për rregjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësive dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësive dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Duke u bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, *“Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”* përcaktohet se, *“Nëpunësi Autorizues i njësive publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës”*.

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës”.

Bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, *“Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Riskut në njësitë publike”* në rolin e Koordinatorit të MFK në Bashkinë Krujë me shkresë nr. 431 prot., datë 26.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë Krujë është caktuar znj. O.L. me detyrë specialiste finance.

Konstatim: Koordinatorin e financës është caktuar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 *“Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve”* ku citohet në pikën 1.2 *“NZ i njësive publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësive publike në vartësi direkte nga Nëpunësi Autorizues i njësive dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Në njësitë publike të ndërtuara me më shumë se dy nivele vartësie, punonjësit e financës, në strukturat përgjegjëse për financat, të vendosur në nivelet e poshtme të vartësisë konsiderohen punonjës të deleguar të Nëpunësit Zbatues, të njësive nga varen. Punonjësit e financës të vendosur në nivelet e poshtme të vartësisë, duhet të kenë përfunduar të paktën studimet e ciklit të parë në shkencat ekonomike dhe raportojnë në mënyrë të dyfishtë tek Nëpunësi Zbatues i njësive nga varen dhe Nëpunësi Autorizues përkatës.”*

Konstatim: Për vitin 2022 Bashkia Krujë nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3 *“Aktivitetet e Kontrollit”*.

Titullarët e njësive kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve,

që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese;
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, që duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit;
- Procedurat e sinjalizimit;

Konstatim: Bashkia Krujë nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

4. Monitorimi:

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive.

Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetëtorin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “*Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm*”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.

Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

Me shkresën nr. 1828 prot., datë 28.02.2023, me shkresën nr. 1828/1 prot., datë 28.02.2023, dhe shkresën 1828/2 prot., datë 28.02.2023 nga Bashkia Krujë është hartuar dhe dërguar pranë

Ministrisë së Financave, Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Raporti Vjetor për Funkcionimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm, Pyetësorin e Vetëvlerësimit për Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm dhe Plani i Veprimit për ngritjen e sistemit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar në ligjin 115/2015 datë 15.10.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1 dhe Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 Aneksi nr. 6 “Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”. Gjithashtu është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.6. dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

5. Informimi dhe komunikimi

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe Urdhërave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t’i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Krujë dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë

shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

Titulli i gjetjes: Mbi implementimin dhe zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera në Bashkinë Krujë, është si vijon:

1. Në Bashkinë Krujë nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.

2. Kordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është caktuar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve”, pika 1.2.

3. Për vitin 2022 Bashkia Krujë nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3 “Aktivitetet e Kontrollit”.

4. Bashkia Krujë nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.1., faqe 12-23.

Kriteri: Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21/2016 “Për menaxherët e të gjitha niveleve”; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu VI, neni 32, pika 2/a, b, c; Ligji nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nënpunësin civil në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9, pikat 3, 4 dhe 5; neni 11 pika 1/c, e, f; neni 12; neni 19/1,2,3; neni 20; Ligji nr. 10325/2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”; VKM nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Lidhja 1 dhe 2; VKM nr. 243/2014 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; VKM nr. 142 /2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; Ligji nr. 119/2014 “Për informimin publik” dhe Udhëzimi i viti 2016 “Mbi detyrat e Koordinatorit të Informimit dhe Transparencës”.

Ndikimi/Efekt: Nga Bashkia Krujë nuk janë zbatuar rigorozisht elementët nga të cilët përbëhen pesë Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke riskuar sigurinë e arritjes së objektivave të bashkisë nëpërmjet përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.

Shkaku: Mos hartimi i gjurmës së auditimit si dhe një procedure për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave. Mos zbatimi i Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për delegimin e kompetencave për kordinatorin e MFK.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi 1: Nga Kryetari i Bashkisë Krujë të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së

auditimit, për hartimin e programeve të trajnimit zhvillimit profesional të stafit dhe një procedure për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizimin e tyre.

Rekomandimi 2: Nga Kryetari i Bashkisë Krujë të merren masa për të caktuar Nënpunësin Zbatues si Koordinator të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.

Në zbatim të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe Vendimit nr. 114, datë 28.12.2021, të Këshillit Bashkiak Krujë, është miratuar struktura organizative e Bashkisë Krujë ku pjesë e saj është dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm, e përbërë nga tre pozicione, konkretisht: 1 përgjegjës njësie dhe 2 specialistë auditimi. Përgjatë periudhës objekt auditimi, pjesë e NJAB kanë qenë punonjësit si më poshtë:

Periudha: 01.01.2022-15.11.2022

- Z. E.F. me detyrë përgjegjës i njësisë së auditimit të brendshëm.
- Znj. E.K. me detyrë specialiste auditimi.
- Znj. S.D. me detyrë specialiste auditimi.

Periudha: 16.11.2022-31.12.2022

- Znj. S.S. me detyrë përgjegjëse e njësisë së auditimit të brendshëm.
- Znj. D.P. me detyrë specialiste auditimi.
- Znj. S.D. me detyrë specialiste auditimi

Deri në datën 31.12.2022, struktura e NJAB ka funksionuar me 3 punonjës, konkretisht:

Znj. S.S. me detyrë përgjegjëse e NJAB, nuk është e certifikuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11, pika 2 shkronja “b”.

Znj. S.D. me detyrë specialiste e NJAB, nuk është e certifikuar, në kundërshtim me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11, pika 2 shkronja “c”.

Znj. D.P. me detyrë specialiste e NJAB, nuk është e certifikuar, në kundërshtim me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11, pika 2 shkronja “c”.

Të dhënat e detajuara janë paraqitur në Aneksin AB1 dhe AB2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1. Karta e Auditimit të Brendshëm për NJAB të Bashkisë Krujë është miratuar me Vendimin nr. 51, datë 17.11.2017, në përputhje me nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, e cila është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 142 prot., datë 09.01.2023 sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

2. Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vitet 2023-2025 me shkresën nr. 6261/1 prot., datë 17.10.2022, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.1. Referuar planit strategjik për vitin 2023 synohen të realizohen 6 auditime, për vitin 2024 synohet të realizohen 7 auditime dhe për vitin 2025 synohen të realizohen 7 auditime.

Konstatim: Plani strategjik duhet të rishikohet dhe të formulohet në bazë të Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016, Kapitulli III, Formatit Standard nr. 5. “Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NjAB”.

3. Plani vjetor është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vitin 2022 me shkresën nr. 807 prot., datë 11.02.2022, i ndryshuar me shkresën nr. 6944 prot., datë 14.10.2022.ë përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të

miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.1. Referuar planit vjetor për vitin 2022 synohen të realizohen 5 auditime për vitin 2022 dhe janë realizuar 4 auditime.

Konstatim: Plani vjetor duhet të rishikohet dhe të formulohet në bazë të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016 Kap III, Formati Standard nr. 5. *“Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NjAB”*.

4. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Audituese për vitin 2022, është dërguar me shkresën nr. 701/1 prot., datë 08.02.2023, në Drejtorinë e Hamornizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, bashkëlidhur ndodhen edhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Pika 3.6.

5. Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur të plotësuara në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI. Në to është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

Të dhënat e detajuara për auditimet e kryera janë paraqitur në Aneksin AB3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

6. Struktura e Projekt Raportëve dhe Raportëve Përfundimtare, përgjithësisht është e plotësuar sipas standardeve të Vendosura në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.12, Hapi 11.

7. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015, *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, neni 11, pika 2, shkronjat “b” dhe “c”.

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm ushtron detyrën si drejtues i njësisë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015, *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, neni 11, pika 2 shkronja “b”.

2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

Duke u bazuar në Planin Vjetor për vitin 2022, i cili është miratuar me shkresën nr. 807 prot., datë 11.02.2022, i ndryshuar me shkresën nr. 6944 prot., datë 14.10.2022, *“Për auditimet të cilat do të realizohen nga NJAB”*, kanë qenë objekt auditimi subjektet sipas Aneksit AB4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Seksioni VI, Kreu III, Pika 1, programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Referencat ligjore të vendosura në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Për vitin 2022 referuar planifikimit vjetor janë planifikuar për t’u kryer 5 auditime dhe janë realizuar 4 auditime në masën 80%.

Gjithashtu vlen të theksohet se për vitin 2022.ë lidhje me auditimet e përcaktuara, nuk kemi të argumentuar arsyen përse nuk është realizuar plani i auditimeve për vitin 2022.

Pasqyra e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga NJAB për vitin 2022 dhe faza e zbatueshmërisë së tyre, është paraqitur në mënyrë të hollësishme në Aneksin AB5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Mbi vlerësimin e aktivitetit të Njesisë së auditimit të brendshëm.

Situata: Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë të Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Krujë, për vitin 2022, u konstatua se:

1. Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.2 “*Plani vjetor i Auditimit*”, që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Plani vjetor duhet përgatitur duke marrë në konsideratë Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016 Kap III, Formatin Standard nr. 5, “*Hartimi i planit strategjik dhe vjetor të NjAB*”.

2. Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.1 “*Planifikimi strategjik*” që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Planifikimi strategjik duhet të kryhet duhet përgatitur duke marrë në konsideratë Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016 Kap III, Formatin Standard nr. 5, “*Hartimi i planit strategjik dhe vjetor të NjAB*”.

3. Rekrutimi i punonjësve është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, neni 11, pika 2, shkronjat “b” dhe “c”.

Struktura e NJAB funksionon me 3 punonjës konkretisht:

Znj. S.S. me detyrë përgjegjëse e NJAB; Znj. S.D. me detyrë specialiste e NJAB dhe Znj. D.P. me detyrë specialiste e NJAB, nuk janë të certifikuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, neni 11, pika 2, shkronja “c”.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.1., faqe 12-23.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” dhe “*Manuali i auditimit të brendshëm në sektorin publik*”; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar; VKM nr. 83/2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”; Ligji nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”; “*Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, etj.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e certifikimit të stafit të NjAB në Bashkisë Krujë përbën pengesë për mirëfunksionimin dhe performancën e Njesisë së auditimit të brendshëm të bashkisë.

Shkaku: Moszbatimi i bazës ligjore në fuqi, e cila rregullon aktivitetin e Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Krujë.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi 1: Nga NJAB të merren masa që Plani Vjetor dhe Plani Strategjik për vitin 2023 të jenë në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016, Kapitulli III, Formatin Standard nr. 5, “*Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NjAB*”.

Rekomandimi 2: Bashkia Krujë të marrë masa që 3 punonjësit në NjAB të kryejnë certifikimin si Auditues të Brendshëm, në mënyrë që struktura e NjAB të funksionojë në mënyrë efektive.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Për hartimin e PBA-së 2022-2024, nga Bashkia Krujë janë ndjekur dhe zbatuar hapat e mëposhtëm:

- Urdhër i Brendshëm nr. 01, datë 08.04.2021, “*Për përgatitjen e PBA-së 2022-2024*”;
- Shkresë nr. 2297 prot., datë 08.04.2021, “*Dërgohet Udhëzimi i Brendshëm për përgatitjen e PBA-së 2022-2024 për Bashkinë Krujë*”;

- Relacion nr. 1663 prot., datë 12.03.2021, “Mbi përgatitjen e tavaneve Përgatitore sipas PBA-së 2022-2024 të Bashkinë Krujë”;
 - Urdhër nr. 168, datë 12.03.2021, “Ngritja e ekipeve të menaxhimit të programeve të PBA-së 2022-2024 dhe buxhetit vjetor 2022, të Bashkisë Krujë”;
 - VKB nr 27, datë 31.03.2021, “Për miratimin e tavaneve Përgatitore të Shpenzimeve të PBA-së 2022-2024 në Bashkinë Krujë”;
 - VKB nr. 95, datë 27.10.2021, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 për Bashkinë Krujë”, relacioni bashkëlidhur;
 - Me shkresë nr. 5235 prot., datë 28.07.2021, “Dërgohet Udhëzimi i brendshëm për përgatitjen e Programit Afatmesëm Vendor 2022-2024, për Bashkinë Krujë”, drejtuar ekipit të menaxhimit të programeve;
 - VKB nr. 66, datë 26.07.2021, “Tavanet buxhetore përfundimtare”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 590/8, datë 30.07.2021;
 - Relacioni nr. 4852, datë 19.07.2021, “Mbi përgatitjen e tavaneve përfundimtare sipas programeve buxhetore për PBA 2022-2024, në Bashkinë Krujë”;
 - Udhëzimi Plotësues nr. 20, datë 09.07.2021, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm Vendor 2022-2024”;
 - VKB nr. 55, datë 28.06.2021, “Për miratimin e projektit të parë të PBA-së, për Bashkinë Krujë”, si dhe mendimi mbi PBA-në 2022-2024, i dërguar në MFE me shkresë nr. 10877 prot., datë 18.06.2021;
 - Urdhër nr. 168, datë 12.03.2021, “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të Bashkisë Krujë”, i ndryshuar;
 - VKB nr. 106, datë 28.12.2020, “Mbi miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve buxhetore 2022 dhe përgatitjes së PBA-së 2022-2024”;
 - Shkresë dërguar MFE nr. 3637 prot., datë 01.06.2021, “Dërgohet Instrumenti i Planifikimit Financiar 2022-2024”, bashkëlidhur dhe relacioni;
 - Shkresë dërguar MFE nr. 6250 prot., datë 15.09.2021, “Dërgohet Instrumenti i Planifikimit Financiar 2022-2024”, bashkëlidhur dhe relacioni.
- Nga auditimi, u konstatua se për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Krujë nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”, kreu I, pika 13.

Titulli i Gjetjes: Probleme në lidhje me publikimin e Projekt Buxhetin Afatmesëm 2022-2024.

Situata: Për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Krujë nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-36.

Kriteri: Udhëzimi MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”, kreu I, pika 13.

Ndikimi/Efekti: Mangësi e menaxhimit për të publikuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur të njësisë vendore.

Shkaku: Analizat e punës për publikimin e PBA për 2022-2024 nuk janë bërë të plota, duke mos qenë transparent.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa të publikojë në faqen zyrtare Projekt Buxhetin Afatmesëm 2022-2024 sipas kërkesës së Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Për vitin 2022.ë Bashkinë Krujë buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 27 programeve, përkatësisht: Organet ekzekutive dhe legjislativë, për çështjet financiare dhe fiskale, çështje të brendshme, Shërbime të huamarrjes vendore, Shërbime policore, Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri, marrëdhëniet me komunitetin, çështjet e përgjithshme ekonomike tregtare dhe të punës, Bujqësia, Pyjet, peshkimi dhe gjuetia, Transporti, Industri të tjera, Menaxhimi i mbetjeve, etj. Buxheti i vitit 2022, është miratuar me VKB nr. 115, datë 28.12.2020, me shkresën nr. 8856/11, datë 10.01.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës.

Nga auditimi u konstatua se, buxheti i viteve 2022-2024 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit nr. 32, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022, është paraqitur në Aneksin B1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2022, është paraqitur në Aneksin B2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022:

Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **3,779,616** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **2,374,876** mijë lekë, ose në masën 63%.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022, është paraqitur në Aneksin B3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

VKB nr. 115, datë 28.12.2020, me shkresën nr. 8856/11, datë 10.01.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës.

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, me VKB nr. 13, datë 28.02.2022, “Për miratimin e shtesës së buxhetit të Bashkisë Krujë të vitit 2022” bashkëlidhur relacioni VKB nr. 73, datë 09.08.2022 dhe VKB nr. 103, datë 28.12.2022.

Titulli i Gjetjes: Probleme në lidhje me procedurat e diskutimit, planifikimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve.

Situata: Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **3,779,616** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **2,374,876** mijë lekë, ose në masën 63%.

- Vlera e mosrealizimit në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë tregon se planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale;

- Ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2022, rezulton:

- Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor;
- Kryetari i Bashkisë Krujë për vitin 2022.01 ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe

zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-36.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 47, Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore” shtojca 4, pika c.

Ndikimi/Efekti: Mangësi e menaxhimit për të projektuar, miratuar, realizuar dhe analizuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur të njësisë vendore. Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, më së shumti për shkak të mosrealizimit të të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkaku: Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda afateve, të dokumentoj se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Treguesit e buxhetit për vitin 2022, janë planifikuar në shumën 3,779,616 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 2,374,876 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 63%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 336,805 mijë lekë ose në masën 14% të buxhetit faktik.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore pasqyruar.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44 dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Bashkia Krujë ka raportuar në MFE për zbatimin e buxhetit të vitit 2022:

- Me shkresën nr. 2954 prot., datë 20.05.2022, “Mbi raportimin e zbatimit të buxhetit për 4-mujorit e vitit 2022”;
- Me shkresën nr. 6086 prot., datë 20.09.2022, “Mbi raportimin e zbatimit të buxhetit për 8-mujorit e vitit 2022”;
- Me shkresën nr. 1545 prot., datë 20.02.2023, “Mbi raportimin e zbatimit të buxhetit për vitin 2022”.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Në Bashkinë Krujë, vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2022. u përputhet me të dhënat e rakorduara të Degës së Thesarit dhe raportimin në MFE me shkresën nr. 1545 prot., datë 20.02.2023, e cila paraqitet 17,602,310 lekë, ndërkohë që në dokumentet analitike që Bashkia Krujë disponon, vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet 31,581,206 lekë. Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, Bashkia Krujë nuk ka hartuar një plan të cilin ta paraqesë në raportimin e monitorimit vjetor të buxhetit dërguar në MFE, por parashikohet vetëm që në fund të vitit 2022 mos të ketë detyrime të prapambetura.

Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Krujë për investimet, është paraqitur në Aneksin B4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Krujë për vitin 2022, janë paraqitur në Aneksin B5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur të dhënat që grupi i auditimit analizoi lidhur me detyrimet e prapambetura janë grupuar në Aneksin B6, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, referuar dokumentacionit si akt rakordimet me degën e thesarit, raportimeve në MFE dhe listave analitike që disponon Bashkia Krujë.

Titulli i gjetjes: Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, pasaktësi në të dhënat e paraqitura raportimet në MFE dhe dokumentet analitike të Bashkisë Krujë.

Situata: Nga ana e Bashkinë Krujë janë bërë përpjekje për të bërë saktësimin dhe evidentimin e kontratave dhe faturave të cilat nuk ishin pasqyruar më parë në tabelat e raportimeve të detyrimeve. Nga analizimi rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE, rakordohet me degën e thesarit për vlerën 17,602,310 lekë, por nuk përputhet me vlerën e në dokumentet analitike që bashkia disponon nuk rakordon as në total as sipas zërave specifik dhe rezulton që detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 të jenë në vlerën 31,581,206 lekë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-36.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

Ndikimi/Efekti: Mosshlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penaltetesh të panevojshme dhe pasaktësi në vlera dhe mangësi në raportime të detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, vlera jo të besueshme dhe mungesë raportimesh në MFE për detyrimet e prapambetura.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportoje periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Krujë:

Për Bashkinë Krujë, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2022 ka vlerën 3,003,348,648 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022, ka vlerën 17,602,310 lekë, sipas raportimit në MFE me shkresën nr. 2109, datë 06.03.2023. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 0.59%, shifër që e klasifikon Bashkinë Krujë në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

Shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive, trajtohet në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, kreu XI, “Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre”, neni 55, “Problemet Financiare”, pika 1 dhe në

UMFE nr. 26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Krujë:

Likuidimet e vendimeve gjyqësore, janë paraqitur në Aneksin B7, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, nga ku u konstatua se:

1. Nga të dhënat e paraqitura në Aneksin B7, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore, nga dokumentet analitike të bashkisë rezulton 3,336,440 lekë. Janë paguar detyrime në vlerën 2,684,280 lekë dhe për vitin 2022, rezultojnë 652,160 lekë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 40, pika 3;
2. Bashkia Krujë, në likuidimin e detyrimeve nuk respekton rradhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8.

Titulli i gjetjes: Moslikuidim i vendimeve gjyqësore sipas radhës së paraqitjes së tyre.

Situata: Vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore të prapambetura nga dokumentet analitike të bashkisë rezulton në vlerën 3,336,440 lekë janë paguar detyrime në vlerën 2,684,280 lekë dhe për vitin 2022 rezultojnë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore në vlerë 652,160 lekë, si dhe Bashkia Krujë në likuidimin e detyrimeve nuk respekton rradhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-36.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 40, pika 3 dhe Udhëzimi i MFE nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8.

Ndikimi/Efekti: Identifikimi, regjistrimi i vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura si dhe likuidimi i tyre ndikon në vlerësimin e situatës financiare të Bashkisë Krujë.

Shkaku: Bashkia Krujë nuk zbaton rradhën e regjistrimit në bashki të vendimeve gjyqësore për likuidim.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Krujë, Drejtoria e Financës dhe Sektori i Buxhetit të hartojë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojë me rigorozitet rradhën e regjistrimit të tyre në bashki kur të kryejë likuidimet e tyre.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 3,779,616 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **2,374,876** mijë lekë. Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 336,805 mijë lekë dhe vlera e mbuluar nga FZHR është **2,038,074** mijë lekë, ose **86%**. Nga këto, fondi i pagave (Ilogaria 600) është realizuar me 77%, sigurime shoqërore dhe shëndetësore (Ilogaria 601) është realizuar me 77%, shpenzimet operative (Ilogaria 602) është realizuar me 62%, transfertat korrente të brendshme (Ilogaria 604) është realizuar me 23%, transferime tek buxhetet familjare (Ilogaria 606) është realizuar me 100% dhe fondi i investimeve (Ilogaria 231) është realizuar me 86%.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve.

Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Parashikimi dhe realizimi i taksave e tarifave vendore sipas llojeve:

Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Krujë është miratuar me VKB-në nr. 106, datë 28.12.2021 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 999/2 prot., datë 10.01.2022.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Krujë për vitin 2022, është paraqitur në Aneksin B8, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Referuar të dhënave të paraqitura në Aneksin B8, për periudhën nën auditim, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Krujë për vitin 2022 është realizuar në masën 90%. Nga 350,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 316,371 mijë lekë (diferencë 33,629 mijë lekë). 10 zëra janë realizuar në masën mbi ose 85%, 2 zëra janë realizuar në masën mbi ose 50%, 1 zë është realizuar në masën mbi ose 25% dhe 3 zëra nën masën 25%.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet:

Në Bashkinë Krujë, struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipërcituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë, është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 32, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.

Lidhur me ecurinë në procesin e legalizimeve për vitin 2022 rezulton se janë legalizuar 32 objekte me vlerë totale 920,522 lekë dhe janë paguar të gjithë detyrimet.

Titulli i gjetjes: Mosarkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve).

Situata: Lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se, për vitin 2022. uk ka debitorë por detyrimet e viteve të mëparshme janë në vlerë 63,700,015 dhe në vitin 2022 është paguar vlera 110,210 lekë, vlera e mbetur vazhdon të jetë detyrim që përbën në total 63,589,805 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-36.

Kriteri: Ligji nr. 32, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; Ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 32, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar”, neni 9, pika 3/c; Ligji nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 32, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar”, neni 1, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5; etj.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë, nga mos arkëtimi i vlerës prej **63,589,805 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mos marrje e masave nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për të bërë të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve nga subjektet që kanë përfituar certifikatën e pronësisë, si dhe mos bashkëpunim me DTTV dhe ASHK-në.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën

e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **63,589,805 lekë**. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Krujë të bashkëpunojnë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore:

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e palikuiduara etj, në Bashkinë Krujë kryhet në programin Excel. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Bizneset që ushtrojnë aktivitetet në Bashkinë Krujë 2022 janë paraqitur në Aneksin B9, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Realizimi i të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit:

Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Krujë, u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 35 procesverbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 4 masa për “*Pezullim të punimeve*”, 13 masa për “*Prishje të objekteve të kundërligjshëm*” si dhe 29 masa “*Dënim me gjobë*”. Nuk kanë paguar disa subjekte vullnetarisht, me vlerë totale të gjobave të vendosura 7,450,000 lekë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Drejtoria e IMTV nuk ka ndjekur hapat e nevojshëm për të dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhërin e Ekzekutimit për të gjithë gjobat e vendosura të këtij viti, por vetëm për 15 masa, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*”, neni 30, pika 4. Vlera 7,450,000 lekë nga mosarkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV për vitin 2022, përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Krujë.

Titulli i gjetjes: Mosarkëtim i gjobave të vendosura nga IMTV.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Krujë, u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 35 Procesverbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 4 masa për “*Pezullim të punimeve*”, 13 masa për “*Prishje të objekteve të kundërligjshëm*” si dhe 29 masa “*Dënim me gjobë*”. Nuk kanë paguar disa subjekte vullnetarisht, me vlerë totale të gjobave të vendosura 7,450,000 lekë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. Për vitin 2022 të ardhurat e munguara nga mosarkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 7,450,000 lekë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-36.

Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*” neni 30 pika 1 pika 3 dhe pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë në vlerën 7,450,000 lekë.

Shkaku: Mos ndjekja e hapave ligjore për arkëtimin e gjobave të IMTV.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: IMTV dhe Drejtoria e të Ardhurave në Bashkisë Krujë të ndjekin të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjisllacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **7,450,000 lekë**.

Menaxhimi i borxhit:

Subjektet Debitorë: Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, u konstatua se gjendja progresive e debitorëve për subjektet fizikë/juridikë në fund

të vitit 2021 është 2251 subjekte, në vlerën 530,511,820 lekë, ndërsa për vitin 2022 është 613,515,626 lekë.

Të dhënat progresive në vlerë për subjektet debitorë për vitin 2022, janë paraqitur sipas Njësive Administrative në Aneksin B10, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Të dhënat progresive në numër për subjektet debitorë për vitin 2022, janë paraqitur sipas Njësive Administrative dhe llojit të biznesit në Aneksin B11, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga të dhënat e Bashkisë Krujë, gjendja progresive e debitorëve për subjektet fizikë/juridikë, në fund të vitit 2021 rezulton 2251 subjekte, në vlerën 530,511,820 lekë.

Në fund të vitit 2022 rezultojnë 2412 subjekte në vlerën 613,515,626 lekë.

Vërehet se për vitin 2022 vlera progresive e debitorëve të jetë rritur përafërsisht me 13.6%, krahasuar me një vit më parë.

Lista emërore progresive për subjektet debitorë është paraqitur në Aneksin B12, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Taksat dhe Tarifat Familjare:

Në Bashkinë Krujë familjarët ngarkohen me taksa dhe tarifa për Tokën, Banesën, Ndriçimin dhe Shërbimet Publike nga Drejtoria e Tatim Taksave Vendore. Nga auditimi, rezultoi se Bashkia Krujë nuk ka identifikuar numrin e familjeve që paguajnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe si rrjedhojë nuk ka identifikuar numrin e familjeve debitorë, si dhe nuk janë paraqitur dokumente analitike për këto debitorë. Në total vlera progresive e detyrimit nga familjet debitorë, e paraqitur nga Bashkia Krujë është 109,356,149 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Tatim Taksave, vlera totale borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Krujë paraqitet:

1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 109,356,149 lekë;
2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë 63,589,805 lekë; dhe
3. Biznese Debitorë në vlerë 613,515,626 lekë;

Nga auditimi, u konstatua se në fund të vitit 2022, borxhi tatimor është 786,461,580 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Krujë.

Masat e marra për uljen e borxhit:

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenet 89-93 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “*Hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara*”.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet, rezulton se janë njoftuar bizneset debitorë që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre për 28 pika, për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifave vendore me shkresën nr. 6925, datë 14.10.2022, por pas mbarimit të afatit ligjor të këtij njoftimi, nuk kanë vazhduar procedurat e mëtejshme për bllokimin e llogarive bankare të subjekteve debitorë.

Titulli i gjetjes: Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Krujë dhe masat e marra për uljen e tij.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se në Bashkinë Krujë, gjendja e debitorëve (bizneseve) për vitin 2022 ka qenë në vlerën 83,003,806 lekë, ndërsa vlera progresive deri në 31.12.2022 për subjektet fizike/juridike ka qenë 613,515,626 lekë. Kjo vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Krujë, është: 63,589,805 lekë nga taksa e ndikimit në

infrastrukturë, 109,356,149 lekë nga debitorët familjarë, duke rezultuar në total me vlerën e borxhit tatimor 786,461,580 lekë. Gjithashtu, Bashkia Krujë nuk ka të dhëna për numrin e familjeve debitore për periudhën objekt auditimi si dhe nuk ka dokumente analitike ku të jenë paraqitur zërat sipas taksave dhe tarifave dhe numrit të familjeve për taksat dhe tarifat familjare. Nga Bashkia Krujë pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2022, nuk janë nxjerrë Urdhërat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-36.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Moszbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **786,461,580 lekë** nga taksapaguesit privatë dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhërat përkatës për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitorë.

Rekomandimi 2: Bashkia Krujë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të marrë masat për të ngritur një grup pune i cili të identifikojë të gjithë familjarët që paguajnë detyrimet e bashkisë lidhur me taksat dhe tarifat familjare.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve:

Në territorin e Bashkisë Krujë për periudhën objekt auditimi, kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 37 subjekte. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve përkatësisht rezultoi:

1. Subjekti “E.O.” me NUIS K.....J, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 02.07.2021-02.07.2022 dhe 03.07.2022-03.07.2023. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
2. Subjekti “K.” me NUIS J.....P, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 5 vjeçare për periudhën 2018-2023 për të dy pikat në Bashkinë Krujë;
3. Subjekti “V.P.” me NUIS K.....K, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., ka tre pika karburanti në Bashkinë Krujë, dhe ka paguar për të tre pikat e karburantit, me autorizim 2 vjeçare me afat 06.01.2022-06.01.2024;
4. Subjekti “P.B.” me NUIS L.....H, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 5 vjeçare për periudhën 2020-2025;
5. Subjekti “K.” me NUIS J.....L, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 21.05.2021-21.05.2022 dhe 22.05.2022-22.05.2023. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
6. Subjekti “A.G.” me NUIS L.....I, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 duke sjellë të ardhura të munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë në vlerën 200,000 lekë;
7. Subjekti “I.” me NUIS L.....Q, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë deri në momentin e mbylljes së aktivitetit (datë 20.04.2022)

- për vitin 2022. Këtë pikë e ka marrë "A.G." me NUIS L.....I dhe nuk është pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë në vlerën 200,000 lekë;
8. Subjekti "K.I.D." me NUIS K....C, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 16.12.2021-16.12.2022. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
9. Subjekti "K." me NUIS L.....J, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 1 vite për të dy pikat e karburantit = 400,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
10. Subjekti "B.O." me NUIS L.....S, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 05.01.2022-05.01.2023. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
11. Subjekti "G.C." me NUIS K....T, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 05.01.2022-05.01.2023 për te dy pikat e karburantit. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
12. Subjekti "S.G." me NUIS K.....V, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., ka tre pika karburanti në Bashkinë Krujë:
- a) është pajisur me licencë nga Bashkia Krujë për një periudhë 27.05.2021-27.05.2022 dhe 27.05.2022-27.05.2023. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
 - b) dhe për pikën e dytë dhe të tretë ky subjekt nuk është pajisur me licencë duke sjellë të ardhura të munguara në Bashkinë Krujë për vlerën 400,000 lekë;
13. Subjekti "M.O." me NUIS L.....H, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 04.02.2021-04.02.2022. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 04.02.2022-31.12.20212 periudha e pambuluar me autorizim 11 muaj * 16,666 = 183,326 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
14. Subjekti "B.S." me NUIS K....R, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 16.03.2021-16.03.2022. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 17.03.2022-31.12.2022 periudha e pambuluar me autorizim 9 muaj e 15 ditë * 16,666 = 158,038 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
15. Subjekti "V." me NUIS L....H, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 12 muaj = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
16. Subjekti "E.D.O." me NUIS L....A, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 12 muaj = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
17. Subjekti "G.E.P.", me NUIS L.....V ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 12 muaj = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
18. Subjekti "A. ShPK" me NUIS K....C, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 02.07.2021-02.07.2022 dhe 03.07.2022-03.07.2023. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
19. Subjekti "K." me NUIS J.....N, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 12 muaj = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
20. Subjekti "S.A." me NUIS K....D, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 12 muaj = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;

21. Subjekti “E.” me NUIS K.....V, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 12 muaj = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
22. Subjekti “D.O.” me NUIS L.....G, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., për dy pika karburanti si dhe është pajisur me licencë nga data 05.01.2022-05.01.2023 për të dy pikat e karburantit. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
23. Subjekti “V.T.” me NUIS K....H, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 5 vjeçare për periudhën 2018-2023. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
24. Subjekti “A.” me NUIS L.....U, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 12 muaj = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
25. Subjekti “G.” me NUIS K.....C, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 17.07.2021-17.07.2023. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë;
26. Subjekti “M.O.” me NUIS L.....P, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 12 muaj = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
27. Subjekti “A.D.” me NUIS L.....E, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për vitin 2022 periudhë e pambuluar me autorizim për 12 muaj = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
28. Subjekti “I.A.” me NUIS L.....L, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë në momentin e hapjes së aktivitetit nga data 01.04.2022-01.04.2023. Rezulton se subjekti ka paguar detyrimin dhe është autorizuar me licencë.
- Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte sipas dokumentacionit që bashkia disponon, të cilët janë të papajisur me autorizim, bie në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre””, të ndryshuar, neni 4 dhe neni 20, pika 2.

Titulli i gjetjes: Ushtrimi i aktivitetit në shkelje të dispozitave ligjore nga subjektet që tregtojnë lëndëve djegëse.

Situata: Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 28 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 37 pika karburanti), nga të cilat 14 subjekte për 19 pika karburanti janë të autorizuar dhe kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore dhe për 18 pika karburanti janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale 3,341,364 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-36.

Kriteri: Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre””, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2, pika 11.

Ndikimi/Efekt: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Puna jo efektive e drejtuesit dhe specialistëve të Drejtorisë së Tatim Taksave Vendore në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim edhe pse janë njoftuar nga DTTV.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa që subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet të papajisur me autorizimin përkatës, të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën **3,341,364 lekë** ndaj Bashkisë Krujë.

Asetet e dhëna me qira:

Bashkia Krujë, në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 1 kontratë për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Kjo kontrata është lidhur bazuar në legjislacionin përkatës.

Nga auditimi i pagesave të kontratës nr. 8691 prot., datë 21.12.2021, me subjektin “O.T. Sha” me aktivitet vendosje antene të telefonisë së lëvizshme, për një sipërfaqe prej 15 m², për vlerën 400,000 lekë në vit, u konstatua se nuk ka paguar detyrimin për vlerën totale të detyrimit.

Me shkresën “Kërkesë për lëshim fature për arkëtim”, datë 12.01.2023, Drejtoria e Menaxhimit të Tokës dhe Pronës i është drejtuar Drejtorisë së Tatim Taksave për të kryer veprime lidhur me pagesën e detyrimit të subjektit “O.T.”, pra 2 vjet pasi është lidhur kontrata e qirasë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në lidhje me sa më sipër, nga Bashkia Krujë është paraqitur observacioni me nr. 4971/3 prot., datë 15.06.2023, i administruar në KLSH me nr. 206/7 prot., datë 19.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Referuar Kontratës së Qirasë nr. 8691 Prot, Datë 21.12.2021, nënshkruar nga Bashkia Krujë me “O.T.” SHA, me objekt dhënia me qira e një sipërfaqe per 15 m2 (neni 1), me afat 1 vjecar duke filluar nga data e nënshkrimit(neni 3), vlera e qirasë vjetore në shumën 400 000 lekë/vit (neni 4), rezulton se bazuar ne Faturen për Arkëtim, lëshuar nga Drejtoria e Tatim Taksave e Bashkisë Krujë, ky subjekt ka arkëtuar ONLINE BANKING, në bankën “O.” BANK, Albania shumën 400 000 lekë, sipas dokumentit Lëvizjet e llogarisë sipas kërkesës datë 03.03.2023, e konfirmuar nga O. BANK Albania Dega Krujë, datë 14.06.2023. Bashkëlidhur fatura me datë 14.06.2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i kundërshtive dhe dokumentacionit bashkëlidhur, observacioni merret në konsideratë dhe reflektohen ndryshimet e nevojshme në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Zbatimi i aktmarrëveshjeve:

Në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, DTTV Bashkia Krujë ka lidhur marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura me disa subjekte debitore të vitit 2022, të cilat janë paraqitur të detajuara në Aneksin B13 dhe B14, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga analizimi i Akt marrëveshjeve të lidhura për vitin 2022 vërehet se pjesa më e madhe e subjekteve ose familjeve debitorë kanë respektuar kushtet e kontratës duke paguar sipas kësteve të caktuara, përveç subjekteve me Akt marrëveshjet si mëposhtë:

1. Aktmarrëveshja me subjektin “L.N.”, është lidhur me datë 24.03.2022, me afat 24.03.2022-24.06.2023 dhe subjekti ka paguar vetëm këstin e parë duke shkelur kushtet e kontratës;
2. Aktmarrëveshja me subjektin “A.V.” është lidhur me datë 11.05.2022, me afat 11.05.2022-10.12.2023 dhe subjekti ka paguar vetëm këstin e parë duke shkelur kushtet e kontratës;
3. Aktmarrëveshja me subjektin “D.K.” është lidhur me datë 15.06.2022, me afat 15.06.2022-10.12.2022 dhe subjekti vazhdon të ketë detyrim deri në fund të vitit 2022 duke shkelur kushtet e kontratës;
4. Aktmarrëveshja me subjektin “R.” është lidhur me datë 16.06.2022, me afat 16.06.2022-31.12.2022 dhe subjekti vazhdon të ketë detyrim deri në fund të vitit 2022 duke shkelur kushtet e kontratës;

5. Aktmarrëveshja me subjektin “R.T.E.” është lidhur me datë 12.10.2022, me afat 12.10.2022-10.12.2022 dhe subjekti vazhdon të ketë detyrim deri në fund të vitit 2022 duke shkelur kushtet e kontratës.

Titulli i gjetjes: Mos hartim i akt marrëveshjeve për pagesën e detyrimeve tatimore ndaj bashkisë, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Situata: Bashkia Krujë ka lidhur:

- 24 akt marrëveshje për vitin 2022 për të ndihmuar subjektet debitore në likuidimin e detyrimeve me këste për vitin 2022, 19 subjekte dhe familje debitore i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes dhe nuk i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes 5 prej tyre.
- Si dhe akt marrëveshje të lidhura në vitin 2021 me afat deri në vitin 2022,ga të cilat 10 subjekte dhe familje debitorë prej këtyre akt marrëveshjeve nuk i kanë zbatuar kushtet e kontratës.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe i akt marrëveshjeve për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se ka mangësi nga ana e DTTV në lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste, përkatësisht;

- Në dy raste, rezulton se afati i akt marrëveshjeve është lidhur për një periudhë 24 mujore, por afati nuk mund të zgjatë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës, pas momentit të hartimit të marrëveshjes;
- Nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-36.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 2, 3, 4, 5.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Akt marrëveshjet janë hartuar në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë, gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë, të marrë masat që këto akt marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtare si dhe të plotësojnë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste.

Konkluzion: Të ardhurat e munguara për buxhetin e Bashkisë Krujë janë 797,652,944 lekë, si më poshtë:

- Nga taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 63,589,805 lekë;
- Nga gjoha të vendosura nga IMTV në vlerën totale 7,450,000 lekë;
- Nga familjet për taksat dhe tarifat e tokës, ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, etj., në vlerën 109,356,149 lekë;
- Nga bizneset debitore, në vlerën 613,515,626 lekë;
- Nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në vlerën 3,341,364 lekë;

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

➤ **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2022**

Në fund të periudhës ushtrimore, bilanci është plotësuar sipas formateve standard të miratuara me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022. Bilanci i vitit 2022 është përgatitur nga z. E.F., me detyrë Drejtor i Financës dhe Nëpunës Zbatues, është konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë, z. A.B., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe është depozituar në Degën e Thesarit Krujë me shkresën nr. 2982 prot., datë 31.03.2023, brenda limiteve të përcaktuara me ligj.

Veprimet kontabile janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, centralizator dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.

Partitarët analitikë të të gjitha llogarive janë mbajtur dhe azhornuar si dhe i llogarive inventariale të magazinës për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:

- Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2: Pasqyra e performancës financiare;
- Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5: Pyetësor me shënimet shpjeguese;

Pasqyrat statistikore:

- Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7, a dhe b: - Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b);
- Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

➤ **Qasja dhe metodologjia e auditimit.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **48,682,045 lekë** për shpenzimet dhe **60,847,470 lekë** për të ardhurat, sipas **Aneksit PF1**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ **Mbi vlerësimin e riskut**

Nga grupi i auditimit janë ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në Bashkinë Krujë nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësisë ekonomike nuk mund ta dijë ku mund të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët (me dëgën e thesarit) informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- Transaksionet:

Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.

Nisur nga ky fakt, bazuar në vlerën e materialitetit të përlogaritur (12,211,132 lekë) u filtruan të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajt nëntor-dhjetor 2022, në vlerën 522,691,058 lekë për muajin nëntor dhe 690,442,868 lekë për muajin dhjetor.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

➤ **Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit**

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët:

Subjekti që auditohet i ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

➤ **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021:**

Mbajtja e kontabilitetit:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*”), të përcaktuara në Ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, si dhe në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022; nenit 3 dhe 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, etj.

Nuk ka patur komunikim me MFE për aspekte të trajtimeve kontabile apo mbyllje vjetore.

Bilanci kontabël:

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Krujë në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2022.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë: Aktivet, Detyrimet dhe Kapitali.

Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sigurtë të situatës financiare.

Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse .

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzhërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Në Bashkinë Krujë nuk ka njësi varësie, të cilat të funksionojnë si njësi shpenzuese të pavarura, pra, nuk ka pasqyra financiare të konsoliduara.

Në Bashkinë Krujë, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, në programin kompjuterik EXCEL, gjë e cila paraqet risk të lartë përse i përket sigurisë dhe saktësisë së informacionit të paraqitur nëpërmjet pasqyrave financiare.

Nga auditimi, u konstatua se në bilanc, totali i Aktivit është i barabartë me totalin e Pasivit, në vlerën 9,011,477,507 lekë.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Krujë në 31.12.2022, sipas formatit F1, është paraqitur në Aneksin PF2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit.

➤ **AKTIVET**

Nga auditimi, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF të Bashkisë Krujë, vlera është 2,175,308,277 lekë, e cila përbëhet nga Aktivet Qarkulluese/Afatshkurtra, në vlerën 366,977,224 lekë dhe Aktivet Afatgjata në vlerën 1,808,331,053 lekë.

I. Aktivet Afatshkurtra

Nga auditimi, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF të Bashkisë Krujë, vlera është 9,011,477,507 lekë. Në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, vlera është 2,314,052,547 lekë. Llogaria 520 “*Disponibilitete në Thesar*”, ka vlerën 1,464,672,480 lekë.

1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre:

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë detajuar në Aneksin PF3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga Aneksi PF3, konstatohet se kjo llogari ka pësuar një rritje me 836,091,597 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo llogari kuadraton me shumën e llogarive përkatëse 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit” dhe 12 “Rezultatet e mbartura”, në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022, Kreu III, pikat 29, 30, 39, 50. Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, në datën 31.12.2022 ka qenë 1,464,672,480 lekë, me një rritje prej 836,091,597 lekë nga viti ushtrimor paraardhës. Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar në Aneksin PF4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Llogaritë e Klasës 5 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Nga auditimi i ditarit të bankës, u konstatua se në debi të llogarisë 520 janë paraqitur gjithsej 1,938 transaksione, për vlerën totale **2,383,109,661 lekë**, ndërkohë që planifikimi ka qenë për vlerën totale **3,779,616,312 lekë** sipas Aneksit PF5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Nga auditimi, u konstatua se është realizuar 63% e planit vjetor të shpenzimeve.

2. Gjendje Inventari qarkullues:

Llogaritë e inventareve paraqiten në vlerën totale 81,649,935 lekë, me një rritje prej 9,759,787 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Llogaria 31 “Materiale”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,195,888 lekë, me një rritje prej 199,594 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, ndërsa llogaria 32 “Inventar i imët”, paraqitet në vlerën 74,454,047 lekë, me një rritje prej 9,560,193 lekë nga viti ushtrimor paraardhës. Këto rritje janë si rezultat i shtesave të materialeve gjatë vitit. Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrjen jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe Pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme, nuk rezultuan diferenca përse i përket llogarisë 32 “Inventar i imët” dhe llogarisë 31 “Materiale”.

Nga analiza e kryer për llogarinë 32 “Inventar i imët”, Bashkia Krujë dhe Njësitë Administrative përkatëse gjatë vitit 2022, ka një rritje prej 9,759,787 lekë. Diferencat me pasqyrimin në bilanc i përkasin shtesave gjatë periudhës.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e dokumentuara në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës, si dhe me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

3. Llogaritë e arkëtueshme:

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten në vlerën totale 750,127,822 lekë, me një rritje prej 64,619,943 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën debitore 702,662,238 lekë.

Kjo llogari përbëhet nga detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2022.

Në këtë nënzë paraqiten edhe tepricat debitore të llogarive të furnitorëve, kërkesat ndaj personelit, individëve, debitorëve të tjerë, kërkesat ndaj pjesëmarrjeve dhe shoqërive të grupit, etj., kur ato klasifikohen si afatshkurtra.

Për vlerën e paarkëtuar, Bashkia Krujë është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e Urdhërave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të

Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit “Për kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve, ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve për detyrimet e lëna nga KLSH në vite për shpërbllim dëmi, për arkëtimin e të cilave nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore, duke kaluar afatet e kërimit.

Në Bashkinë Krujë ka mangësi dokumentacioni vërtetues, gjë që e bën të pamundur kërkimin në rrugë zyrtare dhe ligjore të detyrimeve të papaguara në favor të saj.

Detyrimet e klientëve janë kërkesa afatshkurta dhe nëse nuk i mbledh subjekti, atëherë parimi i vijimësisë (qëndrueshmërisë) vihet në pikëpyetje.

Bashkia Krujë nuk ka bërë analizë për vlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe për vjetërsinë e tyre dhe nuk ka politika të shkruara rreth procedurave për njohjen e provizioneve. Mungesa e analizave të duhura rreth të arkëtueshmeve dhe politikave të duhura rreth procedurave për njohjen e provizioneve ndikon në besueshmërinë e vlerës së tyre.

Gjithashtu për vlerat mbi një vit, drejtimi nuk ka bërë zhvlerësimin për këto llogari të arkëtueshme.

Në mënyrë analitike Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, është paraqitur e detajuar në Aneksin PF6, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit ushtrimor 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 47,465,584 lekë, e cila përbëhet nga shuma e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 0 lekë, llog. 42 “Detyrimet ndaj personelit” në vlerën 24,431,517 lekë, llog. 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 1,467,742 lekë, llog. 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 7,243,736 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 995,853 lekë dhe llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në vlerën 17,602,310 lekë. Nga auditimi nuk u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilanc është pasqyruar në mënyrë të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

4. Të tjera aktive afatshkurtra

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 17,602,310 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 19,306,881 lekë.

Detyrimet e Bashkisë Krujë, sipas natyrës janë paraqitur në **Aneksin PF7**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Përsa i përket detyrimeve të prapambetura, nga pasqyra e mësipërme vërehet se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të prapambetura është e trashëguar nga periudha para reformës territoriale.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitore e kësaj llogarie, është e kuadruar me shumën e llogarisë kreditore në pasiv të bilancit, përkatësisht me llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën 17,602,310 lekë, në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 22.02.2022, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi 1, “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

Nga auditimi i ankesës së z. S.M., i cili me Vendimin nr. 42, datë 27.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, ka fituar të drejtën e pagës nga data 01.03.2017, kur është larguar nga puna, deri në rikthimin në detyrë, u konstatua se ky detyrim i Bashkisë Krujë nuk është kontabilizuar dhe nuk ka filluar të bëhet pagesa ndaj këtij kreditori.

Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet vlerën e vërtetë.

II. Aktivet Afatgjata

1. Aktivet afatgjata jomateriale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas UMF nr. 8, datë 9.03.2018, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022, përfshin primet e emisionit dhe rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit në Aneksin PF9, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” në Bashkinë Krujë në datën 31.12.2021 ka qenë në vlerën 134,000,204 lekë dhe në datën 31.12.2022 ka qenë në vlerën 136,740,204 lekë. Është shtuar një projekt: “*Projektim mbrojtje në brigjet e lumit Zezë*” në vlerën 2,740,000 lekë, sipas Aneksit PF10, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Për këto asete njësia publike nuk ka përlllogaritur norma amortizimi duke i qëndruar Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 05).

Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit. Për aq kohë sa objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është e gabuar.

2. Aktivet afatgjata materiale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5, i përmirësuar.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:

Vlera e kësaj nënrubrike është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Shtesat në këtë nënrubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.

Shtesat në këtë nënrubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Detajet e nënrubrikës Aktive Materiale Afatgjata janë paraqitur në Aneksin PF11, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në Bashkinë Krujë inventarizimi është kryer në bazë të urdhërave përkatës të titullarit, sipas të cilëve janë ngritur komisionet për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së aseteve. Nga ana e Drejtorisë së Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Gjithashtu, fakti që nuk ka një regjistër kontabël për AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

Llogaritë e Klasës 21 “*Aktive Afatgjata Materiale*”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, paraqiten në shumën 5,018,436,582 lekë. Në vitin ushtrimor paraardhës, vlera totale e AAM-ve ka qenë 4,291,986,973 lekë, me një shtesë të AAM-ve në shumën 726,449,609 lekë.

Në Bashkinë Krujë inventarizimi është kryer çdo vit në bazë të urdhërave përkatës të titullarit, sipas të cilëve janë ngritur komisionet për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave

73, 74 dhe pika 81 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Sipas pasqyrës së aktiveve, nxjerrjet jashtë përdorimit janë miratuar me VKB nr. 107 datë 28.12.2021, “Mbi miratimin e vlerësimit të mjeteve motorrike për nxjerrjen nga përdorimi”, i konfirmuar nga Prefektura Durrës me shkresën nr. 999/3 datë 10.01.2022, me të cilin janë nxjerrë jashtë përdorimit 9 automjete në vlerën 17,854,038 lekë. Për vitin 2022, nga llogaria 215 “Mjete transporti” janë nxjerrë jashtë përdorimi 8 automjete në vlerën 13,178,838 lekë dhe nga llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” është nxjerrë jashtë përdorimi 1 makineri në vlerën 4,675,200 lekë.

Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrje jashtë përdorimi, me kontabilitetin dhe aneksin e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve të qëndrueshme nuk rezultuan diferenca.

Llogaria 31 “Materiale”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,195,888 lekë, me një rritje neto prej 199,594 lekë nga viti ushtrimor paraardhës.

Llogaria 32 “Inventar i imët”, paraqitet në vlerën 74,454,047 lekë, me një rritje neto prej 9,560,193 lekë nga viti ushtrimor parardhës.

Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrjen jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme, nuk rezultuan diferenca përsa i përket llogarisë 32 “Inventar i imët” dhe llogarisë 31 “Materiale”.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e dokumentuara në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës, si dhe me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Titulli i gjetjes: Parregullsi dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se:

1. Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 37,907,145 lekë dhe në datën 31.12.2022 paraqitet në vlerën 40,397,690. Rezulton një rritje prej 2,490,553 lekë, si rrjedhojë e shtesës së tre shponësimeve. Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në Aneksin PF12, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

2. Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 për 19,804,270 lekë. Edhe sipas Formatit nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 19,804,270 lekë. Kjo vlerë përfshin kostot e mbjelljes së pemëve dekorative dhe frutore në territorin e Bashkisë Krujë, për të cilat nuk ekziston inventari fizik në numër drurësh. Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në Aneksin PF13, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

3. Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 1,423,340,263 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,854,020,505 lekë, me një rritje neto në vlerën 430,680,242 lekë. Kjo diferencë vjen si rrjedhojë e shtesave dhe pakësimeve të vitit, konkretisht: Shtesa të vitit 538,152,551 lekë; Pakësime të vitit: 36,305,296 lekë; Pakësim i amortizimit të vitit: 71,167,013 lekë. Kosto historike ka qenë 2,336,186,067 lekë dhe amortizimi i akumuluar ka qenë 482,165,562 lekë. Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në Aneksin PF14, ndërsa analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Aneksin PF18, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

4. Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 2,710,398,261 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,920,240,937 lekë, me një rritje në vlerën 209,842,676 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Detajet e kësaj llogarie janë

paraqitur në Aneksin PF15, ndërsa analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Aneksin PF19, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

5. Gjendja e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 17,468,925 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 28,404,238 lekë, me një rritje në vlerën 10,935,313 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit dhe nxjerrje jashtë përdorimi. Shtesa të vitit: 15,788,676 lekë; Pakësime të vitit: 841,536 lekë; Pakësim nga amortizimi i vitit: 4,011,827 lekë. Analiza e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” është paraqitur në Aneksin PF20, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

6. Gjendja e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 22,672,572 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 31,836,370 lekë, me një rritje në vlerën 9,163,798 lekë. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit dhe nxjerrje jashtë përdorimi ndërsa rritjet janë për blerjet e automjeteve të reja. Shtesa të vitit: 16,303,280 lekë; Pakësime të vitit: 2,604,968 lekë; Pakësim nga amortizimi i vitit: 4,534,515 lekë. Detajet e kësaj llogarie janë paraqitur në Aneksin PF16, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se automjetet në vlerën 61,161,138 lekë, sipas Aneksit PF17 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, nuk janë mjete transporti, por makineri, të cilat duhet të regjistrohen në llogarinë përkatëse, 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”. Rrjedhimisht, llogaritë 215 “*Mjete transporti*” dhe 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, nuk paraqesin vlerën reale në bilanc. Analiza e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” është paraqitur në Aneksin PF21, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

7. Gjendja e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 57,995,537 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 121,332,564 lekë, me një rritje në vlerën 63,337,027 lekë. Shtesa të vitit: 74,936,134 lekë; Pakësim nga amortizimi i vitit: 11,599,107 lekë. Analiza e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” është paraqitur në Aneksin PF22, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

8. Nga auditimi dhe testimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, u konstatua se në regjistrat/librat e kontabilitetit të këtyre llogarive, për një pjesë të konsiderueshme të zërave nuk është pasqyruar vlera fillestare e aktiveve, por vetëm vlera e shpenzimeve të mëpasshme, për rikonstruksione ose përmirësimin e gjendjes së këtyre aktiveve. Kryesisht, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Gjithashtu, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

9. Për llogaritë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, 212 “*Ndërtime e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*”, nga Bashkia Krujë nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike.

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së aseteve. Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës disponohet

informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Fakti që nuk ka një regjistër kontabël për të gjitha AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

Në kontabilizimin e këtyre aktiveve, nuk është marrë në konsideratë “Njohja fillestare”, por vetëm “Vlerësimi i mëpasshëm”, duke mos njohur origjinën e tyre. Mosnjohja e origjinës së aktiveve është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2, Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, etj.

Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

➤ **Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr. 7/b) Viti 2022.**

Për vitin 2022, amortizimi i AQT-ve (Llogaria 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”), nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto janë paraqitur në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.7 “Amortizimi”, si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022.

Nga auditimi i Bilancit, Formatit 7, a dhe b: “Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b)”, u konstatua se Amortizimi i Akumuluar në Bashkinë Krujë për Aktivet Afatgjata Materiale në fillim të vitit 2022 paraqitet për vlerën 1,171,458,857 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet për vlerën 1,610,597,111 lekë. Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhë ushtrimore, shtesën e kostos së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivitetit. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2022 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%

Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Mosnjohja e origjinës së aktiveve është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”. Pika 2, Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Nga auditimi ka rezultuar se, shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Financës, z. E.F. dhe Specialiste kontabiliteti A.B..

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 36-57.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Krujë.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Rekomandimi 2: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, si dhe saktësimin e aseteve të inventarizuara, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë vlera fillestare dhe kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe

shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës, sipas rastit.

3. Aktivitet Afatgjatë Financiare:

Titulli i gjetjes: Mangësi në kontabilizimin e aktiveve afatgjatë financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për periudhën e audituar.

Situata: Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Krujë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si:

- Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë “*I. S.H.A.*”, me NUIS L14519201M e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit, etj.*”. Numri i aksioneve është 2,000 me vlerë nominale 1,750 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **3,500,000 lekë**. Këto të drejta, Bashkia Krujë i ka trashëguar nga reforma territoriale, si përfituese e pasurisë së ish-Bashkisë Fushë Krujë. Kjo vlerë nuk është paraqitur në aktivet afatgjatë financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2022, konkretisht në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*”.

- Aksionare me 3,45% të aksioneve të shoqërisë “*Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës S.H.A.*”, me NUIS M...2M e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij, etj.*”. Numri i aksioneve është 100,000 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 10,000,000 lekë. Pjesa takuese e Bashkisë Krujë është 3,448 aksione, në vlerën totale **344,800 lekë**. Kjo vlerë nuk është paraqitur në aktivet afatgjatë financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2022, konkretisht në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*”.

- Aksionare me 25% të aksioneve të shoqërisë “*Klubi Sportiv K. S.H.A.*”, me NUIS L...V e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit, etj.*”. Numri i aksioneve është 2,000 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 2,000,000 lekë. Pjesa takuese e Bashkisë Krujë është 500 aksione, në vlerën totale **500,000 lekë**. Kjo vlerë nuk është paraqitur në aktivet afatgjatë financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2022, konkretisht në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*”.

- Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë “*Ujësjellës Kanalizime Krujë S.H.A.*”, me NUIS J.....J e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij, etj.*”. Numri i aksioneve është 1 me vlerë nominale 193,703,532 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **193,703,532 lekë**. Kjo vlerë nuk është paraqitur në aktivet afatgjatë financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2022, konkretisht në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*”.

Për sa më sipër, llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” nuk paraqet vlerën reale për shumën **198,048,332 lekë** (3,500,000 lekë nga shoqëria “*I. S.H.A.*”; 344,800 lekë nga shoqëria “*Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës S.H.A.*”, 500,000 lekë nga shoqëria “*Klubi Sportiv K. S.H.A.*” dhe 193,703,532 lekë nga shoqëria “*Ujësjellës Kanalizime Krujë S.H.A.*”, në kundërshtim me Urdhërin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*”, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “*Aktivitet afatgjatë materiale dhe Aktivitet afatgjatë jo materiale*” pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*”. Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivitet Afatgjatë Financiare të Bilancit Kontabël për vlerën e aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje në shumën 198,048,332 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar dhe për këto veprime mbajnë përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Financës, z. E.F. dhe Specialiste kontabiliteti A.B..

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 36-57.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”;

VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve financiare të Bashkisë Krujë.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e aktiveve financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Bashkia Krujë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të regjistruar dhe sistemuar në kontabilitet, në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2023, konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, për vlerën totale 198,048,332 lekë shoqëritë:

1. “I. SH.A.”, me NUIS L.....M, për 100% të aksioneve, gjithsej 2,000 aksione, me vlerë nominale 1,750 lekë/aksion, me vlerë totale 3,500,000 lekë;
2. “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës SH.A.”, me NUIS M.....M, për 3.45% të aksioneve, gjithsej 3,448 aksione, me vlerë nominale 100 lekë/aksion, me vlerë përkatëse 344,800 lekë;
3. “Klubi Sportiv Kastrioti SH.A.”, me NUIS L.....V, për 25% të aksioneve, gjithsej 500 aksione, me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, me vlerë përkatëse 500,000 lekë.
4. “Ujësjiellës Kanalizime Krujë SH.A.”, me NUIS J.....J, për 100% të aksioneve, gjithsej 1 aksion, me vlerë nominale 193,703,532 lekë/aksion me vlerë totale 193,703,532 lekë.

4. Investimet:

Titulli i gjetjes: Mosparaqitje e saktë e vlerës së llogarive 230/231 “Investime”.

Situata: Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2022 paraqitet përkatësisht 0 lekë për llog. 230 dhe 1,542,248,174 lekë për llog. 231, në total 1,542,248,174 lekë.

Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2022 ka qenë 1,081,941,366 lekë, nga të cilat 741,265,068 lekë me fonde të deleguara dhe 340,676,298 lekë nga të ardhurat e veta. Vlera e kontraktuar (me Tvsh), për investimet në proces gjatë vitit 2022 ka qenë 991,766,258 lekë, nga të cilat 734,813,881 lekë me fonde të deleguara dhe 256,952,377 lekë nga të ardhurat e veta. Planifikimi total për vitin 2022 ka qenë 1,130,166,929 lekë, nga i cili 762,623,413 lekë me fonde të deleguara, me realizim në vlerën 732,291,956 lekë dhe 367,543,516 lekë nga të ardhurat e veta, me realizim në vlerën 179,765,285 lekë.

Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale”. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022, kreu II, pikat 6 dhe 15-18,

kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, “Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël)”, “Aktive afatgjata materiale”, etj.

Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2022. uk paraqet vlerën reale, e cila duhet të përmbante shumën e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Krujë. Kontratat e lidhura në vitin 2022, për vlerën 826,471,882 lekë, janë paraqitur në Aneksin PF25, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Financës, z. E.F. dhe Specialiste kontabiliteti A.B..

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 36-57.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e investimeve të Bashkisë Krujë.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtorja e Financës në Bashkinë Krujë, të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

➤ **PASIVET**

I. Pasivet Afat shkurtra

1. Llogari të pagueshme: Në këtë grup llogarish paraqiten të gjitha detyrimet e njësive ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme.

Në datën 31.12.2022, shuma e llogarive 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore”, është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 47,465,584 lekë. Analiza e grupit të llogarive të pagueshme për vitin 2021 është paraqitur në Aneksin PF26, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 për Llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në bilanc paraqiten në vlerën 0 lekë.

Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 24,431,517 lekë, përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit për muajin dhjetor 2022. Në fund të vitit 2021 ka qenë 21,714,400 lekë, me një rritje në vlerën 2,717,117 lekë.

Llogaria 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa*”, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 1,467,742 lekë përfaqëson detyrimet për tatimin mbi pagat e personelit në muajin dhjetor 2022. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2023.

Llogaria 435 “*Sigurime shoqërore*”, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 7,243,736 lekë përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore në muajin dhjetor 2022. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2023.

Llogaria 436 “*Sigurime shëndetësore*”, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 995,853 lekë, përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimet shëndetësore në muajin dhjetor 2022. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2023.

Në mbyllje të periudhës raportuese, llogaritë kreditore 42; 431; 435 dhe 436 në vlerën totale 34,138,848 lekë, përfaqësojnë detyrime të njësisë publike Bashkia Krujë për pagat e personelit, kontribute për sigurime shoqërore, shëndetësore si dhe tatimin mbi pagë, të përlllogaritura për pagesë në muajin dhjetor 2022, të cilat janë likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2023.

Detyrime të tjera afatshkurtra:

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.

Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht.

Llogaritë për detyrime të tjera afatshkurtra janë paraqitur në **Aneksin PF27**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Mosmarrja në dorëzim e kontratave të investimeve të mbyllura, mbajtja e garancisë përtej limiteve kohore.

Situata: Gjendja e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 44,656,180 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 79,488,357 lekë ose me rritje në vlerën 34,832,177 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Në mënyrë analitike, Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” në fund të vitit 2022 është paraqitur në Aneksin PF28, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Financës, z. E.F. dhe Specialiste kontabiliteti A.B..

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 36-57.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar, Kap II “*Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 “*Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 “*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike*” i ndryshuar pikat 42-50 të tij, UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave*

financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Ndikimi/Efekt: Mosmarrja në dorëzim e objekteve janë verime të cilat nuk garantojnë nëse objekti është zbatuar sipas kushteve teknike të projekt/preventivave, si është realizuar dhe nëse është realizuar brenda kushteve teknike. Gjithashtu, moskryerja e këtij veprimi bën që nga Bashkia Krujë të mos bëhet vlerësimi i subjekteve mbi cilësinë e punimeve dhe nëse këto subjekte janë shoqëri të besueshme për kryerjen e punimeve me cilësi dhe në afatet të caktuar, si dhe vënia në vështirësi ekonomike e OE, të cilëve iu nevojiten fondet e ngurtësuara për të vazhduar veprimtarinë e tyre ekonomike.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

Gjendja e llogarisë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 611,708,432 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 702,662,238 lekë ose me rritje në vlerën 90,953,806 lekë. Në mënyrë analitike, llogaria 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në fund të vitit 2022 është paraqitur në Aneksin PF29, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 77,467,907 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 30,929,046 lekë ose me zbritje në vlerën 46,538,861 lekë. Në mënyrë analitike, llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në fund të vitit 2020 është paraqitur në Aneksin PF30, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ **KAPITALI**

Sipas përcaktimit të bërë në SKK, kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4), njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.

Gjendja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*” (Kapitali i nënshkruar) në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 4,497,877,325 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 5,236,826,721 lekë ose me rritje në vlerën 738,949,396 lekë.

Gjendja e llogarisë 85 “*Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore*” (*Humbja/fitimi i ushtrimit*) në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 583,924,703 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,385,184,123lekë ose me rritje në vlerën 801,259,420 lekë. Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Llogaritë 105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 874,125,393 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,542,248,174 lekë ose me rritje në vlerën 668,122,781 lekë.dhe 106 “*Teprica e Granteve kapitale të huaja*”, si për periudhën ushtrimore paraardhëse, ashtu edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur, janë me vlerën 0 (zero).

Grantet kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proçes të institucioneve (të papërfunduara

ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Krujë në datën 31.12.2022, janë të kuadruara me Degën e Thesarit. Pasqyra e performancës financiare në fund të vitit 2021 është paraqitur në Aneksin PF31, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Sipas SKK nr. 2, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.

Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:

a. Efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (*SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare*);

b. Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/ humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;

- i. fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (*SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit*);
- ii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (*SKK 5 - Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale*);
- iii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje (*SKK 3 "Instrumentet Financiare"*);
- iv. Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet

Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së performancës.

Pasqyra e performancës tregon, minimalisht, zërat që paraqesin shumat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen. Fitimi ose humbja është rreshti i fundit i kësaj pasqyre.

➤ **TË ARDHURAT**

1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet:

Llogaria 70 "*Të ardhurat nga taksat e tatimet*", në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 147,701,933 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 136,364,291 lekë ose me ulje në vlerën 11,337,642 lekë. Të ardhurat nga taksat e tatimet janë paraqitur të detajuara në Aneksin PF32, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Llogaria 71 "*Të ardhura jotatimore*", në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 105,114,936 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 120,775,401 lekë ose me rritje në vlerën 15,660,465 lekë. Të ardhurat jotatimore janë paraqitur të detajuara në Aneksin PF33, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

2. Të ardhura të tjera:

Llogaria 72 "*Grante korente*", në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 2,175,781,770 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 3,498,876,964 lekë ose me rritje në vlerën 1,323,095,194 lekë. Grantet korente, të ardhurat e tjera dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve janë paraqitur të detajuara në Aneksin PF34, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ **SHPENZIMET**

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 320,654,672 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 328,676,327 lekë ose me rritje në vlerën 8,021,655 lekë.

Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 52,918,369 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 54,892,232 lekë ose me rritje në vlerën 1,973,863 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Krujë me të njëjtën vlerë.

Shpenzimet për pagat dhe kontributet shoqërore e shëndetësore janë paraqitur në Aneksin PF35, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ **Testimi i llogarisë 600 “Paga dhe shpërblime”**

Për vitin 2022.umri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 114 datë 28.12.2021. Numri i miratuar i punonjësve të bashkisë Krujë, funksioneve të transferuara dhe gjendjes civile ka qenë 557 punonjës. Sipas listëpagesave janë paguar mesatarisht 554 punonjës për Bashkinë Krujë. Sa më sipër, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

Numri i punonjësve sipas listëpagesave është paraqitur në Aneksin PF36, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Numri i punonjësve sipas Vendimit nr. 114 datë 28.12.2021 është i ndarë si më poshtë:

1. Administrata e Bashkisë dhe Njesitë Administrative	372 punonjës
2. Shërbimi mbrojtjes nga zjarri	18 punonjës
3. Funksione të transferuara nga arsimi	132 punonjës
4. Administrimi pyjeve(funksion i transferuar)	7 punonjës
5. Ujitja dhe kullimi (funksion i deleguar)	7 punonjës
6. Rruget rurale (funksion i deleguar)	6 punonjës
7. QKB	2 punonjës
8. Punonjës sezonalë (me kontratë)	4 punonjës
9. Gjendja Civile	9 punonjës

Totali: **557 punonjës**

Sipas listëpagesave të muajve janar, shtator dhe dhjetor 2022 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listëpagesat dhe përmbledhësja e listëpagesave janë nënshkruar nga Specialistja e pagave dhe nga Kryetari i Bashkisë Krujë.

Janë mbajtur listëprezencat, të cilat janë nënshkruar nga Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Kryetari Bashkisë.

➤ **Auditimi me zgjedhje i disa dosjeve të personelit (me arsim të lartë).**

Në auditimin e dosjeve të personelit krahasuar me nivelin e klasave, kategorinë, pagën e grupit, shtesat për vjetërsi, vështirësitë, pozicionin, etj, u konstatua se janë në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të VKM-së nr. 177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e NJVQV për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Në dosjet personale të nëpunësve adminstrohen:

Dokumenti i identifikimit (fotokopje letërnjoftimi); dokumenti mbi gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor në fushën e studimeve përkatëse (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokument i gjendjes

gjyqësore (dëshmi penaliteti); raportit mjeko ligjor; librezë pune; fotografi; CV; letër motivimi; dëshmi të tjera kualifikimi.

Nga auditimi i kryer rezultoi se:

Gjatë vitit 2022, ishin reflektuar ndryshimet në pagën minimale për punonjësit përkatësisht si vijon:

Me VKM nr. 158, datë 12.03.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, paga minimale nga 30,000 lekë/muaj është bërë 32,000 lekë/muaj nga data 01.04.2022.

Referuar VKM nr. 625, datë 28.09.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e NJVQV për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të të Njësive të vetëqeverisjes vendore””, VKM nr. 624, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin e me page dhe shtesa të punonjësve të MNZSH””, ishin kryer pagesat e punonjësve me efekte financiare nga data 01.09.2022, si dhe me VKM nr. 604, datë 14.09.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, paga minimale nga 32,000 lekë/muaj është bërë 34,000 lekë/muaj nga data 01.09.2022.

Në zbatim të VKM të mësipërme, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me VKB nr. 84, datë 30.09.2022, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 775/9 Prot., datë 13.10.2022, janë miratuar pagat e punonjësve të Bashkisë Krujë, me efekte financiare nga data 01.09.2022, sipas tabelës së niveleve të pagave me emërtesat dhe pozicionet e punës.

Disa nga dosjet që u audituan janë paraqitur në në Aneksin PF37, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ **Hartimi i listëpagesave për vitin 2022**

Nga auditimi i kryer me zgjedhje rezultoi se listëpagesat janë plotësuar konform rregullave të përcaktuara, ku për çdo muaj plotësohen: Listëprezencat (kohëshënuesit), për çdo strukturë (Drejtori/Sektor/Njësi Administrative/Funksione të deleguara), të nënshkruara për çdo rast nga Drejtuesit përkatës si dhe ishte hartuar Lista përmbledhëse e punonjësve, e nënshkruar nga Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë, në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të Bashkisë, janë mbajtur në bazë të Ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 261,949,061 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 247,644,367 lekë ose me ulje në vlerën 14,304,694 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Krujë me të njëjtën vlerë.

Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime janë paraqitur në Aneksin PF38, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

➤ **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës, në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dyja palët.

Urdhër-shpenzimet janë përpiluar në bazë të dokumenteve vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit, si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzime përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin përkatës.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadron me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

➤ **Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifave familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuar me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, arkëtim gjopa të policisë Bashkiake. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.

Për vitin 2022, janë prerë Mandat Arkëtime në vlerën 2,375,510 lekë dhe libri i arkës është mbyllur me MA nr. 1176 datë 29.12.2022, në vlerën 1,280 lekë. Janë derdhur në bankë 2,375,510 lekë.

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2022 janë derdhur totalisht në mënyrë periodike në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është 0 (zero) lekë. Gjithashtu, është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël, i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006 "*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*", si dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" pikat 63, 64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit Krujë për të ardhurat.

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Krujë nuk ka pasur subvencione.

4. Transferimet korente:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Transferime korente, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 822,029,639 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 831,603,387 lekë ose me rritje në vlerën 9,573,748 lekë.

5. Shpenzimet financiare:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Shpenzime financiare, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 0 lekë dhe në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 0 (zero) lekë.

U kryen procedura testimi analitik me përzgjedhje kampionesh për zona të ndryshme llogarish, duke bërë verifikim të fondeve të planifikuara dhe të përdorura, të përllogaritjeve të vlerave për transaksione financiare të kryera si rezultat i ndodhjes së ngjarjeve ekonomike si dhe verifikimi i përputhshmërisë ligjore i dokumentacionit shoqërues mbështetës nëse ato ishin kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 40 “Shpenzimet” pika 1.

➤ Kontratat e lidhura për vitin 2022

Titulli i gjetjes: Probleme në lidhje me kryerjen e veprimeve kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit.

Situata: Për vitin 2022, janë planifikuar investime të reja në buxhet në vlerën 234,590,210 dhe investime nga vitet e mëparshme në vlerën 105,704,476 lekë. Gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 94,838,015 lekë nga investimet e mbartura dhe vlera 65,101,398 lekë nga investimet e vitit. Në total janë likuiduar 159,939,413 lekë.

Me fonde Buxhetore kanë qenë gjithsej 3 objekte, në vlerën totale 103,699,945 lekë të likuiduar gjatë vitit 2022. Nga fondet e rindertimit janë 5 objekte, në vlerën totale të likuiduar 615,692,179 lekë.

Për vitin 2022 janë lidhur 87 kontrata, në vlerën totale 991,766,258 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR, etj.

Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2022 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”. Kontratat e lidhura për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin PF39, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Me kapitalizimin e aktivitetit, (për aktivitetet e marra në dorëzim), duheshin kryer veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur” e në kredi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime; dhe në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” e në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFEn nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFEn nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “Procedurat për përgatitjen,

paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 32.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Financës, z. E.F. dhe Specialiste kontabiliteti A.B..

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 36-57.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njërive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Krujë.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.

Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për **investimet e papërfunduara/në proces,** të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Me kapitalizmin e aktivitetit, (për aktivitetin e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë, shërbime dhe mallra, të cilat janë miratuar me VKB-të përkatëse, bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, konstatoi si vijon:

Për vitin ushtrimor 2022, nga Bashkia Krujë, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve ka kryer gjithsej 44 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 407,218,410 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 332,981,389 lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 70,480,795 lekë pa TVSH ose 18.2%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	64	407,218,410	332,981,389
- Të hapura	12	257,579,960	198,951,232
- E hapur e thjeshtuar	32	13,591,991	10,5614,044
- Me negociim pa shpallje	2	3,359,865	3,351,534
- Të vogla	18	10,358,594	8,448,729
Sipas llojit të objekteve			
- Objekte në fushën e investimeve/ndërtime	27	264,323,315	197,641,928
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	37	142,895,095	135,339,461

Krahas sa më sipër, në Bashkinë Krujë gjatë periudhës objekt auditimi janë zhvilluar edhe dy procedura prokurimi të përsheptuara, në lidhje me rindërtimin. Është audituar edhe procedura e projektit për objektet e dëmtuara nga tërmeti, e zhvilluar në vitin 2021, e cila nuk është audituar nga KLSH në auditimet e mëparshme.

Nr.	Objekti i procedurës së Prokurimit	Fondi limit	Vlera e kontratës
1	Hartimi i projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në Bashkinë Krujë në kuadër të procesit të rindërtimit	64,047,500	63,746,100
2	Riforcimi i njësive të banimit në ndërtesa (pallate) të cilat do rikonstruktohen apo riparohen në kuadër të procesit të rindërtimit	501,755,367	497,093,331
3	Shembja e njësive individuale të banimit të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimi i materialeve të dala prej tyre në Bashkinë Krujë, në kuadër të procesit të rindërtimit	115,965,523	115,251,570
Totali		681,768,390	676,091,001

Vlera totale e fondit limit ka qenë 1,088,986,800 lekë, (përfshirë tenderin për projektin e ndërhyrjeve rehabilituese i cili është zhvilluar në vitin 2021), me vlerë të kontratave 1,009,072,390 lekë. U audituan gjithsej 17 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 954,263,604 lekë dhe vlerë të kontratave 894,593,217 lekë ose 87.6% e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë në procedura gjithsej 77 OE/BOE, nga të cilat janë

skualifikuar 10 OE/BOE. Procedura me 1 OE kanë qenë gjithsej 2 procedura, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar kanë qenë gjithsej 4 procedura. Prokurimet e zhvilluara nga Bashkia Krujë për periudhën 01.01.2018-31.12.2022, janë paraqitur në Aneksin P1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e zhvilluara për vitin 2022, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Situata: Referuar të dhënave në Aneksin për prokurimet, bashkëlidhur Projekt Raportit të auditimit, gjatë vitit 2022, janë realizuar gjithsej 64 procedura prokurimi, me fond limit 407,218,410 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 332,981,389 lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 70,480,795 lekë pa TVSH ose 18.2%. Gjithashtu, në kuadër të procesit të rindërtimit, janë realizuar 3 procedura prokurimi (1 gjatë vitit 2021 dhe 2 gjatë vitit 2022), me fond limit 681,768,390 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 676,091,001 lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 5,677,389 lekë pa TVSH ose 0.8%.

Referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit vlerësoi për auditim **18** procedura, me fond limit 947,037,620 lekë ose 87% e fondit limit të prokuruar.

Nga auditimi i procedurave si më sipër, janë konstatuar shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, nga të cilat: në **16** procedura kriteret nuk janë në përputhje me përcaktimet në legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën e kontraktuar 887,638,776 lekë; veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës; në **3** procedura, OE të shpallur fitues kanë pasur devijime të vogla nga kriteret e përcaktuara në DT, devijime të cilat nuk janë listuar në Raportet Përmbledhëse përkatëse, për vlerën e kontraktuar 185,397,934 lekë; në **8** procedura, OE janë shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në DT, për vlerën e kontraktuar 602,442,759 lekë. Sa më sipër janë veprime/mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në **2** procedura për pastrimin e qyteteve janë konstatuar probleme në lidhje me zbatimin e kontratave, jo në përputhje me kushtet e kontratave të sipërmarrjes, për vlerën e kontraktuar 35,533,665 lekë.

Në të gjitha rastet e audituara, u konstatua se një pjesë e procesverbaleve dhe Dokumentet e Tenderit nuk janë protokolluar në protokollin e Bashkisë Krujë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Ligji nr. 43, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”; neni 23, “Specifikimet teknike”, neni 24, “Anulimi i një procedure”, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, “Kontratat për punë publike”, neni 27, pika 3, “Kontratat e mallrave”, neni 28, pika 2, “Kontratat e shërbimeve”, neni 61, pika 2, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” neni 74, pika 3, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shkaku: Mosvlerësimi i drejtë i kriterëve, kritere jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe/ose aplikimi i kriterëve të rënduara, të cilat çojnë direkt ose indirekt në uljen e numrit të OE pjesëmarrës.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe jo në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DT.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Krujë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të

miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën risk real për shpenzimet e njesisë publike.

Rekomandimi 2: Kryetari i Bashkisë Krujë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Krujë dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit, etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Hartimi i projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në Bashkinë Krujë në kuadër të procesit të rindërtimit”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 131, datë 23.02.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 131, datë 23.02.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 133, datë 23.02.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e Kufizuar Rindërtimi, Marrëveshje Kuadër	1. G.H., Kryetar 2. E.C., Anëtar 3. A.G., Anëtar	1. F.C., Kryetar 2. I.H., Anëtar 3. A.D., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 64,047,500 lekë	6. Oferta fituese: BOE “E.G.” SHPK + “E.C.G.” SHPK Oferta 63,746,100 lekë pa TVSH. Kontrata datë 16.04.2021, me afat 2 muaj nga data e lidhjes së kontratës	7. Diferenca me fondin limit: 301,400 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Faza 1: 03.03.2021 Faza 2: 30.03.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) Skualifikuar 1OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Fondi limit:

- Me shkresën nr. 361 prot., datë 19.01.2021, nga Bashkia Krujë i është kërkuar Komisionit Shtetëror të Rindërtimit financimi i projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/ përshtatëse për sipërfaqen 75,350 m², në vlerën totale 64,047,500 lekë pa TVSH, si i mbështetur në VKM-në nr. 26, datë 15.01.2020, “Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”.
- Me nr. 850, datë 05.02.2021 është protokolluar shkresa e MFE nr. 1512/2, datë 03.02.2021 “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 52, datë 27.01.2021”.
- Fondi për këtë investim është akorduar me VKM-në nr. 52, datë 27.01.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e hartimit të projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore në Bashkinë Krujë”.
- Me shkresën datë 23.02.2021, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, është caktuar detyra e projektimit për realizimin e studim-projektimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore në Bashkinë Krujë”, ku specifikisht është kërkuar të realizohet “Hartimi i dokumentacionit gjeometrik dhe teknik, analizës strukturore të thelluar, projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për ndërtesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”. Në total është përcaktuar ndërhyrja për një

sipërfaqe prej 75,350 m², në 45 ndërtesa banimi, nga të cilat 33 ndërtesa në qytetin e Krujës (20 ndërtesa me shkallën e dëmtimit DS2, 12. ndërtesa me shkallën e dëmtimit DS3 dhe 1 ndërtesë me shkallën e dëmtimit DS4) dhe 12. ndërtesa në Njësinë Administrative Fushë Krujë (11 ndërtesa me shkallën e dëmtimit DS3 dhe 1 ndërtesë me shkallën e dëmtimit DS4).

- Me shkresën datë 23.02.2021, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, është caktuar detyra e projektimit për realizimin e studim-projektimit në fjalë.

Zhvillimi i procedurës, komisionet dhe dokumentet e tenderit:

- Kërkesa për realizimin e procedurës së prokurimit, për të kryer këtë investim është bërë nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. E.S., me shkresën nr. 1215 prot., datë 23.02.2021, për vlerën 64,047,500 lekë pa TVSH, e cila ka bashkëlidhur detyrën e projektimit/termat e referencës, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe kërkesën nr. 361 prot., datë 19.01.2021, drejtuar Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për financim.

- Me nr. 1216 prot., datë 23.01.2021, ka dalë Urdhëri numër 131 i Kryetarit të Bashkisë Krujë, “Për zhvillimin e procedurës së prokurimit “E kufizuar, marrëveshje kuadër, për një afat prej 12 muajsh”...”, për objektin si më sipër, ku është përcaktuar edhe Njësia e Prokurimit, e përbërë nga G.H., Kryetar, E.C. dhe E.S., anëtarë.

- Formulari i noftimit të kontratës për procedurën e prokurimit me nr. REF88235-02-24-2021, është bërë me shkresën datë 24.02.2021.

- Me nr. 1217 prot., datë 23.02.2021, ka dalë Urdhëri nr. 132 i Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për caktimin e personave përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për hartimin e projektit...”, ku ngarkohet G.H., me detyrë Përgjegjës për Prokurimet Publike dhe E.S., me detyrë Drejtor në DPKZHT.

- Me shkresën nr. 1216/1 prot., datë 23.02.2021, janë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit, nënshkruar nga z. G.H., për aspektin ligjor dhe z. E.S., për aspektin teknik.

- Me nr. 1218 prot., datë 23.02.2021, ka dalë Urdhëri numër 133 i Kryetarit të Bashkisë Krujë, “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave...”, për objektin si më sipër, i përbërë nga F.C., Kryetar, I.H. dhe A.D., Anëtarë.

- Në datën 23.02.2021, nga Kryetari i Njësisë së Prokurimit, G.H., janë mbajtur disa procesverbale, konkretisht:

- Procesverbal për caktimin e kriterit vlerësues, ku specifikohet që vlerësimi do të bëhet në bazë të pikëzimit, konkretisht 0-10 pikë do të ketë koha e zbatimit dhe grafiku i kontratës, 60-100 pikë do të ketë çmimi më i ulët dhe 0-30 pikë do të ketë cilësia.
- Procesverbal për përzgjedhjen e procedurës së tenderit.
- Procesverbal për miratimin e dokumenteve të tenderit.

Nga auditimi, u konstatua se asnjë nga procesverbalet e mbajtura nga komisionet e prokurimit nuk është protokolluar, në mospërputhje me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

Nga auditimi, u konstatua se realizimi i projektit, sipas pikës 3 të detyrës së projektimit datë 23.02.2021 është konceptuar të bëhet me dy faza, si më poshtë:

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika 2.1., është kërkuar “Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshire edhe detyrimet vendore për vitin 2022 të leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB...”.

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

Përgjegjësia për vendosjen e kriterëve jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, është e njësisë së prokurimit.

Vlerësimi i ofertave:

➤ Faza I:

Nga auditimi, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur nga BOE “E.G.” SHPK + “E.C.G.” SHPK është fotokopje e panoterizuar dhe të gjitha dokumentet në gjuhë të huaj janë të papërkthyer, në kundërshtim me LPP, neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 5, germa a. dhe VKM-në më sipër, neni 74, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3, germa gj).

➤ Faza II:

Nga auditimi, u konstatua se BOE nuk i plotëson kriteret e kërkuara në DT, pasi:

- OE “E.C.G.” SHPK nuk ka paraqitur kopje të bilanceve dhe vërtetime të xhiros, pasi është themeluar në datën 07.01.2020, duke mos plotësuar kriterin 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.a.

Konkluzion: Megjithëse KVO në vlerësimin e kësaj procedure prokurimi është mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 2, sipas të cilit mangësitë e sipërpërmendura mund të konsiderohen si devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nga KVO duhet të ishte specifikuar kjo gjë në një procesverbal të posaçëm, si dhe duhet të ishte pasqyruar në Raportin Përfundimtar, drejtuar titullarit të AK.

Për sa më sipër BOE “E.G.” SHPK & “E.C.G.” SHPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT dhe në këto kushte KVO mund të mos e kishte kualifikuar BOE “E.G.” SHPK & “E.C.G.” SHPK.

Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 1.

Duke shpallur fitues BOE “E.G.” SHPK & “E.C.G.” SHPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 63,746,100 lekë pa TVSH.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga F.C., Kryetar, I.H. dhe A.D., Anëtarë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën 63,746,100 lekë pa TVSH.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riforcimi i njësisë të banimit në ndërtesa (pallate) të cilat do rikonstruktohen apo riparohen në kuadër të procesit të rindërtimit”

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 359, datë 21.07.2021	2. Njësia e prokurimit: Nr. 359, datë 21.07.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 360, datë 21.07.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Kufizuar, Marrëveshje kuadër”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. E.S., Anëtar	1. F.C., Kryetar; 2. R.B., Anëtar; 3. S.D./Sh., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 501,755,367 lekë		

8. Data e hapjes së tenderit: Faza 1: 01.08.2022 Faza 2: 15.08.2022	6. Oferta fituese: BOE "I." SHPK + "A." SHPK, me ofertë 497,093,331 lekë pa TVSH, Kontrata datë 14.09.2022, me afat 9 muaj e 2 javë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 4,662,036 lekë pa TVSH
9. Burimi i financimit: Buxheti Shtetit		10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE , c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me vlerësimin e ofertave.

Situata: Projekti dhe fondi limit:

- Projekti është hartuar nga BOE "E.G." SHPK + "E.C.G." SHPK, sipas procedurës së prokurimit më sipër.
- Fondi për këtë investim është akorduar me VKM-në nr. 52, datë 27.01.2021 "*Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e hartimit të projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore në Bashkinë Krujë*".

Zhvillimi i procedurës, komisionet dhe dokumentet e tenderit:

- Kërkesa për realizimin e procedurës së prokurimit, për të kryer këtë investim është bërë nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. E.S., me shkresën nr. 4592 prot., datë 21.07.2022, për vlerën 501,755,367 lekë pa TVSH, sipas projektit dhe dokumentacionit teknik të hartuar nga studio e kontraktuar "E.G." SHPK.
- Me nr. 3774 prot., datë 22.06.2022, ka dalë Urdhëri nr. 295 i Kryetarit të Bashkisë Krujë "*Për caktimin e personave përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurat e prokurimit në kuadër të procesit të rindërtimit pranë Bashkisë Krujë*", ku ngarkohet z. G.H., me detyrë Përgjegjës për Prokurimet Publike dhe z. E.S., me detyrë Drejtor në DPKZHT.
- Në datën 21.07.2022, me shkresën pa numër protokolli, janë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit, nënshkruar nga z. G.H., për aspektin ligjor dhe z. E.S., për aspektin teknik.
- Me nr. 4593 prot., datë 21.07.2022, ka dalë Urdhëri numër 359 i Kryetarit të Bashkisë Krujë, "*Për zhvillimin e procedurës së prokurimit "E kufizuar, marrëveshje kuadër, për një periudhë vlefshmërie prej 24 muajsh"...*", për objektin si më sipër, ku është përcaktuar edhe Njësia e Prokurimit, e përbërë nga G.H., Kryetar, M.K. dhe E.S., anëtarë. Fondet për këtë investim janë dhënë nga Buxheti i Shtetit, me VKM-në nr. 181, datë 30.03.2022, "*Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rirforcimit të njësive individuale të banimit në ndërtesa (pallate), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë*". Procedura e përdorur në këtë prokurim, është në zbatim të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*", neni 42, pika 6.
- Formulari i noftimit të kontratës është me shkresën pa numër protokolli, datë 21.07.2022, për procedurën e prokurimit me nr. REF36888-07-21-2022.
- Me nr. 4594 prot., datë 21.07.2022, ka dalë Urdhëri numër 360 i Kryetarit të Bashkisë Krujë, "*Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave...*", për objektin si më sipër, i përbërë nga F.C., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, Kryetar, R.B., me detyrë Specialist në DPKZHT dhe S.D., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Financës, Anëtarë.
- Në datën 21.07.2022, nga Kryetari i Njesisë së Prokurimit, z. G.H., janë mbajtur disa procesverbale, konkretisht:
 - Procesverbal për caktimin e kriterit vlerësues, ku specifikohet që vlerësimi do të bëhet në bazë të pikëzimit, konkretisht 0-10 pikë do të ketë koha e zbatimit dhe grafiku i kontratës, 60-100 pikë do të ketë çmimi më i ulët dhe 0-30 pikë do të ketë cilësia.
 - Procesverbal për zgjedhjen e procedurës së tenderit.

- Procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit.

Nga auditimi, u konstatua se procesverbalet e mësipërme janë nënshkruar nga një person i vetëm dhe si të tilla nuk plotësojnë kushtet e një procesverbali. Procesverbali është një akt shkresor në të cilin pasqyrohen rezultatet e një takimi ose mbledhjeje dhe duhet të nënshkruhet nga të gjithë personat pjesëmarrës në atë takim ose mbledhje. Gjithashtu, asnjë nga procesverbalet e mbajtura nga komisionet e prokurimit nuk është protokolluar, në mospërputhje me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2. “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, nënpika 2.1., është kërkuar “*Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2022 të leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB...*”.

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifën, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2.

- Në nënpikën 2.3.8., “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*”, kërkohet sipas tabelës më poshtë:

Lloji Makinerive	Pronësia	Sasia
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton	Ne pronësi ose me qera	2 copë
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 7.5-18 ton	Ne pronësi ose me qera	2 copë
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale të autorizuar mbi 18 ton	Ne pronësi ose me qera	1 cope
Autobetoniere	Ne pronësi ose me qera	2 copë
Autopompe betoni	Ne pronësi ose me qera	2 copë
Skela	Ne pronësi ose me qera	5000 m2
Ngrites peshash në lartësi	Ne pronësi ose me qera	4 copë
Pajisje për prerje shkëmbi (Betoni) me diamant t=20cm	Ne pronësi ose me qera	2 copë
Pirune ngrites për levizjen e materialeve	Ne pronësi ose me qera	2 cope
Trapano matrapik betoni Φ 32 mm	Ne pronësi ose me qera	2 cope
Pompë suvatimi	Ne pronësi ose me qera	4 copë
Ashpërsues i sipërfaqes së suvasë (Sabiatrice)	Ne pronësi ose me qera	2 copë
Kompresor ajri	Ne pronësi ose me qera	2 copë
Betoniere	Ne pronësi ose me qera	(cope 4)
Perzierës elektrik me xhiro të ngadalta për betonin përforcues	Ne pronësi ose me qera	(cope 4)

Nga grupi i auditimit, konstatohet se duke pasur parasysh vëllimin e punës sipas grafikut të punimeve, ku në asnjë rast nuk parashikohen punime në më shumë se katër objekte në të njëjtën kohë, kërkesa për 2 kamiona me kapacitet 7.5-18 ton, një automjet me kapacitet mbi 18 ton dhe kërkesa për 2 autobetoniere dhe 2 autopompa betoni është e tepërt dhe e paargumentuar.

Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat kërkohet disponimi i faturave, deklaratave të zhdoganimit, etj., nuk mund të vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Gjithashtu, grupi i auditimit mendon se duhet kërkuar domosdoshmërisht disponimi i një fadrome apo ekskavatori, pasi nuk sigurohet mënyra e ngarkesës së interteve të cilat do të rezultojnë nga prishjet e ndryshme.

Kriteret e mësipërme, nga grupi i auditimit konsiderohen të tepërta dhe jo në përputhje me vëllimin e punimeve të parashikuara, duke ndikuar në pjesëmarrjen e OE në prokurim dhe duke ulur konkurrencën.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pikat 1 dhe 3.

Vlerësimi i ofertave:

➤ Faza I:

Nga auditimi, u konstatua se në Fazën I, nga të dy OE pjesëmarrës nuk janë paraqitur kapacitetet teknike, ligjore dhe ekonomike, në kundërshtim me DT, Seksioni 2, “Faza 1 – Kualifikimi / marreveshja kuadër”, pika 2.1.

Oferta ekonomike dhe sigurimi i ofertës nga të dy OE pjesëmarrës janë dorëzuar në fazën e parë, në kundërshtim me pikën 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të Shtojcës 15, nën-pika 1, germat a. dhe c.

Në bazë të sa më sipër, të dy kandidatët duhet të ishin skualifikuar dhe procedura duhet të ishte anuluar.

➤ Faza II:

- Nga auditimi, u konstatua se nuk është paraqitur Përshkrimi i Ofertës, sipas Shtojcës 3 dhe sigurimi i ofertës, sipas Shtojcës 5. Këto dokumente janë paraqitur në Fazën I, ndërsa në Fazën II janë paraqitur vetëm preventivat, në kundërshtim me DT, pika 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nën-pika 1, germat a dhe c dhe LPP, neni 89, “Paraqitja dhe pranimi i ofertave”, pika 1, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 79 “Dorëzimi i ofertave”, pika 3.

- Nga auditimi, u konstatua se OE “A.” ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore vetëm për Bashkinë Tiranë, ndërkohë që nga verifikimi në internet, u konstatua se ky OE, gjatë vitit 2022 ka ushtruar aktivitet edhe në Bashkitë Durrës, Kolonjë, Berat dhe Mallakastër³.

- Nga auditimi, u konstatua se OE “I.” ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore vetëm për Bashkinë Tiranë, ndërkohë që nga verifikimi në internet, u konstatua se ky OE, gjatë vitit 2022 ka ushtruar aktivitet edhe në Bashkinë Kamëz⁴.

- Nga OE “A.” është paraqitur si teknik ndërtimi z. H.L., i cili është i punësuar me kontratë të rregullt si teknik ndërtimi, por nuk ka certifikata trajnimi të vlefshme, pasi AQSCert nuk është subjekt i akredituar për trajnimin dhe certifikimin e personelit. Gjithashtu, subjekti HVAT ka bërë trajnim për sigurinë në përdorimin e pajisjeve elektrike, e cila në këtë rast nuk nevojitet, ndërsa nga OE “I.” është paraqitur si teknik ndërtimi z. A.Sh., i cili është i punësuar me kontratë për një periudhë të pacaktuar, duke mos garantuar vlefshmërinë e kontratës gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me DT, pika 2.3.5., germa b.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithëse disponohen fatura, deklarata zhdoganimi, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohët në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre. Gjithashtu, disa deklarata doganore dhe fatura blerjeje të origjinës, janë në gjuhë të huaj dhe të papërkthyer, në kundërshtim me LPP dhe DT.

Konkluzion: Sa më sipër BOE “I.” SHPK & “A.” SHPK nuk plotëson kriteret e vendosura në DT dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE “I.” SHPK & “A.” SHPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si më poshtë:

³ https://spending.data.al/en/treasury/list/faqe/2/year/2019/perf_id/ARKONSTUDIO

⁴ https://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/perf_id/I.DA

Neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Duke shpallur fitues BOE “I.” SHPK & “A.” SHPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 497,093,331 lekë pa TVSH.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga F.C., Kryetar, I.H. dhe A.D., Anëtarë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 497,093,331 lekë pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shembja e njërive individuale të banimit të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimi i materialeve të dala prej tyre në Bashkinë Krujë, në kuadër të procesit të rindërtimit”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 367, datë 25.07.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 367, datë 25.07.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 368, datë 25.07.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e kufizuar rindërtimi, Marrëveshje kuadër”	1. G.H., Kryetar; 2. E.C., Anëtar; 3. A.G., Anëtar	1. F.C., Kryetar; 2. A.H., Anëtar; 3. A.D., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 115,965,523 lekë	6. Oferta fituese: BOE “B.C.” SHPK + “K.K.” SHPK, 115,251,570 lekë pa TVSH, me kontratë datë 07.10.2022, me afat 150 ditë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 713,953 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Faza 1: 05.08.2022 Faza 2: 19.09.2022	9. Burimi Financimit: Buxheti Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me vlerësimin e ofertave.

Situata: Projekti dhe fondi limit:

- Me shkresën nr. 3786 prot., datë 22.06.2022, nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Krujë është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objektin në fjalë, bashkëlidhur së cilës është preventivi përmbledhës dhe analitik, grafiku i punimeve, specifikimet teknike, kërkesat e veçanta për kualifikim, si dhe Akt ekspertizat nga Instituti i Ndërtimit, për prishjen e objekteve sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Njësia Administrative	Numri i banesave	Volumi total m ³
1	Krujë	171	19,619.5
2	Cudhi	72	18,121.1
3	Fushë Krujë	162	13,889.4
4	Thumanë	208	33,937.0
5	Bubq	182	22,723.4
6	Nikël	56	8,251.6
Totali		851	116,541.9

- Preventivi është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Krujë dhe është nënshkruar nga E.S., R.B., A.D., Xh.M. dhe I.K..

- Fondet për këtë investim janë dhënë nga Buxheti i Shtetit, me VKM-në nr. 180, datë 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në Bashkinë Krujë”.

- Projekti është hartuar nga punonjësit e DPKZHT, Bashkia Krujë, të cilët nuk janë të pajisur me licencë profesionale, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5.

Zhvillimi i procedurës, komisionet dhe dokumentet e tenderit:

- Me nr. 3774 prot., datë 22.06.2022, ka dalë Urdhëri nr. 295 i Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për caktimin e personave përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurat e prokurimit në kuadër të procesit të rindërtimit pranë Bashkisë Krujë”, ku ngarkohet z. G.H., me detyrë Përgjegjës për Prokurimet Publike dhe z. E.S., me detyrë Drejtor në DPKZHT.

- Në datën 22.06.2022, me shkresën pa numër protokoll, janë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit, nënshkruar nga z. G.H., për aspektin ligjor dhe z. E.S., për aspektin teknik.

- Me nr. 3787 prot., datë 22.06.2022, ka dalë Urdhëri numër 296 i Kryetarit të Bashkisë Krujë, “Për zhvillimin e procedurës së prokurimit “E kufizuar, marrëveshje kuadër, për një periudhë vlefshmërie prej 24 muajsh”...”, për objektin si më sipër, ku është përcaktuar edhe Njësia e Prokurimit, e përbërë nga G.H., Kryetar, E.C. dhe A.G., anëtarë.

- Formulari i noftimit të kontratës është me shkresën pa numër protokoll, datë 22.06.2022, për procedurën e prokurimit me nr. REF33790-06-22-2022.

- Me nr. 3788 prot., datë 22.06.2022, ka dalë Urdhëri numër 297 i Kryetarit të Bashkisë Krujë, “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave...”, për objektin si më sipër, i përbërë nga F.C., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, Kryetar, A.H., me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe A.D., me detyrë Specialiste në DPKZHT, Anëtarë.

- Në datën 22.06.2022, nga Kryetari i Njesisë së Prokurimit, z. G.H., janë mbajtur disa procesverbale, konkretisht:

- Procesverbal për caktimin e kriterit vlerësues, ku specifikohet që vlerësimi do të bëhet në bazë të pikëzimit, konkretisht 0-10 pikë do të ketë koha e zbatimit dhe grafiku i kontratës, 60-100 pikë do të ketë çmimi më i ulët dhe 0-30 pikë do të ketë cilësia.
- Procesverbal për zgjedhjen e procedurës së tenderit.
- Procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nën-pika 2.1., është kërkuar “Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2022 të leshuar nga ana e njësise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB...”.

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Në nën-pikën 2.3.4., “Personeli dhe fuqia punëtore”, është kërkuar punësimi i të paktën 56 personave, duke përfshirë stafin e përhershëm. Nga grupi i auditimit, duke pasur parasysh se numri total i të gjithë punonjësve që kërkohen, për të gjitha nivelet dhe profesionet është 52 persona sipas tabelës më poshtë, duke pasur parasysh që OE mund të jetë i angazhuar edhe në sipërmarrje të tjera publike apo private, konstatohet se numri prej 60 persona të punësuar është i papërshtatshëm dhe i paargumentuar.

-

Nr.	Profesioni	Sasia
1	Inxhinier ndërtimi	1
2	Teknik ndërtimi	2
3	Drejtues mjete	9
4	Eskavatorist/Manovrator	6
5	Elektricitist	1
6	Hidraulik	1
7	Punëtorë të thjeshtë	40
Totali		60

Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat kërkohet disponimi i faturave, deklaratave të zhdoganimit, etj., nuk mund të vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Kriteret e mësipërme, nga grupi i auditimit konsiderohen të tepërta dhe jo në përputhje me vëllimin e punimeve të parashikuara, duke ndikuar në pjesëmarrjen e OE në prokurim dhe duke ulur konkurrencën.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pikat 1 dhe 3.

Vlerësimi i ofertave:

➤ Faza I:

- Nga auditimi, u konstatua se OE “K.K.” ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore vetëm për Bashkinë Tiranë, ndërkohë që nga verifikimi në internet, u konstatua se ky OE, gjatë vitit 2022 ka ushtruar aktivitet edhe në Bashkinë Durrës, me AK Autoritetin Portual Durrës, për tenderin me objekt “Zbatimi i projektit për zyrat modulare për agjensitë doganore”, i cili është zhvilluar në datën 12.07.2021, me afat 6 muaj⁵. Për këtë objekt, OE “K.K.” ka deklaruar kontratën e lidhur, por megjithëse ka kaluar mbi gjashtë muaj nga data e fillimit të punimeve, ende nuk e ka përfunduar, duke vënë në pikëpyetje realizimin e kontratës me Bashkinë Krujë.

- Makineritë teknologjike (ekskavatorët me zinxhirë, miniekskavatori dhe minifadroma e paraqitur, nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”.

- OE “K.K.”, ka paraqitur faturë të vitit 2010 për 4 depozita uji nga 1000 litra, por, nga verifikimi i “Pasqyrës së amortizimit të aktiveve të qëndrueshme”, bashkëlidhur bilancit, u konstatua se disponon vetëm një depozitë 3000 litra. OE “B.C.” ka paraqitur faturë me datë 28.06.2022 për 4 depozita x 1000 litra.

- OE “K.K.”, ka paraqitur faturë të vitit 2016 për 3 kuti të ndihmës së shpejtë, ndërsa OE “B.C.” ka paraqitur faturë të vitit 2011 për 10 kuti të ndihmës së shpejtë dhe faturë të vitit 2021 për 4 kuti.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithëse disponohen fatura, deklarata zhdoganimi, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre. Gjithashtu, disa deklarata doganore dhe fatura blerjeje të origjinës, janë në gjuhë të huaj dhe të papërkthyer, në kundërshtim me LPP dhe DT.

➤ Faza II:

⁵ <https://openprocurement.al/en/pcompany/vieë/id/7766>

Nga auditimi, u konstatua se Faza II është zhvilluar në rregull dhe pavarësisht mënyrës së gabuar të ndjekur për vlerësimin e ofertave, fituese është shpallur oferta më e ulët.

Konkluzion: Megjithëse KVO në vlerësimin e kësaj procedure prokurimi gjatë Fazës I është mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 2, sipas të cilit mangësitë e sipërpërmendura mund të konsiderohen si devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nga KVO duhet të ishte specifikuar kjo gjë në një procesverbal të posaçëm, si dhe duhet të ishte pasqyruar në Raportin Përfundimtar, drejtuar titullarit të AK.

Sa më sipër BOE “B.C.” SHPK & “K.K.” SHPK nuk plotëson kriteret e vendosura në DT dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE “B.C.” SHPK & “K.K.” SHPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 1.

Duke shpallur fitues BOE “B.C.” SHPK & “K.K.” SHPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 115,965,523 lekë pa TVSH.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga F.C., Kryetar, I.H. dhe A.D., Anëtarë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 115,965,523 lekë pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në lidhje me sa më sipër, nga Bashkia Krujë është paraqitur observacioni me nr. 4971/1 prot., datë 15.06.2023, i administruar në KLSH me nr. 206/7 prot., datë 19.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Kundërshtitë e paraqitura janë të njëjta me ato të cilat janë paraqitur për Aktin e Konstatimit dhe që janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, në lidhje me pagesën e detyrimeve vendore dhe detyrimin për ta vërtetuar këtë pagesë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Duke qenë se observacioni i paraqitur nuk përmban asnjë dokument, fakt apo provë të re, të panjohur nga grupi i auditimit dhe të patrajtuar gjatë zhvillimit të auditimit në terren apo gjatë fazës së hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, gjithashtu, duke i gjetur këto kundërshti të njëjta me kundërshtitë e paraqitura për Aktet e Konstatimit, observacioni nuk merret në konsideratë.

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, Nj.A.Nikël, Krujë”

1. Urdhër Prokurimi : Nr. 380, datë 27.07.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 380, datë 27.07.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 381, datë 27.07.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. F.C., Kryetar; 2. A.D., Anëtar; 3. M.C., Anëtar;

5. Fondi Limit (pa Tvsh) 24,483,917 lekë	6. Oferta fituese: "B." SHPK, 18,435,326 lekë pa tvsh, me kontratë datë 21.09.2022, me afat 115 ditë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 6,048,591 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 12.08.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 4 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.

Situata: Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave: Me urdhërin e Prokurimit nr. 380, me nr. 4701 prot., datë 27.07.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Krujë z. A.B., urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 24,483,917 lekë pa TVSH, për objektin: "Sistemim-asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, Nj.A. Nikël, Krujë".

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga G.H., Kryetar, M.K. dhe A.G., anëtarë. Numri i referencës së prokurimit është REF-37299-07-27-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 12.08.2022, ora 10:00.

Kriteret e veçanta të kualifikimit, janë hartuar nga Ing. A.D., me detyrë inxhinier në DPZHT, Bashkia Krujë, në bazë të Urdhërit nr. 04, me nr. 52 prot., datë 07.01.2022, "Për ngarkimin e strukturave përgjegjëse, ...".

KVO është ngritur me urdhërin nr. 381, me nr. 4702 prot., datë 27.07.2022.

Projekti dhe fondi limit: Nga DPZHT Bashkia Krujë, me shkresën nr. 4700 prot., datë 27.07.2022, bashkëlidhur së cilës gjendet Projekti, Preventivi, Grafiku i punimeve, Raporti teknik, Specifikimet teknike dhe Raporti i ndikimit në mjedis (të hartuara nga Shoqëria "E.G."), është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt si më sipër.

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Krujë, i miratuar me Vendimin nr. 13, datë 28.02.2021 të Këshillit Bashkiak Krujë, "Për miratimin e shtesës së buxhetit të vitit 2022", i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 190/2 prot., datë 07.03.2022. Financimi është parashikuar për t'u kryer për 2 vite: 11,788,260 lekë për vitin 2022 dhe 17,592,440 lekë për vitin 2023.

Në procesverbalin datë 12.04.2022, të mbajtur nga Njësia e Prokurimit për kriteret e kualifikimit, specifikimet teknike, etj., është specifikuar që përllogaritja e fondit limit i cili konfirmon preventivin e përllogaritur nga studio projektuese, është bërë në përputhje me Vendimin nr. 629, datë 15.07.2015 të KM "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2. "Kriteret e veçanta të kualifikimit", nën-pika 2.1., është kërkuar "Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2022 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB...".

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", pika 2.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat kërkohet disponimi i faturave, deklaratave të zhdoganimit, etj., nuk mund të vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Vlerësimi i ofertave: Nga Procesverbali mbi hapjen e ofertave, datë 12.08.2022, u konstatua pjesëmarrja e gjashtë Operatorëve Ekonomikë.

Nga Procesverbali mbi vlerësimin e ofertave, datë 26.08.2022, u konstatua se janë skualifikuar dy dhe janë kualifikuar katër Operatorë Ekonomikë. Është shpallur fituese oferta e OE “B.” SHPK, me vlerë 18,435,326 lekë pa tvsh, si oferta me vlerën më të ulët e kualifikuar.

Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 4700/2 prot., datë 07.09.2022 dhe nga Titullari i AK Bashkia Krujë, ka dalë Urdhëri nr. 499, me nr. 6144 prot., datë 21.09.2022 “Për lidhjen dhe zbatimin e kontratës”. Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 6145 prot., datë 21.09.2022. Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatrëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	B.	18,435,326	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	C.R.	18,972,462	Kualifikuar
3	D.	19,968,830	Kualifikuar
4	S.U.	15,787,730	<p><u>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:</u> <i>Sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe konkretisht, neni 93 te Ligjit Nr. 162.2022 , “ Per prokurimin publik” , i ndryshuar, neni 82 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” , si dhe te pikes seksioni 1 pika 22 te DST citohet</i> <i>- Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.</i> <i>- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.</i> <i>- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.</i> <i>Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.</i> <i>Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e neni 93 të LPP-së.</i> <i>Komisioni i vlerësimit te ofertave i ngritur prane bashkise Kruje me urdherin Nr. 381 date 27.07.2022 per proceduren e prokurimit “ Sistemim Asfaltim I Rrugës “ Kroji I Bardhe – Kurcaj, Nj.A Nikel”, gjate vlerësimit veren se oferta e paraqitur nga subjekti me vlere 15,787,730 leke pa TVSH, ne baze te perlllogaritjeve rezultoi te jete nen vleren 85 % te mesatares se ofertave te vlefshme qe ishte 15,878,307.00 leke pa TVSH dhe rrjedhimisht konsiderohet si oferte anomalisht e ulet.</i> <i>Persa me siper komisioni i vlerësimit te ofertave prane autoritetit kontraktor, Bashkia Kruje, kerkoi nga subjekti ofertues ne baze te ligjit:</i> <i>-shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:</i> <i>a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; (analize e nxjerrjes se kosos per njesi per cdo produkt te preventivit)</i> <i>b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;</i> <i>c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;</i> <i>Duke gene se kerkesa e autoritetit kontraktor Bashkia Kruje nuk mori pergjigje persa kerkohej, KVO ne tagrin qe i jep ligji, e gjykon si oferte jashte logjikes ekonomike duke pare rendesine dhe veshtiresine e punes ne zbatim dhe rrjedhimisht oferta e subjektit nuk mund te pranohet si e vlefshme.</i></p>
5	K.T.	20,237,460	Kualifikuar
6	U.		<p><u>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:</u> <i>- Subjekti ofertues nuk ka paraqitur vlere ekonomike pasi ka ngarkuar dokumentat per nje tjetër objekt prokurimi jo objektin per te cilin po procedohet.</i></p>

Nga grupi i auditimit, u konstatua se qëndron argumenti i përdorur nga KVO për skualifikimin e ofertës të OE S.U., si anomalisht e ulët.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

- Makineritë teknologjike (ekskavatori, rrulat dhe asfaltoshtruesja), nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe

siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “*Makinat teknologjike*” dhe neni 113 “*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*”.

Gjithashtu, dokumentacioni shoqëruar i këtyre makinerive është në gjuhë të huaj, i papërkthyer.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithëse disponohen fatura, deklarata zhdoganimi, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Konkluzion: Megjithëse KVO në vlerësimin e kësaj procedure prokurimi është mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, neni 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, paragrafi 2, sipas të cilit mangësitë e sipërpërmendura mund të konsiderohen si devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nga KVO duhet të ishte specifikuar kjo gjë në një procesverbal të posaçëm, si dhe duhet të ishte pasqyruar në Raportin Përfundimtar, drejtuar titullarit të AK.

Duke pasur parasysh se qëndron skualifikimi i dy OE sipas tabelës më sipër, si dhe duke pasur parasysh që OE i shpallur fitues ka ofertuar vlerën më të ulët nga katër OE të kualifikuar, si dhe duke i konsideruar mangësitë e konstatuara si “*devijime të vogla*”, në kuptimin e nenit 92 të LPP “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, paragrafi i fundit.

Sa më sipër, grupi i auditimit mendon se kualifikimi dhe shpallja fitues e OE “B.” SHPK për këtë procedurë është e rregullt dhe në përputhje me kriteret e vendosura në DT dhe dispozitat ligjore për Prokurimin Publik.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekt: Prokurim i fondeve publike jo në përputhje të plotë me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 18,435,326 lekë pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës “Mezine”, Nj. A. Thumanë, Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 466, datë 14.09.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 466, datë 14.09.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 467, datë 14.09.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. F.C., Kryetar; 2. O.L., Anëtar; 3. R.B., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 20,711,057 lekë	6. Oferta fituese: “C.R.” sh.p.k ofertë 13,556,589 lekë pa TVSH, me kontratë datë 31.10.2022, me afat 84 dite nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 7,154,468 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 04.10.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 8 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 8 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.

Situata: Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave: Me urdhërin e Prokurimit nr. 466, me nr. 5890 prot., datë 14.09.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Krujë z. A.B., urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 20,711,057 lekë pa TVSH, për objektin: “*Sistemim-asfaltim i rrugës “Mezine”, Nj. A. Thumanë, Krujë*”.

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga G.H., Kryetar, M.K. dhe A.G., anëtarë. Numri i referencës së prokurimit është REF-41890-15-09-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 30.09.2022, ora 10:00.

Kriteret e veçanta të kualifikimit, janë hartuar nga Ing. A.D., me detyrë inxhinier në DPZHT, Bashkia Krujë, në bazë të Urdhërit nr. 04, me nr. 52 prot., datë 07.01.2022, “Për ngarkimin e strukturave përgjegjëse”.

KVO është ngritur me urdhërin nr. 467, me nr. 5891 prot., datë 14.09.2022.

Projekti dhe fondi limit: Nga DPZHT Bashkia Krujë, me shkresën nr. 5889 prot., datë 14.09.2022, bashkëlidhur së cilës gjendet Projekti, Preventivi, Grafiku i punimeve, Raporti teknik, Specifikimet teknike, Raporti i ndikimit në mjedis dhe Kërkesat e veçanta për kualifikim (të hartuara nga Shoqëria “H.C.”), është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt si më sipër.

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Krujë, i miratuar me Vendimin nr. 13, datë 28.02.2021 të Këshillit Bashkiak Krujë, “Për miratimin e shtesës së buxhetit të vitit 2022”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 190/2 prot., datë 07.03.2022. Financimi është parashikuar për t’u kryer për 2 vite: 10,626,978 lekë për vitin 2022 dhe 10,084,078 lekë për vitin 2023.

Në procesverbalin datë 14.09.2022, të mbajtur nga Njësia e Prokurimit për kriteret e kualifikimit, specifikimet teknike, etj., është specifikuar që përllogaritja e fondit limit i cili konfirmon preventivin e përllogaritur nga studio projektuese, është bërë në përputhje me Vendimin nr. 629, datë 15.07.2015 të KM “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika 2.1., është kërkuar “Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2022 të leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB”.

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat kërkohet disponimi i faturave, deklaratave të zhdoganimit, etj., nuk mund të vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Këto kriteret, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe 3.

Vlerësimi i ofertave: Nga Procesverbali mbi hapjen e ofertave, datë 04.10.2022, u konstatua pjesëmarrja e tetë Operatorëve Ekonomikë.

Nga Procesverbali mbi vlerësimin e ofertave, me nr. 5889/1 prot., datë 14.10.2022, u konstatua se janë kualifikuar të gjithë Operatorët Ekonomikë ofertues. Është shpallur fituese oferta e OE “C.R.” SHPK, me vlerë 13,556,589 lekë pa tvsh, si oferta me vlerën më të ulët.

Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 5889/2 prot., datë 28.10.2022 dhe nga Titullari i AK Bashkia Krujë, ka dalë Urdhëri nr. 606, me nr. 7424 prot., datë 31.10.2022 “Për lidhjen dhe zbatimin e kontratës”. Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 7425 prot., datë 31.10.2022. Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatrëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	C.R.	13,556,589	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	D.	13,938,225	Kualifikuar
3	K.D.	14,027,700	Kualifikuar
4	2.	14,621,580	Kualifikuar
5	BOE M. & N.	14,703,500	Kualifikuar
6	B.	14,976,060	Kualifikuar
7	K.T.	15,300,540	Kualifikuar
8	N.	17,545,340	Kualifikuar

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

- Makineritë teknologjike (rrulat, grejderi dhe asfaltoshtuesja), nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “*Makinat teknologjike*” dhe neni 113 “*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*”.

Gjithashtu, dokumentacioni shoqërues i këtyre makinerive është në gjuhë të huaj, i papërkthyer.

- OE C.R. nuk ka paraqitur vërtetime për pagesën e taksave vendore nga të gjitha bashkitë ku ka kryer aktivitet. Ka paraqitur vërtetim nga bashkitë Kamëz dhe Kurbin, po nuk ka paraqitur vërtetim nga bashkitë Patos, Tiranë, Bulqizë, Divjakë, Mat dhe Lezhë⁶.

- OE C.R. nuk ka paraqitur lejen e transportit për autobitumatriçen e marrë me qera nga shoqëria E. SHPK.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithëse disponohen fatura, deklarata zhdoganimi, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Konkluzion: Sa më sipër OE “C.R.” SHPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT dhe KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “C.R.” SHPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, neni 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE “C.R.” SHPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 13,556,589 lekë pa TVSH.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 13,556,589 lekë pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në lidhje me sa më sipër, nga Bashkia Krujë është paraqitur observacioni me nr. 4971/5 prot., datë 15.06.2023, i administruar në KLSH me nr. 206/7 prot., datë 19.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

⁶ https://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/perf_id/COMPANYRIVIERA2008

Kundërshtitë e paraqitura janë të njëjta me ato të cilat janë paraqitur për Aktin e Konstatimit dhe që janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, në lidhje me pagesën e detyrimeve vendore dhe detyrimin për ta vërtetuar këtë pagesë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Duke qenë se observacioni i paraqitur nuk përmban asnjë dokument, fakt apo provë të re, të panjohur nga grupi i auditimit dhe të patrajtuar gjatë zhvillimit të auditimit në terren apo gjatë fazës së hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, gjithashtu, duke i gjetur këto kundërshti të njëjta me kundërshtitë e paraqitura për Aktet e Konstatimit, observacioni nuk merret në konsideratë.

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës së Kapllanëve, Nj. A. Fushë Krujë, Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 400, datë 03.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 400, datë 03.08.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 401, datë 03.08.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur e thjeshtuar”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. R.B., Kryetar; 2. A.B., Anëtar; 3. I.K., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 8,256,970 lekë	6. Oferta fituese: “B.” sh.p.k., me ofertë 6,400,264 lekë pa TVSH, me kontratë datë 21.09.2022, me afat 84 ditë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 1,856,706 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 15.08.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.

Situata: Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave: Me urdhërin e Prokurimit nr. 400, me nr. 4859 prot., datë 03.08.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Krujë z. A.B., urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 8,256,970 lekë pa TVSH, për objektin: “Sistemim-asfaltim i rrugës së Kapllanëve, Nj. A. Fushë Krujë, Krujë”.

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga G.H., Kryetar, M.K. dhe A.G., anëtarë. Numri i referencës së prokurimit është REF-37823-08-03-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 15.08.2022, ora 10:00.

Kriteret e veçanta të kualifikimit, janë hartuar nga Ing. A.D., me detyrë inxhinier në DPZHT, Bashkia Krujë, në bazë të Urdhërit nr. 04, me nr. 52 prot., datë 07.01.2022, “Për ngarkimin e strukturave përgjegjëse, ...”.

KVO është ngritur me urdhërin nr. 401, me nr. 4860 prot., datë 03.08.2022.

Projekti dhe fondi limit: Nga DPZHT Bashkia Krujë, me shkresën nr. 4858 prot., datë 03.08.2022, bashkëlidhur së cilës gjendet Projekti, Preventivi, Grafiku i punimeve, Raporti teknik, Specifikimet teknike, Raporti i ndikimit në mjedis dhe Kërkesat e veçanta për kualifikim (të hartuara nga Shoqëria “E.G.”), është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt si më sipër.

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Krujë, i miratuar me Vendimin nr. 13, datë 28.02.2021 të Këshillit Bashkiak Krujë, “Për miratimin e shtesës së buxhetit të vitit 2022”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 190/2 prot., datë 07.03.2022. Financimi është parashikuar për t’u kryer për 2 vite: 4,128,485 lekë për vitin 2022 dhe 4,128,485 lekë për vitin 2023.

Në procesverbalin datë 03.08.2022, të mbajtur nga Njësia e Prokurimit për kriteret e kualifikimit, specifikimet teknike, etj., është specifikuar që përllogaritja e fondit limit i cili konfirmon preventivin e përllogaritur nga studio projektuese, është bërë në përputhje me Vendimin nr. 629, datë 15.07.2015 të KM “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2. “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, nënpika 2.1., është kërkuar “*Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2022 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB...*”.

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat kërkohet disponimi i faturave, deklaratave të zhdoganimit, etj., nuk mund të vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “*Kërkesat për kualifikim*”, pika 4 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 39 “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pikat 1 dhe 3.

Vlerësimi i ofertave: Nga Procesverbali mbi hapjen e ofertave, datë 15.08.2022, u konstatua pjesëmarrja e dy Operatorëve Ekonomikë.

Nga Procesverbali mbi vlerësimin e ofertave, me nr. 4858/1 prot., datë 19.08.2022, u konstatua se janë kualifikuar të dy Operatorët Ekonomikë ofertues. Është shpallur fituese oferta e OE “B.” SHPK, me vlerë 6,400,264 lekë pa tvsh, si oferta me vlerën më të ulët.

Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 4858/2 prot., datë 29.08.2022 dhe nga Titullari i AK Bashkia Krujë, ka dalë Urdhëri nr. 494, me nr. 6121 prot., datë 21.09.2022 “*Për lidhjen dhe zbatimin e kontratës*”. Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 6122 prot., datë 21.09.2022. Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatrëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	B.	6,400,264	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	K.T.	6,773,520	Kualifikuar

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

- Makineritë teknologjike (ekskavatori, rrulat dhe asfaltoshtruesja), nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “*Makinat teknologjike*” dhe neni 113 “*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*”.

Gjithashtu, dokumentacioni shoqërues i këtyre makinerive është në gjuhë të huaj, i papërkthyer.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithëse disponohen fatura, deklaratat zhdoganimi, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Konkluzion: Megjithëse KVO në vlerësimin e kësaj procedure prokurimi është mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, neni 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, paragrafi 2, sipas të cilit mangësitë e sipërpërmendura mund të konsiderohen si devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nga KVO duhet të ishte specifikuar kjo gjë në një procesverbal të posaçëm, si dhe duhet të ishte pasqyruar në Raportin Përfundimtar, drejtuar titullarit të AK.

Duke pasur parasysh se OE i shpallur fitues ka ofertuar vlerën më të ulët nga dy OE të kualifikuar, si dhe duke i konsideruar mangësitë e konstatuara si “*devijime të vogla*”, në kuptimin e nenit 92 të LPP “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, paragrafi i fundit.

Sa më sipër, grupi i auditimit mendon se kualifikimi dhe shpallja fitues e OE “B.” SHPK për këtë procedurë është e rregullt dhe në përputhje me kriteret e vendosura në DT dhe dispozitat ligjore për Prokurimin Publik.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike jo në përputhje të plotë me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 6,400,264 lekë pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës së “Hakëve” dhe “Ura e Telit”, Nj. A. Nikël, Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 505, datë 22.09.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 505, datë 22.09.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 506, datë 22.09.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. M.Ç., Kryetar; 2. S.D., Anëtar; 3. S.Sh., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 14,142,517 lekë	6. Oferta fituese: “Rr.G.” sh.p.k., me ofertë 10,999,858 lekë pa TVSH, me kontratë datë 14.11.2022, me afat 68 ditë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 3,142,659 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 11.10.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 4 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.

Situata: Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave: Me urdhërin e Prokurimit nr. 505, me nr. 6185 prot., datë 22.09.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Krujë z. A.B., urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 14,142,517 lekë pa TVSH, për objektin: “*Sistemim-asfaltim i rrugës së “Hakëve” dhe “Ura e Telit”, Nj. A. Nikël, Krujë*”.

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga G.H., Kryetar, M.K. dhe A.G., anëtarë. Numri i referencës së prokurimit është REF-43162-09-23-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 11.10.2022, ora 10:00.

Kriteret e veçanta të kualifikimit, janë hartuar nga Ing. A.D., me detyrë inxhinier në DPZHT, Bashkia Krujë, në bazë të Urdhërit nr. 04, me nr. 52 prot., datë 07.01.2022, “*Për ngarkimin e strukturave përgjegjëse, ...*”.

KVO është ngritur me urdhërin nr. 506, me nr. 6186 prot., datë 22.09.2022.

Projekti dhe fondi limit: Nga DPZHT Bashkia Krujë, me shkresën nr. 6184 prot., datë 22.09.2022, bashkëlidhur së cilës gjendet Projekti, Preventivi, Grafiku i punimeve, Raporti teknik, Specifikimet teknike, Raporti i ndikimit në mjedis dhe Kërkesat e veçanta për kualifikim (të hartuara nga Shoqëria “E.G.”), është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt si më sipër.

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Krujë, i miratuar me Vendimin nr. 73, datë 09.08.2022 të Këshillit Bashkiak Krujë, “*Për miratimin e shtesës së buxhetit të vitit 2022*”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 651/10 prot., datë 18.08.2022.

Në procesverbalin datë 22.09.2022, të mbajtur nga Njësia e Prokurimit për kriteret e kualifikimit, specififikimet teknike, etj., është specifikuar që përllogaritja e fondit limit i cili konfirmon preventivin e përllogaritur nga studio projektuese, është bërë në përputhje me Vendimin nr. 629, datë 15.07.2015 të KM “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika 2.1., është kërkuar “Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2022 të lëshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB...”.

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat kërkohet disponimi i faturave, deklaratave të zhdoganimit, etj., nuk mund të vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Këto kriteret, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pikat 1 dhe 3.

Vlerësimi i ofertave: Nga Procesverbali mbi hapjen e ofertave, datë 11.10.2022, u konstatua pjesëmarrja e pesë Operatorëve Ekonomikë.

Nga Procesverbali mbi vlerësimin e ofertave, me nr. 6184/1 prot., datë 26.10.2022, u konstatua se janë kualifikuar katër Operatorë Ekonomikë ofertues. Është shpallur fituese oferta e OE “Rr.G.” sh.p.k., me ofertë 10,999,858 lekë pa TVSH, si oferta me vlerën më të ulët.

Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 6184/2 prot., datë 07.11.2022 dhe nga Titullari i AK Bashkia Krujë, ka dalë Urdhëri nr. 647, me nr. 7948 prot., datë 14.11.2022 “Për lidhjen dhe zbatimin e kontratës”. Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 7949 prot., datë 14.11.2022. Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatorëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	Rr.G.	10,999,858	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	K.D.	11,141,774	Kualifikuar
3	K.T.	11,422,188	Kualifikuar
4	D.	11,799,910	Kualifikuar
5	B.	-	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: Subjekti ofertues nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

- OE Rr.G. nuk ka paraqitur vërtetime për pagesën e taksave vendore nga të gjitha bashkitë ku ka kryer aktivitetet. Ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Shkodër, po nuk ka paraqitur vërtetim nga bashkitë Lezhë, Tiranë dhe Durrës⁷.

- Makineritë teknologjike (grejderi, rrulat dhe asfaltoshtruesja), nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”.

Gjithashtu, dokumentacioni shoqëruar i këtyre makinerive është në gjuhë të huaj, i papërkthyer.

⁷ https://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/perf_id/RROKUGUEST

- OE Rr.G. nuk vërteton disponimin e matrapikut të ekskavatorit dhe autobitumatriçen.
Konkluzion: Sa më sipër OE “Rr.G.” SHPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT dhe KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “Rr.G.” SHPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE “Rr.G.” SHPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 10,999,858 lekë pa TVSH.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekt: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 10,999,858 lekë pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

8. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Hapje rruge, rrethim e sistemim i varrezave Katolike e Muslimane Thumanë, Bashkia Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 426, datë 15.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 426, datë 15.08.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 427, datë 15.08.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur e thjeshtuar”	1. G.H., Kryetar; 2. E.C., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. R.B., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. M.P., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 10,100,268 lekë	6. Oferta fituese: “2.” sh.p.k., me ofertë 7,622,920 lekë pa TVSH, me kontratë datë 05.10.2022, me afat 50 ditë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 2,477,348 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 26.08.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 4 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.

Situata: Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave: Me urdhërin e Prokurimit nr. 426, me nr. 5072 prot., datë 15.08.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Krujë z. A.B., urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 10,100,268 lekë pa TVSH, për objektin: “Hapje rruge, rrethim e sistemim i varrezave Katolike e Muslimane Thumanë, Bashkia Krujë”.

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga G.H., Kryetar, E.C. dhe A.G., anëtarë. Numri i referencës së prokurimit është REF-38936-08-15-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 26.08.2022, ora 10:00.

Kriteret e veçanta të kualifikimit, janë hartuar nga Ing. A.D., me detyrë inxhinier në DPZHT, Bashkia Krujë, në bazë të Urdhërit nr. 04, me nr. 52 prot., datë 07.01.2022, “Për ngarkimin e strukturave përgjegjëse, ...”.

KVO është ngritur me urdhërin nr. 427, me nr. 5073 prot., datë 15.08.2022.

Projekti dhe fondi limit: Nga DPZHT Bashkia Krujë, me shkresën nr. 5071 prot., datë 15.08.2022, bashkëlidhur së cilës gjendet Projekti, Preventivi, Grafiku i punimeve, Raporti teknik, Specifikimet teknike, Raporti i ndikimit në mjedis dhe Kërkesat e veçanta për kualifikim (të hartuara nga Shoqëria “E.G.”), është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt si më sipër.

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Krujë, i miratuar me Vendimin nr. 13, datë 28.02.2021 të Këshillit Bashkiak Krujë, “Për miratimin e shtesës së buxhetit të vitit 2022”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 190/2 prot., datë 07.03.2022. Financimi është parashikuar për t’u kryer për 2 vite: 5,050,137 lekë për vitin 2022 dhe 6,060,164 lekë për vitin 2023.

Në procesverbalin datë 14.09.2022, të mbajtur nga Njësia e Prokurimit për kriteret e kualifikimit, specifikimet teknike, etj., është specifikuar që përllogaritja e fondit limit i cili konfirmon preventivin e përllogaritur nga studio projektuese, është bërë në përputhje me Vendimin nr. 629, datë 15.07.2015 të KM “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika 2.1., është kërkuar “Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2022...”.

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat kërkohet disponimi i faturave, deklaratave të zhdoganimit, etj., nuk mund të vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pikat 1 dhe 3.

Vlerësimi i ofertave: Nga Procesverbali mbi hapjen e ofertave, datë 26.08.2022, u konstatua pjesëmarrja e katër Operatorëve Ekonomikë.

Nga Procesverbali mbi vlerësimin e ofertave, me nr. 5071/1 prot., datë 31.08.2022, u konstatua se janë kualifikuar të gjithë Operatorët Ekonomikë ofertues. Është shpallur fituese oferta e OE “2.” SHPK, me vlerë 7,622,920 lekë pa tvsh, si oferta me vlerën më të ulët.

Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 5071/2 prot., datë 08.09.2022 dhe nga Titullari i AK Bashkia Krujë, ka dalë Urdhëri nr. 546, me nr. 6623 prot., datë 05.10.2022 “Për lidhjen dhe zbatimin e kontratës”. Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 6624 prot., datë 05.10.2022. Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatrëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	2.	7,622,920	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	B.	9,394,370	Kualifikuar
3	K.T.	7,862,840	Kualifikuar
4	K.D.	9,655,570	Kualifikuar

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

- OE 2. nuk ka paraqitur vërtetime për pagesën e taksave vendore nga të gjitha bashkitë ku ka kryer aktivitet. Ka paraqitur vërtetim nga bashkitë Tiranë dhe Kamëz, po nuk ka paraqitur

vërtetim nga bashkitë Dibër, Krujë, Belsh, Elbasan, Durrës, Vlorë, Kukës, Mat, Shkodër dhe Korçë⁸.

- Makineritë teknologjike (ekskavatori, grejderi, rrulat dhe asfaltoshtruesja), nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”. Gjithashtu, dokumentacioni shoqëruar i këtyre makinerive është në gjuhë të huaj, i papërkthyer ose në një rast i përkthyer nga përkthyes jozyrtarë/pa licencë nga Ministria e Drejtësisë.

- Autobotmatricës me targë LU3021C, e marë me qera nga I.S.P.P., i mbaron kolaudimi në datën 27.08.2022, si dhe nuk ka vërtetim për pagesën e taksave dhe nuk ka leje transporti.

- Për autobotin me targë LU3021C, e marë me qera nga E.O., nuk ka vërtetim për pagesën e taksave.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithëse disponohen fatura, deklarata zhdoganimi, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Konkluzion: Sa më sipër OE “2.” SHPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT dhe KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “2.” SHPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE “2.” SHPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 7,622,920 lekë pa TVSH.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekt: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 7,622,920 lekë pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

9. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës së “Shelqetit”, Nj. A. Nikël, Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 415, datë 10.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 415, datë 10.08.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 416, datë 10.08.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. M.Ç., Kryetar; 2. S.D., Anëtar; 3. K.Z., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 9,858,016 lekë	6. Oferta fituese: “K.D.” sh.p.k., me ofertë 6,772,800 lekë pa TVSH, me kontratë datë 05.10.2022, me afat 50 ditë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 3,085,216 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 22.08.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 3 OE

⁸ https://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/perf_id/2N

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.

Situata: Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave: Me urdhërin e Prokurimit nr. 415, me nr. 4984 prot., datë 10.08.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Krujë z. A.B., urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 9,858,016 lekë pa TVSH, për objektin: “Sistemim-asfaltim i rrugës së “Shelqetit”, Nj. A. Nikël, Krujë”.

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga G.H., Kryetar, M.K. dhe A.G., anëtarë. Numri i referencës së prokurimit është REF-38287-08-10-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 22.08.2022, ora 10:00.

Kriteret e veçanta të kualifikimit, janë hartuar nga Ing. A.D., me detyrë inxhinier në DPZHT, Bashkia Krujë, në bazë të Urdhërit nr. 04, me nr. 52 prot., datë 07.01.2022, “Për ngarkimin e strukturave përgjegjëse, ...”.

KVO është ngritur me urdhërin nr. 416, me nr. 4985 prot., datë 10.08.2022.

Projekti dhe fondi limit: Nga DPZHT Bashkia Krujë, me shkresën nr. 4983 prot., datë 10.08.2022, bashkëlidhur së cilës gjendet Projekti, Preventivi, Grafiku i punimeve, Raporti teknik, Specifikimet teknike, Raporti i ndikimit në mjedis dhe Kërkesat e veçanta për kualifikim (të hartuara nga Shoqëria “E.G.”), është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt si më sipër.

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Krujë, i miratuar me Vendimin nr. 13, datë 28.02.2021 të Këshillit Bashkiak Krujë, “Për miratimin e shtesës së buxhetit të vitit 2022”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 190/2 prot., datë 07.03.2022. Financimi është parashikuar për t’u kryer për 2 vite: 4,929,008 lekë për vitin 2022 dhe 5,914,809 lekë për vitin 2023.

Në procesverbalin datë 14.09.2022, të mbajtur nga Njësia e Prokurimit për kriteret e kualifikimit, specifikimet teknike, etj., është specifikuar që përllogaritja e fondit limit i cili konfirmon preventivin e përllogaritur nga studio projektuese, është bërë në përputhje me Vendimin nr. 629, datë 15.07.2015 të KM “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Kriteret e vlerësimit: Në pikën 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nën-pika 2.1., është kërkuar “Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshire edhe detyrimet vendore për vitin 2022 të leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB...”.

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat kërkohet disponimi i faturave, deklaratave të zhdoganimit, etj., nuk mund të vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Këto kriteret, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pikat 1 dhe 3.

Vlerësimi i ofertave: Nga Procesverbali mbi hapjen e ofertave, datë 22.08.2022, u konstatua pjesëmarrja e katër Operatorëve Ekonomikë.

Nga Procesverbali mbi vlerësimin e ofertave, me nr. 4983/1 prot., datë 26.08.2022, u konstatua se është skualifikuar OE B. dhe janë kualifikuar tre Operatorët Ekonomikë të tjerë ofertues. Është shpallur fituese oferta e OE “K.D.” SHPK, me vlerë 6,772,800 lekë pa tvsh, si oferta me vlerën më të ulët.

Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 4983/2 prot., datë 07.09.2022 dhe nga Titullari i AK Bashkia Krujë, ka dalë Urdhëri nr. 543, me nr. 6617 prot., datë 05.10.2022 “Për lidhjen dhe zbatimin e kontratës”. Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 6618 prot., datë 05.10.2022. Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatrëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	K.D.	6,772,800	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	K.T.	7,077,310	Kualifikuar
3	B.	7,466,400	Kualifikuar
4	B.	7,504,000	Skualifikuar për mosparaqitje të formularit për sigurimin e ofertës

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

- OE K.D. nuk ka paraqitur dokumentacion për punësimin e minimalisht 3 punonjësve manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda.
- Makineritë teknologjike (rrulat dhe asfaltoshtuesja), nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”.
- OE K.D. nuk ka paraqitur dokumentacion për pajisjen “Sharrë për prerje asfalti”.
- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithëse disponohen fatura, deklarata zhdoganimi, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

Konkluzion: Sa më sipër OE “K.D.” SHPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT dhe KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “K.D.” SHPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE “K.D.” SHPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 6,772,800 lekë pa TVSH.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 6,772,800 lekë pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Loti nr. 1, Blerje karburanti (gasoil 10 ppm) për Bashkinë Krujë”,

1. Urdhër Prokurimi Nr. 156, datë 20.04.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. 156, datë 26.04.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr. 157, datë 20.04.2022
--	---	---

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”, e tipit Marrëveshje Kuadër	1. G.H., Kryetar; 2. E.C., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. M.Ç., Kryetar; 2. I.H., Anëtar; 3. A.B., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa tvsh) 36,394,882 lekë	6. Oferta fituese: “K.” shpk Vlera e shprehur me normë fitimi: 14.9 lekë/litër pa tvsh. Normë e fitimit të shprehur në vlerë absolute, marreveshje kuader, me afat 24 mujor, date 26.05.2022	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Faza 1- Data e zhvillimit: 06.05.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatoret Ekonomike: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE K. Shpk me normë fitimi 14,9 lekë/litër B.O. Shpk me normë fitimi 4.9% e çmimit pa tvsh lekë/litër
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP, Nuk ka

11. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Loti nr. 2, Blerje Benzine Premium Unl 10 ppm për Bashkinë Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 156, datë 20.04.2022	3.2 Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. 156, datë 26.04.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr. 157, datë 20.04.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”, e tipit Marreveshje Kuader	1. G.H., Kryetar; 2. E.C., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. M.Ç., Kryetar; 2. I.H., Anëtar; 3. A.B., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa tvsh) 100,000 lekë	6. Oferta fituese: “K.” shpk Vlera e shprehur me normë fitimi: 14.9 lekë/litër pa tvsh. Normë e fitimit të shprehur në vlerë absolute, marreveshje kuader, me afat 24 mujor, date 26.05.2022	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Faza 1- Data e zhvillimit: 06.05.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatoret Ekonomike: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE K. Shpk me normë fitimi 14,9 lekë/litër B.O. Shpk me normë fitimi 4.9% e çmimit pa tvsh lekë/litër
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve të vendosura dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i fondit limit: Nga auditimi, rezultoi se nga komisioni i përlogaritjes së fondit limit, nuk argumentohet dhe dokumentohet sasia e kërkuar e cila do të përdoret për nevojat e drejtorive dhe sektorëve të Bashkisë Krujë.

Hartimi i Kriterëve: Çertifikata për transportimin e materialeve të rrezikshme është vendosur në kundërshtim me Ligjin nr. 118/2012 “Për transportimin e mallrave të rrezikshëm”, pasi karburantet nuk konsiderohen mallra të rrezikshme, sepse nuk përfshihen në asnjë nga klasat e përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji.

Vlerësimi i ofertave: Vlerësimi është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kriterëve të veçanta, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

12. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim i pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane për qytetin Fushë Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi : Nr. 229, datë 31.05.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 229, datë 31.05.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 230, datë 31.05.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, Marreveshje Kuader	1. G.H., Kryetar; 2. E.C., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. F.C., Kryetar; 2. A.S., Anëtar; 3. A.Gj., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 16,528,954 lekë	6. Oferta fituese: R. sh.p.k ofertë 16,500,478 Lekë pa Tvsh, me kontrate nr. 4159 prot., datë 06.07.2022, me afat 12 muajor, me vlerë 19,800,573 lekë meTvsh	7. Diferenca me fondin limit: 28,476 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 17.06.2022	9. Burimi Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i kushteve të kontratës midis operatorit ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor.

Situata: Zbatimi i Kontratës

1. Raportimet: Nga auditimi, rezultoi se kontraktori nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 4159 prot., datë 06.07.2022, neni 13, pika 1 dhe pika 2.

2. Edukimi ambiental: Nga auditimi, rezultoi se kontraktori për periudhën e vlefshmërisë së kontratës 2022-2023 nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik, të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike. Gjithashtu, nuk ka kryer as programin e edukimit ambiental, i cili duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj. Veprime këto që janë në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 4159 prot., datë 06.07.2022, neni 18, pika 1 dhe pika 2.

Në kushtet e mosrealizimit të programeve të edukimit publik dhe ambiental, supervizorët e AK nuk kanë aplikuar gjopa ndaj kontraktorit në kundërshtim me përcaktimet e kontratës, neni 28 “*Penalitetet dhe gjobat*”.

3. Moskryerja e zërit të punimeve: Sipas procesverbalit të datës 31.08.2022, të mbajtur nga grupi për monitorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit për qytetin e Fushë-Krujës, është konstatuar moskryerja e zërit të punimeve “*grumbullim e ngarkim në mjet mbetje inerte barishte dhe transport mbetje inerte, barishte, materiale të ngurta*”. Sasia e planifikuar e këtyre mbetjeve është në sasinë 91.25 ton.

Këto veprime janë në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 4159 prot., datë 06.07.2022, neni 10, pika 1.

4. Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit: Sa më sipër, rezulton se grupi i punës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratës së pastrimit në Qytetin e Fushë-Krujës nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratën nr. 4159 prot., datë 06.07.2022, neni 22, pikat 2, 5, 6.

Hartimi i Kritereve: Kriteret janë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

Vlerësimi i ofertave: Vlerësimi është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Kontrata midis operatori ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekt: Pasiguri për kryerjen me cilësi të shërbimit në pastrimin e qytetit.

Shkaku: Moszbatim i kushteve të kontratës së firmosur midis operatorit ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me kushtet e kontratës.

13. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim i pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane për qytetin e Krujës”		
1. Urdhër Prokurimi : Nr. 85, datë 11.03.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 85, datë 11.03.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 86, datë 11.03.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, Marreveshje Kuader	1. G.H., Kryetar; 2. E.C., Anëtar 3. A.G., Anëtar	1. F.C., Kryetar; 2. A.S., Anëtar 3. K.M., Anëtar
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 19,083,869 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese: D. & S. Shpk me ofertë 19,033,187 lekë pa tvsh, me kontrate nr. 2208 Prot., datë 15.04.2022, me afat 12 mujor, 22,839,824 lekë me Tvsh	7. Diferenca me fondin limit: 50,682 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 30.03.2022	10. Burimi Financimit: Te ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i kushteve të kontratës midis operatorit ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor.

Situata: Zbatimi i Kontratës

1. Raportimet: Nga auditimi rezulton se, kontraktori nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 2208 Prot., datë 15.04.2022, neni 13, pika 1 dhe pika 2.

2. Edukimi ambiental: Nga auditimi rezultoi se, kontraktori për periudhën e vlefshmërisë së kontratës 2022-2023 nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike. Gjithashtu, nuk ka kryer as programin e edukimit ambiental, i cili duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj. Veprime këto që janë në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 2208 Prot., datë 15.04.2022, neni 18, pika 1 dhe pika 2.

Në kushtet e mosrealizimit të programeve të edukimit publik dhe ambiental, supervizorët e AK nuk kanë aplikuar gjopa ndaj kontraktorit, në kundërshtim me përcaktimet e kontratës, neni 28 “Penalitet dhe gjobat”, germa f.

Hartimi i Krieteve: Kriteret janë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

Vlerësimi i ofertave: Vlerësimi është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Kontratat midis Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Pasiguri për kryerjen me cilësi të shërbimit në pastrimin e qytetit.

Shkaku: Moszbatimi kushteve të kontratës së firmosur midis Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me kushtet e kontratës.

14. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës së Lagjes së “Bakallëve”, Nj.A. Bubq, Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 341, datë 15.07.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 341, datë 15.07.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 342, datë 15.07.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. A.H., Kryetar; 2. A.D., Anëtar; 3. S.D., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 13,712,479 lekë	6. Oferta fituese: B.O.E “K.D.” & “V.”, me ofertë 9,334,210 lekë pa tvsh, me kontratë datë 21/09/2022, me afat 66 ditë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 4,378,269 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit:	9. Burimi Financimit:	10. Operatorët Ekonomikë:

05.08.2022	Te ardhurat e Bashkisë Kruje	a) Pjesëmarrës në tender 7 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 6 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kritereve.

Situata: Hartimi i kritereve: 1. Sipas kërkesës në DT në pikën 2.3.7 (a) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet për mjetet të tjera të cilat nuk kanë objekt transportin duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

2. Sipas kërkesës në DT në pikën 2.3.7 (c) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Vlerësimi i ofertave: Vlerësimi është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

15. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” e “Hekurudha”, N.J.A.Thumanë, Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi : Nr. 384, datë 27.07.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 384, datë 27.07.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 385, datë 27.07.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. F.C., Kryetar; 2. I.K., Anëtar; 3. S.K., Anëtar;
5. Fondi-Limit(pa Tvsh) 20,344,004 - lekë pa tvsh	6. Oferta fituese: “S.M.O.U.”, me ofertë 13,865,401 Lekë pa tvsh, me kontrate datë 21.09.2022, me afat 96 ditë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 6,479,603 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 12.08.2022	9. Burimi Financimit: Te ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 8 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 8 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1. Sipas kërkesës në DT në pikën 2.3.7 (a) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet për mjetet te tjera të cilat nuk kanë objekt transportin duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

2. Sipas kërkesës në DT në pikën 2.3.7 (c) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Vlerësimi i Ofertave: OE i shpallur fitues nuk ka paraqitur:

- Vërtetim nga tatimet që kompania nuk është në procedurë falimenti.
- Vërtetim nga APP që subjekti nuk është i ndaluar për të marrë pjesë në procedura prokurimi.
- Certifikatë për gjendjen gjyqësore për anëtarët e organit administrativ.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që

lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP. Vlerësimi i operatorit fitues në mospërputhje me kuadrin ligjor.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

16. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës Halil-Zgërdhesh (Kala), Nj.A.Fushë Krujë, Krujë”		
1. Urdhër Prokurimi : Nr. 382, datë 27.07.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 384, datë 27.07.2022	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 382, datë 27.07.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur “	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. E.S., Kryetar; 2. R.B., Anëtar; 3. D.Zh., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 14,997,888- lekë pa tvsh	6. Oferta fituese: S.U. shpk ofertë 9,848,450 Lekë pa tvsh, me kontratë datë 21/09/2022, me afat 72 ditë nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 5,149,438 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 12.08.2022	9. Burimi Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Krujë	10.Operatorët Ekonomikë : a) Pjesëmarrës në tender 7 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 7 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Sipas kërkesës në DT në pikën 2.3.7 (a) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet për mjetet te tjera të cilat nuk kanë objekt transportin duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

2. Sipas kërkesës në DT në pikën 2.3.7 (c) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Vlerësimi i Ofertave: OE i shpallur fitues nuk ka paraqitur:

- Vërtetim nga tatimet që kompania nuk është në procedurë falimenti.
- Vërtetim nga APP që subjekti nuk është i ndaluar për të marrë pjesë në procedura prokurimi.
- Certifikatë për gjendjen gjyqësore për personat në cilësinë e antarëve të organit administrativ.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP. Vlerësimi i operatorit fitues në mospërputhje me kuadrin ligjor.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në lidhje me sa më sipër, nga Bashkia Krujë është paraqitur observacioni me nr. 4971/2 prot., datë 15.06.2023, i administruar në KLSH me nr. 206/7 prot., datë 19.06.2023, nga shqyrtimi i të cilit u konstatua se është i njëjti observacion i trajtuar në Projekt

Raportin e dërguar në Bashkinë Krujë me shkresën nr 206/6 prot, datë 05.06.2023.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Duke qenë se observacioni i paraqitur nuk përmban asnjë dokument, fakt apo provë të re, të panjohur nga grupi i auditimit dhe të patrajtuar gjatë zhvillimit të auditimit në terren apo gjatë fazës së hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, gjithashtu, duke i gjetur këto kundërshti të njëjta me kundërshtitë e paraqitura për Aktet e Konstatimit, observacioni nuk merret në konsideratë.

17. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugëve Lagja në lindje të superstradës, Qendër Thumanë, Krujë”

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 378, datë 27.07.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 378, datë 27.07.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 379, datë 27.07.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar; 3. A.G., Anëtar;	1. F.C., Kryetar; 2. R.S., Anëtar; 3. Xh.M., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 22,079,548 lekë	6. Oferta fituese: S.U. sh.p.k ofertë 15,703,890 Lekë pa tvsh, me kontratë datë 31.10.2022, me afat 105 dite nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 6,375,658 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 12.08.2022	9. Burimi Financimit: Te ardhurat e Bashkisë Kruje	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 8 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 8 OE
11. Ankime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Sipas kërkesës në DT në pikën 2.3.7 (a) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet për mjetet te tjera të cilat nuk kanë objekt transportin duhet te jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

2. Sipas kërkesës në DT në pikën 2.3.7 (c) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Vlerësimi i Ofertave: OE i shpallur fitues nuk ka paraqitur:

- Vërtetim nga tatimet që kompania nuk është në procedurë falimenti.
- Vërtetim nga APP që subjekti nuk është i ndaluar për të marrë pjesë në procedura prokurimi.
- Certificate për gjendjen gjyqësore për personat në cilësinë e antarëve të organit administrativ.
- Kopje të Certificate Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me përgjegjësi antarët e NjP. Vlerësimi i operatorit fitues në mospërputhje me kuadrin ligjor.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

18. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i Unazës së Vogël Qytet Fushë Krujë”

1. Urdhër Prokurimi : Nr. 339, datë 15.07.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 339, datë 15.07.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 340, datë 15.07.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “e hapur”	1. G.H., Kryetar; 2. M.K., Anëtar;	1. F.C., Kryetar; 2. A.H., Anëtar;

	3. A.G., Anëtar;	3. Xh.M., Anëtar;
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 34,474,861 lekë	6. Oferta fituese: B.O.E “K.D.” + “V.” sh.p.k ofertë 26,979,520 Lekë pa tvsh, me kontratë datë 21.09.2022, me afat 160 dite nga fillimi i punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 7,495,341 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 05.08.2022	9. Burimi Financimit: Te ardhurat e Bashkisë Krujë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 5 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në aplikimin e kriterëve.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Sipas kërkesës në DT në pikën 2.3.7 (a) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet që për mjetet e tjera të cilat nuk kanë objekt transportin, duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

2. Sipas kërkesës në DST në pikën 2.3.7 (c) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike*. Operatorit ekonomik i kërkohet për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Vlerësimi i ofertave: Vlerësimi është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik. *Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.*

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekt: Ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Në zbatim të kësaj nënpike të Programit të auditimit, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë, nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022.

Nga grupi i auditimit, në bazë të nivelit të materialitetit, riskut cilësor dhe kohës në dispozicion, u gjykuan për t’u audituar kontratat për punë publike, pasqyruar në Aneksin Z1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, me vlerë totale 41,634,936 lekë pa TVSH ose **49,961,924.2 lekë me TVSH**, mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimin, zbatimin e afateve të kontratave si dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:

1. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashmiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 2044 Prot., datë 21.09.2022 OE “S.U.” SHPK	15. Vlera e kontratës VI e prev ofertues 16,638,481.2 lekë me TVSH Prev Rishikuar 16,638,358.20 lekë me TVSH	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 12,891,147 lekë me TVSH Sit. 2 (përfundimtar) në vlerën 3,559,851 lekë me TVSH
17. Situacioni Përfundimtar Vlera 16,638,358 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në ditë Fillimi punimeve: 29.09.2022 Përfundimi punimeve: 03.01.2023	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka

20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "B.P." SHPK	Licenca MK.2205/5	Kontratë me nr. 1110 prot, datë 27.03.2020
21. Kolaudatori i punimeve OE "S.V." SHPK	Licenca Nr: MK.3232	Kontratë nr. 2051 prot, datë 20.07.2022
22. Akt Kolaudimi Datë: 26.03.2023	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë ---- objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Krujë. Urdhër nr. ---, datë ---- është ngritur grupi me përbërje: ----	

Titulli i Gjetjes: Punime ndërtimi të pakryera në objektin “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”.

Situata: Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Krujë, në vlerën **147,330** lekë pa TVSH, argumentuar si vijon:

Punime shtresash në rrugë:

I. Rruga “Vlash Dobrozi” l=850 ml, Zëri 7. Shtresë stabilizanti (banikë) t=10cm.

Preventivi bazë ofertues pasqyron volumin 425 m² shtresë stabilizant me çmim 180 lekë.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 425 m² shtresë stabilizant me çmim 180 lekë.

Libreza e masave pasqyron volumin 425 m² shtresë stabilizant, të detajuar në mënyrë analitike.

Në fakt, nga auditimi i realizimit të këtij zëri në objekt rezultoi se, në bankinën e rrugës, nuk është vendosur fare stabilizant.

Sa më sipër trajtuar, mosrealizimi i volumit në masën 100 % shtresë stabilizanti në bankina, është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve OE “S.U.” SHPK në vlerën **76,500 lekë pa TVSH** (425 m² x 180 lekë).

II. Rruga “Dashamiri” l=542 ml + 54 ml shtesë = 596 ml, Zëri 7. Shtresë stabilizanti (banikë) t=10cm.

Preventivi bazë ofertues pasqyron volumin 271 m² shtresë stabilizant me çmim 180 lekë.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 271 m² shtresë stabilizant me çmim 180 lekë.

Libreza e masave pasqyron volumin 271 m² shtresë stabilizant, të detajuar në mënyrë analitike.

Në fakt, nga auditimi i realizimit të këtij zëri në objekt rezultoi se, në bankinën e rrugës, nuk është vendosur fare stabilizant.

Sa më sipër trajtuar, mos realizimi i volumit në masën 100 % shtresë stabilizanti në bankina, është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve OE “S.U.” SHPK në vlerën **48,780 lekë pa TVSH** (271 m² x 180 lekë).

III. Rruga “Hekurudha” l=245 ml, Zëri 7. Shtresë stabilizanti (banikë) t=10cm.

Preventivi bazë ofertues pasqyron volumin 122.5 m² shtresë stabilizant me çmim 180 lekë.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 122.5 m² shtresë stabilizant me çmim 180 lekë.

Libreza e masave pasqyron volumin 122.5 m² shtresë stabilizant, të detajuar në mënyrë analitike.

Në fakt, nga auditimi i realizimit të këtij zëri në objekt rezultoi se, në bankinën e rrugës, nuk është vendosur fare stabilizant.

Sa më sipër trajtuar, mos realizimi i volumit në masën 100% shtresë stabilizanti në bankina, është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve OE “S.U.” SHPK në vlerën **22,050 lekë pa TVSH** (122.5 m² x 180 lekë).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. A.A., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 1075 prot., datë 19.03.2020; Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 1110 prot., datë 27.03.2020.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Mosrealizim zëra punë ndërtimi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të arkëtojë vlerën prej **147,330 lekë pa TVSH** nga OE “S.U.” SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 2044 Prot., datë 21.09.2022, me objekt “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”.

Titulli i Gjetjes: Mosrealizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”, Bashkia Krujë.

Situata: Nga auditimi i dosjes teknike për objektin: “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë” u konstatuas si vijon:

- Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2021 nga shoqëria “H.C.” SHPK përfaqësuar nga Administratori Z. G.P., me NIPT L.....Q. Projekti i zbatimit është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë.

- Për projektin e zbatimit të objektit: “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë” nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Krujë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, “Ndërtimet publike”, germa (a), ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. A.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Krujë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Ligji Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, neni 6, “Ndërtimet publike”, germa (a).

Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Krujë .

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë” Bashkia Krujë.

14. Lidhja e kontratës Nr. 6115 prot., datë 21.09.2022 BOE “K.D.” SHPK & “V.” SHPK	15. Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 11,201,052 lekë me TVSH Prev Rishikuar 11,195,478 lekë me TVSH	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 7,816,112 lekë me TVSH Sit. 2 (përfundimtar) në vlerën 2,819,592 lekë me TVSH.
17. Situacioni Përfundimtar -Vlera 11,195,478 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 28.09.2022 Përfundimi punimeve: 06.01.2023	19. Zgjatja e kontratës Pezullim për periudhën 20.11.2022-27.12.2022.

20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "B.P." SHPK	Licenca MK.2205/5	Kontratë me nr. 6238 prot, datë 23.09.2022
21. Kolaudatori i punimeve OE "G.L.C." SHPK	Licenca Nr: MK2928/10	Kontratë nr. 7795 prot, datë 08.11.2022
22. Akt Kolaudimi Datë: 08.02.2023	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 10.03.2023 objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Krujë. Urdhër nr. --., datë ---- është ngritur grupi me përbërje: E.S., Arben Dobrazi dhe Sokol Kallaku.	

Titulli i Gjetjes: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin "Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së "Bakallëve" NjA Bubq, Krujë", Bashkia Krujë.

Situata: Nga auditimi i situacioneve pjesore progresive dhe situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Krujë, në vlerën **154,320 lekë** pa TVSH, si vijon:

I. Punime shtresash në rrugë (Segmenti 1, 2, 3, 4), Zëri 1. Gërmim dheu kanal, ekskavator me zinxhir, dhe shkarkim në mjet.

Preventivi bazë pasqyron volumin 362 m³ gërmim dheu me çmim 250 lekë. Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 184.70 m³ gërmim dheu me çmim 250 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 184.70 m³ gërmim dheu me çmim 250 lekë. Libreza e masave pasqyron volumin 184.70 m³ gërmim, të detajuar në mënyrë analitike sipas seksioneve që i përkasin piketave nga (Pk1 0+000 + deri Pk12 0+340.2).

Në fakt, konstatohet se në situacionin nr. 1 janë likuiduar për volumin 260 m³ dhe në situacionin përfundimtar pasqyrohet volumi 184.7 m³.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve janë likuiduar tepër 75.3 m³ (260 m³ – 184.7 m³) dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve BOE "K.D." SHPK & "V." SHPK në vlerën **18,825 lekë pa TVSH (75.3 m³ x 250 lekë)**.

Zëri 8. Transport dheu në distancë 1 km.

Preventivi bazë pasqyron volumin 362 m³ transport dheu me çmim 100 lekë. Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 195.20 m³ transport dheu me çmim 100 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 195.20 m³ transport dheu me çmim 100 lekë. Libreza e masave pasqyron volumin 195.2 m³ transport dheu, të detajuar në mënyrë analitike, sipas seksioneve që i përkasin piketave nga (Pk1 0+000 + deri Pk16 0+436.5).

Në fakt, libreza pasqyron 195.2 m³, ndërkohë që në situacionin nr. 1 janë likuiduar për volumin 290 m³ dhe në situacionin përfundimtar pasqyrohet volumi 195.20 m³.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve janë likuiduar tepër 75.3 m³ (290 m³ – 195.20 m³) dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve BOE "K.D." SHPK & "V." SHPK në vlerën **9,480 lekë pa TVSH (94.8 m³ x 100 lekë)**.

II. Punime shtresash në rrugë (Segmenti 5), Zëri 6. Shtresë stabilizanti (banikë), t=10cm.

Preventivi bazë pasqyron volumin 635 m² Shtresë stabilizanti me çmim 180 lekë. Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 197 m² Shtresë stabilizanti me çmim 180 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 197 m² Shtresë stabilizanti me çmim 100 lekë. Libreza e masave pasqyron volumin 197 m² Shtresë stabilizanti, të detajuar në mënyrë analitike.

Në fakt, libreza pasqyron 197 m², ndërkohë që në situacionin nr. 1 janë likuiduar për volumin 635 m² dhe në situacionin përfundimtar pasqyrohet volumi 197 m².

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve janë likuiduar tepër 438 m² (635 m² – 197 m²)

dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve BOE "K.D." SHPK & "V." SHPK në vlerën **78,840 lekë pa TVSH (438 m² x 180 lekë)**.

III. Punime shtresash asfaltike (Segmenti 6), Zëri 6. Shtresë binderi, t=5 cm, gur zalli makineri

Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 477 m² Shtresë binderi me çmim 950 lekë.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 477 m² Shtresë binderi me çmim 950 lekë.

Libreza e masave pasqyron volumin 477.67 m² Shtresë binderi, të detajuar në mënyrë analitike. Në fakt, nga auditimi i pasqyrimin në librezën e masave, konstatohet se për progresivim nga Pk1 0+000 deri Pk2 0+045.57 ml, gjerësia e rrugës është marrë 2.8 m ku në projektin e rishikuar është 2.5 ml; gjithashtu, konstatohet se për progresivim nga Pk4 0+050 deri Pk9 0+0176 ml, gjerësia e rrugës është marrë 2.6 m ku në projektin e rishikuar është 2.5 ml. Nga rillogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se librezuar dhe situacionuar 25.5 m² shtresë binderi më tepër në vlerën **24,225 lekë pa TVSH** (25.5 m² x 950 lekë).

- Zëri 6. Shtresë asfaltobetoni, t=4 cm, gur zalli makineri

Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 477 m² Shtresë binderi me çmim 900 lekë.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 477 m² Shtresë binderi me çmim 900 lekë.

Libreza e masave pasqyron volumin 477.67 m² Shtresë binderi, të detajuar në mënyrë analitike. Në fakt, nga auditimi i pasqyrimin në librezën e masave, konstatohet se për progresivim nga Pk1 0+000 deri Pk2 0+045.57 ml, gjerësia e rrugës është marrë 2.8 m ku në projektin e rishikuar është 2.5 ml; gjithashtu, konstatohet se për progresivim nga Pk4 0+050 deri Pk9 0+0176 ml, gjerësia e rrugës është marrë 2.6 m ku në projektin e rishikuar është 2.5 ml. Nga rillogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se librezuar dhe situacionuar 25.5 m² shtresë binderi më tepër në vlerën **22,950 lekë pa TVSH** (25.5 m² x 900 lekë).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. A.A., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 6115 prot., datë 21.09.2022; Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 6238 prot, datë 23.09.2022.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Mosrealizim zëra punë ndërtimi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të arkëtojë vlerën prej **154,320 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE “K.D.” SHPK & “V.” SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën Nr. 6115 prot., datë 21.09.2022, me objekt “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”.

Titulli i Gjetjes: Mosrealizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve NjA Bubq”, Bashkia Krujë.

Situata: Nga auditimi i dosjes teknike për objektin: “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë” u konstatua si vijon:

Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2021 nga shoqëria “E.G.” SHPK përfaqësuar nga Administratori Z. G.I., me NIPT L57129604Q me Licencë N. ---. Projekti i zbatimit është miratuar nga Bashkia Krujë.

- Për projektin e zbatimit të objektit: “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë” nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Krujë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, “Ndërtimet publike”, germa (a), ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. A.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Krujë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Ligji Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, neni 6, “Ndërtimet publike”, germa (a).

Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit pa oponentë teknike.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Krujë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Oponentë Teknike për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”, Bashkia Krujë.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 6145 prot., datë 21.09.2022 OE “B.” SHPK	15. Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 22,122,391 lekë me TVSH Prev Rishikuar 22,122,175 lekë me TVSH	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 13,818,369 lekë me TVSH Sit. 2 (përfundimtar) në vlerën 7,197,698 lekë me TVSH.
17. Situacioni Përfundimtar -Vlera 22,122,175 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 26.09.2022 Përfundimi punimeve: 17.01.2023	19. Zgjatja e kontratës S’ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “B.P.” SHPK	Licenca MK.2205/5	Kontratë me nr. 6236 prot, datë 23.09.2022
21. Kolaudatori i punimeve OE“G.L.C.” SHPK	Licenca Nr: MK2928/10	Kontratë nr. 3347 prot, datë 13.04.2023
22. Akt Kolaudimi Datë: -----	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë ----- objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Krujë. Urdhër nr. --., datë ---- është ngritur grupi me përbërje: -----	

Titulli i Gjetjes: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”.

Situata: Nga auditimi i situacioneve pjesore progresive dhe situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Krujë, në vlerën **305,440 lekë pa TVSH**, si vijon.

- Zëri 3. Mbushje me çakëll makinerie, me makineri.

Preventivi bazë dhe i rishikuar pasqyron volumin 1491 m² mbushje me çmim 1540 lekë.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 1491 m² shtresë çakëll me çmim 1540 lekë.

Libreza e masave pasqyron volumin 1848.2 m² mbushje me çakëll, të detajuar në mënyrë analitike, si vijon:

Lloji i punimit	Njësia	Gjatësia (m)	Gjerësia (m)	Lartësi/thellësi (m)	Volumi (m ³)
Mbushje me çakëll makinerie, me makineri					
Km 0+000 deri km 2+050	M ³	2050	4	0.2	1640
Kryqëzimi km 2+050 deri në fund të rrugës	M ³	441		0.2	88.2
Km 0+000 deri km 2+050	M ³	150	4	0.2	120
Totali					1848.2

Në fakt nga auditimi në objekt, i pasqyrimin në librezën e masave si dhe nga matjet me AutoCad, rezulton se volumi në kryqëzimin Km 2+050 deri në fund të rrugës është 358 m² dhe jo 441 m².

Sa më sipër trajtuar, diferenca prej 83 m², sipas llogaritjes nga grupi i auditimit të KLSH-së me është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **127,820 lekë pa TVSH** [83 m² x 1540 lekë].

Në të njëjtën logjikë (trajtuar më sipër) diferenca prej 83 m³ (është volumi në kryqëzimin Km 2+050 deri në fund të rrugës është 358 m² dhe jo 441 m²) është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, për zërat:

- Shtresë stabilizanti t=10cm, gurë kave, makineri në vlerën **26,560 lekë pa TVSH** [83 m² x 320 lekë].

- Shtresë binderi t= 5cm, gurë kave, makineri në vlerën **78,850 lekë pa TVSH** [83 m² x 950 lekë].

- Shtresë asfaltbetoni t= 4cm, gurë kave, makineri në vlerën **72,210 lekë pa TVSH** [83 m² x 870 lekë].

Në total, sa më sipër janë librezuar dhe situacionuar volume më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **305,440 lekë pa TVSH**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. A.A., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 6115 prot., datë 21.09.2022; Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 6238 prot, datë 23.09.2022.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Mosrealizim zëra punë ndërtimi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Bashkia Krujë të arkëtojë vlerën prej **305,440 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “B.” SHPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 6145 prot., datë 21.09.2022, me objekt “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”.

Titulli i Gjetjes: Mos realizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”.

Situata: Nga auditimi i dosjes teknike për objektin: “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë” u konstatuas si vijon:

- Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2021 nga shoqëria “E.G.” SHPK përfaqësuar nga Administratori Z. G.I., me NIPT K...K dhe Licencë MK. 1015/12. Projekti i zbatimit është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë.

- Për projektin e zbatimit të objektit: “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë” nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Krujë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, “Ndërtimet publike”, germa (a), ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. A.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Krujë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 57-123.

Kriteri: Ligji nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, neni 6.

Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Krujë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Konkluzion mbi zbatimin e kontratave për punë publike:

1. Nga auditimi i 3 (tre) kontratave për punë publike për periudhën e auditimit në vlerën totale **41,634,936 lekë pa TVSH ose 49,961,924.2 lekë me TVSH**, rezultuan zëra pune të pakryera si dhe realizim zërash jo në përputhje me specifikimet teknike në vlerën **607,090 lekë pa TVSH**, përkatësisht:

- **Vlera 147,330 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera si dhe realizimin zëra pune jo sipas specifikimeve teknike në kontratën me nr. 2044 prot., datë 21.09.2022 me objekt “*Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë*” të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe shoqërisë “S.U.” SHPK .

- **Vlera 154,320 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera sipas kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6115 prot., datë 21.09.2022 me objekt “*Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë*” të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe BOE “K.D.” SHPK & “V.” SHPK .

- **Vlera 305,440 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për diferenca në volume për zërat e punimeve në kontratën nr. 6145 prot., datë 21.09.2022 me objekt “*Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë*” të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Krujë dhe OE “B.” SHPK.

2. Në 3 raste, nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve, respektivisht për kontratat:

- “*Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë*”,

- “*Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë*”,

- “*Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë*”,

rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë, nuk ka kryer oponencën teknike për investimet për objektet e mësipërme. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 120/2020 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*”, të ndryshuar, neni 6, germa (a) ndërtimet publike.

3. Në 3 raste, nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve, respektivisht për kontratat:

- “*Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë*”,

- “*Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë*”,

- “*Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë*”,

rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë, nuk ka dhënë Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar.

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit;

2.5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës

së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Nga Bashkia Krujë, për periudhën 01.01.2011 deri 31.12.2022 janë realizuar 59 procedura: “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m²”; “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”; “Certifikatë përdorimi”; “Deklaratë paraprake”; “Leje infrastrukturore”; “Leje për ndërtime të reja në zonat e dëmtuara dhe në zona të reja për zhvillim”; “Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit”; “Leje për ndryshimin e zhvilluesit”; “Leje për prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore”; “Leje rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim vëllimi”; “Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim vëllimi” dhe “Leje zhvillimi”, përkatësisht:

- 3 “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m²”, me vlerë të përgjithshme preventivi 19,434,378 lekë; AK ka përfituar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 583,031 lekë;
- 9 “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, me vlerë të përgjithshme preventivi 234,155,081 lekë; AK ka përfituar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 7,665,067 lekë;
- 1 “Certifikatë përdorimi”, me vlerë të përgjithshme preventivi 40,086,114 lekë; AK ka përfituar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 180,373 lekë.
- 20 “Deklarata paraprake”, me vlerë të përgjithshme preventivi 198,913,454 lekë;
- 3 “Leje infrastrukturore”;
- 7 “Leje për ndërtime të reja në zonat e dëmtuara dhe në zona të reja për zhvillim”;
- 2 (dy) “Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit”;
- 1 “Leje për ndryshimin e zhvilluesit”;
- 4 “Leje për prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore”;
- 1 “Leje rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim vëllimi”;
- 2 “Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim vëllimi”;
- 5 “Leje zhvillimi”;

Lejet e ndërtimit kryesisht janë dhënë për llojet e objekteve: Ndërtim të ri; Ndërtim çatie në objekte ekzistuese; Shtesa anësore; Godina banimi 2 kat; Godina shërbimi; Objekte magazinimi; rikonstruksione dhe shtesa; Ndërtim kapanone industriale; Rikonstruksione dyqane dhe lokale; ndërtim vila; Mure rrethues; Magazine frigoriferike, etj.

Nga këto janë zgjedhur për t’u audituar procedura të aplikimit dhe miratimit të lejeve të zhvillimit e ndërtimit, bazuar në madhësinë e objekteve, vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë si edhe vend ndodhjes së objekteve duke mbajtur në fokus veçanërisht lejet e dhëna në zonën historike e të mbrojtura të Bashkisë Krujë.

Nga auditimi rezultuan problematikat si vijon:

Titulli i gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me nr. 37/1 prot., datë 07.01.2022 sipas Vendimit nr. 1, datë 07.01.2022 dhe, leje zhvillimi me Nr. 8061 Prot., datë 23.11.2021 sipas Vendimit Nr. 243, datë 23.11.2021, për objekt “Hotel 4 Kat + podrum” me adresë me adresë Rinas, Njësia Administrative Nikël, Krujë”, me zhvillues z. Xh.Rr., në mungesë të disa dokumenteve.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN061220210047 “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²” dhe me nr. protokolli 8319 datë 06.12.2021 e cila është miratuar me Vendimin nr. 1, datë 07.01.2022 për “Hotel 4

Kat + podrum”, u konstatua se, kjo leje është lëshuar në mungesë të dokumenteve, pasi nuk është kryer bashkërendimi me institucionet si vijon.

- Vërtetim nga Instituti i Ndërtimit,
- Vërtetim nga Instituti Sizmologjik,
- Në mungesë të Oponencës Teknike,
- Në mungesë të preventivit të detajuar në mënyrë të saktë,
- Vërtetim që subjekti ndërtues “P.” SHPK ka shlyer taksat dhe tarifatat vendore,
- Vërtetim që subjekti ndërtues “P.” SHPK nuk ka detyrime të papaguara,
- Vërtetim që zhvilluesi z. Xh.Rr. nuk ka detyrime të papaguara,

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. A.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Krujë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 115-119.

Kriteri: Nenet 9, 10 dhe 10/1 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar; nenet 37 dhe 38 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Lëshim leje ndërtimi në mungesë të dokumentacionit.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Krujë.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Krujë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrin masa për miratimin e Lejeve të Ndërtimit për projektet e zbatimit për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin tenikoligjor, sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me nr. 6199/1 prot., datë 22.09.2022 sipas Vendimit nr. 265/1, datë 22.09.2022 dhe, leje zhvillimi me nr. 1164 prot., datë 28.02.2022 sipas Vendimit nr. 26, datë 28.02.2022, për objektin “Strukturë 1-2 kat, për magazinim dhe tregtim të bojërave plastike” me adresë Hasan, Krujë të pronës me nr. pasurie 57/24, ZK 1934, me zhvillues bashkëpronarët S., në mungesë të disa dokumenteve.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²” dhe me nr. protokollit 3875 datë 26.06.2022, për të cilën është marrë vendimi për miratim me 265/1, datë 22.09.2022, për “Strukturë 1-2 kat, për magazinim dhe tregtim të bojërave plastike”, u konstatua se, kjo leje është lëshuar në mungesë të dokumenteve, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucionet si vijon.

- Vërtetim nga Instituti i Ndërtimit,
- Vërtetim nga Instituti Sizmologjik,
- Në mungesë të Oponenca Teknike,
- Vërtetim që subjekti ndërtues “K.D.” SHPK ka shlyer taksat dhe tarifatat vendore,
- Vërtetim që subjekti ndërtues “K.D.” SHPK nuk ka detyrime të papaguara
- Vërtetim që zhvilluesi bashkëpronarët S. nuk ka detyrime të papaguara.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. A.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Krujë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 115-119.

Kriteri: Nenet 11, 14, 15, 16, 22 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”; nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Lëshim leje ndërtimi në mungesë të dokumentacionit.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Krujë.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Krujë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrin masa për miratimin e Lejeve të Ndërtimit për projektet e zbatimit për të gjitha ndërtimet

publike, si dhe për objektet me akses publik, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin teniko-ligjor, sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i Gjetjes: Mos kryerje e Lejes Ndërtimore Infrastrukturore për projektin e zbatimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë” Bashkia Krujë.

Situata: Nga auditimi i dosjes teknike për objektin: “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë” u konstatua si vijon:

- Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2021 nga shoqëria “H.C.” SHPK përfaqësuar nga Administratori Z. G.P., me NIPT L.....Q. Projekti i zbatimit është miratuar nga Bashkia Krujë.

- Për ndërtimin e investimit me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë” nga Titullari i Bashkisë Krujë z. A.B. nuk është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore, veprim ky në kundërshtim me nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 115-119.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Krujë .

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Leje Ndërtimore Infrastrukturore për projektet e zbatimit për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i Gjetjes: Mos kryerje e Lejes Ndërtimore Infrastrukturore për projektin e zbatimit me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë” Bashkia Krujë.

Situata: Nga auditimi i dosjes teknike për objektin: “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë” u konstatua si vijon:

- Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2021 nga shoqëria “E.G.” SHPK përfaqësuar nga Administratori Z. G.I., me NIPT L....Q. Projekti i zbatimit është miratuar nga Bashkia Krujë.

- Për ndërtimin e investimit me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë” nga Titullari i Bashkisë Krujë z. A.B. nuk është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore, veprim ky në kundërshtim me nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 115-119.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Krujë .

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Leje Ndërtimore Infrastrukturore për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i Gjetjes: Mos kryerje e Lejes Ndërtimore Infrastrukturore për projektin e zbatimit me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë” Bashkia Krujë.

Situata: Nga auditimi i dosjes teknike për objektin: “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë” u konstatua si vijon:

- Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2021 nga shoqëria “E.G.” SHPK përfaqësuar nga Administratori Z. G.I., me NIPT K.....K dhe Licencë MK. 1015/12. Projekti i zbatimit është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë.

- Për ndërtimin e investimit me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë” nga Titullari i Bashkisë Krujë Z. A.B. nuk është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore, veprim ky në kundërshtim, nenet 27, 29 dhe 39 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. A.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Krujë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 115-119.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Krujë .

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Leje Ndërtimore Infrastrukturore për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A.B., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Krujë.

2. Z. A.A., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Konkluzion mbi Lejet e Ndërtimit:

Në 2 raste, nga auditimi i miratimit të Lejeve të Ndërtimit, respektivisht për objektet:

- “Hotel 4 Kat + podrum” me adresë me adresë Rinas, Njësia Administrative Nikël, Krujë, me zhvillues z. Xh.Rr.”,

- “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”,

- “Strukturë 1-2 kat, për magazinim dhe tregtim të bojërave plastike” me adresë Hasan, Krujë të pronës me nr. pasurie 57/24, ZK 1934, me zhvillues bashkëpronarët S.”,

rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë dhe, nga DPZHT, janë miratuar Leje Ndërtimi në mungesë të plotë të dokumenteve. Ky veprim është në kundërshtim me Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në lidhje me sa më sipër, nga Bashkia Krujë është paraqitur observacioni me nr. 4971/4 prot., datë 16.06.2023, i administruar në KLSH me nr. 206/7 prot., datë 19.06.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Bashkia Krujë, me shkresën nr. 4771/6, datë 16.06.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 206/7 prot., datë 19.06.2023) ka bërë komente dhe shpjegime për Pikën 2.5 “Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit” të Projekt Raportit të auditimit, si dhe në faqen 127 të projekt raportit tek pjesa “Konkluzione mbi lejet e ndërtimit” lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

-Gjykojmë se nuk jemi në kushtet e mungesës së plotë të dokumentacionit. Këto leje ndërtimi, referuar Akt Konstatimit nr. 11, janë miratuar në përputhje me ligjin nr. 104/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, endryshuar, dhe Planin e Përgjithshëm Vendor Tëshkisë Krujë....Bashkëngjitur dërgojmë CD me të gjithë dokumentet e aplikimit për Leje ndërtimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, sqaron se lejet e ndërtimit “Hotel 4 Kat + podrum, me adresë me adresë Rinas, Njësia Administrative Nikël, Krujë, me zhvillues z. Xh.Rr.” dhe “Strukturë 1-2 kat, për magazinim dhe tregtim të bojërave plastike, me adresë Hasan, Krujë të pronës me nr. pasurie 57/24, ZK 1934, me zhvillues bashkëpronarët S.” janë dhënë në mungesë vetëm të disa dokumenteve dhe konkretisht:

- Vërtetim nga Instituti i Ndërtimit,
- Vërtetim nga Instituti Sizmologjik,
- Në mungesë të Oponenca Teknike,
- Në mungesë të preventivit të detajuar në mënyrë të saktë,
- Vërtetim nga Drejtorja e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, që subjekti ndërtues ka shlyer taksat dhe tarifat vendore, të parashikuara nga pushteti vendor,
- Vërtetim që subjekti ndërtues nuk ka detyrime të papaguara,
- Vërtetim që zhvilluesi nuk ka detyrime të papaguara,

Pra, këto dy leje ndërtimi nuk janë dhënë në mungesë të plotë të dokumenteve, por vetëm në mungesë të disa dokumenteve të cilat nuk cenojnë kushtet e Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015.

Sa më sipër trajtuar, observacioni **merret në konsideratë.**

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)

- 2.6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.**
- 2.6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.**
- 2.6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmerinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë sipas dispozitave ligjore të nenit 81-Inspektimi, pika 3, të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.**

Në zbatim të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 3, kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga:

- a) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njesisë Vendore përkatëse;
- b) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Pranë çdo njësie vendore ngrihet Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, i cili nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Krujë është ngritur dhe funksionon në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4.

Për periudhën 2022 IMTV ka patur në strukturën e tij, 1 Kryeinspektor emëruar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 97, datë 29.09.2015 dhe 3 Inspektorë, të emëruar me Urdhërin nr. 59, datë 09.02.2016, Urdhërin nr. 14, datë 17.01.2020 dhe Urdhërin nr. 17, datë 17.01.2020, si dhe një inspektor i zëvendësuar me Urdhërin nr. 131, datë 10.05.2022.

Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë IMTV-ja në Bashkinë Krujë u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 35 Procesverbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 4 masa për “*Pezullim të punimeve*”, 13 masa për “*Prishje të objekteve të kundërligjshëm*” si dhe 29 masa “*Dënim me gjobë*”. Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2022 është 7,950,000 lekë. E gjithë kjo vlerë nuk është paguar, sipas Aneksit IMTV1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Mos vendosja e masës së gjobës sipas llojit të kundërvajtjes së mbajtur në Procesverbalet e konstatimit.

Situata: Nga shqyrtimi i procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes për vitin 2022, rezultoi se nga IMTV, për këto 35 Procesverbale për konstatimin e kundërvajtjes nuk është zbatuar kuadri ligjor, përkatësisht për:

1. Procesverbal nr. 120, datë 14.02.2022, subjekti “*K.K.*” për kundërvajtjen “*Brez betoni në afërsi të banesës së shtëpisë*” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
2. Procesverbal nr. 125, datë 18.03.2022, subjekti “*E.S.*” për kundërvajtjen “*Platformë me strukturë druri*” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
3. Procesverbal nr. 126, datë 22.03.2022, subjekti “*I.T.*” për kundërvajtjen “*Hapje kanali me efekt shtrirje rrjeti interneti*” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
4. Procesverbal nr. 127, datë 23.03.2022, subjekti “*M.M.*” për kundërvajtjen “*Rrethim me shufra betoni dhe rrjet teli*” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
5. Procesverbal nr. 128, datë 23.03.2022, subjekti “*Gj.N.*” për kundërvajtjen “*Shtyllë Druri në pjesën e rrugës së fshatit*” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
6. Procesverbal nr. 135, datë 15.08.2022, për kundërvajtjen “*Konstruksion metalik me panele sanduiç*”, është marrë masa prishje objekti me nr. 81, datë 25.08.2022 dhe nuk është marrë masë për gjobë.

Mos marrja e masave nga IMTV është në kundërshtim me përcaktimet e të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*” neni 52, germa “e” dhe neni 53, pika 6.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.6., faqe 127-130.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, neni 52 dhe 53, pika 6.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Mos zbatim korrekt i ligjit nga inspektorët e IMTV-së.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: IMTV të vlerësojë me saktësi kundërvajtjet e konstatuara gjatë kontrolleve në terren dhe të sigurohet që në vazhdimësi të aplikojë masën e duhur të gjobës në përputhje me llojin e kundërvajtjes së identifikuar.

Titulli i gjetjes: Mbi marrjen e masave për vendosjen e titujve ekzekutivë për gjobat e vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Krujë.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për periudhën në auditim nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë nga gjobat e vendosura nga IMTV. Për gjobat e vendosura në vitin 2022, të cilat nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV ka njoftuar subjektet kundërvajtës me shkresat përkatëse, por nuk ka bërë kërkesë për të nxjerrë Urdhërin e ekzekutimit, për 12 masa për gjobë, përkatësisht me nr. 64, datë 21.01.2022, nr. 81, datë 06.07.2022, nr. 85, datë 28.07.2022, nr. 86, datë 10.10.2022, nr. 88, datë 07.11.2022, nr. 90, datë 14.11.2022, nr. 92,

datë 14.11.2022, nr. 94, datë 28.11.2022, nr. 95, datë 28.11.2022, nr. , datë 25.11.2022, nr. 97, datë 25.11.2022 dhe nr. 98, datë 05.12.2022, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, rrjedhimisht duke mos ndjekur as hapat e tjera të parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.6., faqe 127-130.

Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30 pika 1 pika 3 dhe pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Mos ndjekja e hapave ligjore për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtime të pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave dhe nxjerrjen e titujve ekzekutiv për gjobat e vendosura.

2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.7.2. Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm në Bashkinë Krujë, u konstatua si më poshtë vijon:

1. Shkresa përcjellëse e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës me nr. 259/7 Prot, datë 27.07.2022, është protokolluar në Bashkinë Krujë, me nr. 3609/2 prot., datë 28.07.2022.

2. Është hartuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas shkresës nr. 4883 prot. datë 04.08.2022, por ky plan nuk është dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit.

3. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 6-mujor) së bashku me Raportin për zbatimin e rekomandimeve të lëna, është me nr. 3609/3 prot., datë 24.01.2023

Nga auditimi u konstatua se:

1. Sipas dokumentave të vendosura në dispozicion nga Bashkia Krujë, nuk është respektuar afati prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Me shkresën nr. 3609/3 prot., datë 24.01.2023 “Kthim përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të KLSH”, Bashkia Krujë ka respektuar afatin prej 6-mujor duke dërguar në KLSH raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

3. Nga KLSH janë lënë gjithsej **40** rekomandime, të grupuara në:

- **25** masa organizative;
- **4** masa shpërblim dëmi;
- **6** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të fondeve publike.

- 5 masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhëdhia (të ardhura të munguara)
Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **25** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 10 janë zbatuar, 2 zbatuar pjesërisht, 1 masë është në proces zbatimi dhe 12.000 janë zbatuar.

Pra janë zbatuar 40% e masave organizative dhe 48% nuk janë zbatuar.

- Për shpërblimin e dëmit janë lënë 4 rekomandime për 3 subjekte në vlerën 957,860 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar 2 rekomandime në vlerën 674,859 lekë dhe 2 rekomandime në vlerën 283,001 lekë janë në proces zbatimi.

- Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 6 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht.

2.7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Titulli i gjetjes: Bashkia Krujë nuk ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Situata: Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara.

Bashkia Krujë ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:

a. Janë lënë 25 Rekomandime për “Masa Organizative”, të cilat janë pranuar nga subjekti, për të cilat rikërkohet zbatimi për 2 masa të zbatuara pjesërisht, për 1 masë në proces zbatimi dhe 12 masa nuk janë zbatuar;

b. Janë lënë 4 rekomandime në vlerën totale 957,860 lekë për “Masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara”, të cilat janë pranuar nga subjekti dhe mbeten për t’u zbatuar, pasi deri tani janë zbatuar 2 masa, në vlerën 674,856 lekë, janë në proces zbatimi 2 masa, në vlerën 283,004 lekë.

c. Janë lënë 5 Rekomandime masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia për të cilat rikërkohet zbatimi për 1 masë të pazbatuar, 2 masa në proces zbatimi, 1 masë e zbatuar pjesërisht.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.7., faqe 130-139.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma j; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ndikimi/Efekti: Moszbatimi i Rekomandimeve, ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimeve institucionale dhe pengon për përmirësimin e tyre në dobi të komunitetit, në mospërdorimin me efikasitet të fondeve të saj si dhe në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Krujë.

Shkaku: Mosndjekja e gjitha procedurave nga ana e njësive përgjegjëse të Bashkisë Krujë, për të mundësuar zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 259/7 Prot, datë 27.07.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Nga sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH-së, rikërkon si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat në mënyrë që, temat më problematike që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik dhe të dokumentohen takimet e realizuara nga GMS dhe vendimet e marra për diskutimet përkatëse.

Brenda vitit 2023

2.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa që në pozicionin e specialistit të NjAB, të punësohet një person që përmbush kriteret për të qenë pjesë e kësaj strukture dhe mundëson funksionimin e auditit të brendshëm në mënyrë efektive.

Menjeherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucione të tjera vendore përkatëse me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

Menjeherë dhe në vijimësi

4.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të marrë masat të ngrejë një grup pune për të identifikuar të gjithë familjet që duhet të paguajnë detyrimet e bashkisë lidhur me taksat dhe tarifat familjare.

Menjeherë dhe në vijimësi

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë gjatë hartimit të akt-marrëveshjeve me subjektet debitore të marrë masat që këto akt- marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtarë si dhe të plotësoje dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimeve me këste.

Menjeherë dhe në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë të ngrejë një grup pune për të verifikuar dokumentacionin në dosjet e përfituesve të granteve të rikonstruksionit DS1/DS2/DS3 dhe përfituesve të bonusit të qirasë si dhe të bëhet plotësimi i këtyre dosjeve kur është e mundur.

Menjeherë

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sisternimit kontabël e gjendjes së llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në fund të vitit 2021 të paraqitur gabim, duke përfshirë në mënyrë të saktë vlerat e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit dhe në rakordim me gjendjen në llog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri më 31.12.2023

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për llogaritjen e amortizimit të aktiveve jo materiale dhe kryerjen e veprimeve kontabël të sisternimit për shpërndarjen e vlerës të studimeve-projektive, sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe duke debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plote.

Deri më 31.12.2023

9.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese, Bashkia Krujë të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialistë të fushës dhe të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të

llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione”. Për aktivet “Ndërtesa e konstruksione NJA Thumanë” në vlerën 104,595,727 lekë dhe për aktivet “Ndërtime para vitit 2001 NjA Fushë Krujë” në vlerën 27,146,269 lekë nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zberthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-komuna Thumanë dhe ish-Bashkia Fushë Krujë për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite dhe për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilanc e në rast pasaktësish të behën sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më 31.12.2023

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktiveve sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Deri më 31.12.2023

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të marrë masa që në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 të kryejë veprimet kontabël përkatëse për pasqyrimin në PF të investimeve në vlerën 4,000,000 lekë të kryera në vitet e mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në Sha “Klubi Sportiv K.” për vlerën 500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 25% të aksioneve dhe Sha “I. (Klubi i Futbollit Fushë- Krujë)” për vlerën 3,500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve.

Deri më 31.12.2023

12.1. Rekomandimi: Në të ardhmen mbikëqyrësi i zbatimit të kontratës të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë për detyrimet që ka OE si dhe pasqyrimin me përpikmëri të përmbushjes së përcaktimeve të kontratës në çdo element të saj, pa anashkaluar ato detyrime që duken të një rëndësie më të ulët.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE “D.” ShPK dhe “F.” ShPK për moszbatimin e kushteve të kontratave të pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.

Menjëherë

14.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE “R.” dhe “L.” për mos përmbushjen e kushteve të kontratës së pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.

Menjëherë

C. MASA PER ULJEN E BORXHIT TATIMOR PER TE RRITUR PERFORMANCEN NE ARKETIMIN E DETYRIMEVE PER TATIM TAKSAT VENDORE, PERFSHIRE DHE DETYRIMET NGA QIRADHENIA (TE ARDHURA TE MUNGUARA).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 614,535,969 lekë nga taksapaguesit privat dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhrat përkates për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitore. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgoje listën e subjekteve debitore të plote dhe të sakte pranë Drejtorisë së Financës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitetet të pa pajisur me autorizimin përkates të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 7,166,460 lekë ndaj Bashkisë Krujë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit

Me shkresën datë 24.04.2023, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 391 prot., datë 24.04.2023, z. S.M., ka paraqitur kërkesë për zbatimin e Vendimit nr. 42, datë 27.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, ku ka fituar të drejtën e pagës nga data 01.03.2017, kur është larguar nga puna, deri në rikthimin në detyrë.

Shkurtimisht ankesa e paraqitur nga z. S.M. ka këtë përmbajtje:

- Kam filluar punë në Bashkinë Krujë më datë 01.06.1995 në Sektorin e financë/tatim taksa dhe më pas në Sektorin e Prokurimeve Publike. Më datën 28.09.2015 jam transferuar në Njësinë Administrative Cudhi, (pjesë e Bashkisë Krujë) në detyrën inspektor financë/tatime. Në këtë detyrë kam punuar deri më datën 01.03.2016, dhe më datë 31.03.2016 jam larguar përfundimisht nga puna sipas vendimit nr. 6 dt. 01.03.2016 “Për lirimin nga Shërbimi Civil”, të nxjerrë nga Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe si pasojë kam ndërprerë marrëdhëniet financiare me Bashkinë Krujë.
- Këtë vendim e kam kundërshtuar fillimisht në rrugë administrative dhe pasi nuk mora përgjigje i jam drejtuar Gjykatës me padi duke kërkuar konstatimin e pavlefshëm të këtij vendimi.
- Përfundimisht, me Vendimin nr. 42 dt. 27.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, kam fituar rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës dhe në pamundësi në një pozicion tjetër të barazvlefshëm të shërbimit civil. Gjithashtu, kam fituar detyrimin e Bashkisë Krujë për të më paguar pagat nga data 01.03.2017 deri më datën 01.09.2021 (datë kur jam thirrur për të filluar punë nga Drejtori i Burimeve Njerëzore të Bashkisë Krujë).
- Bashkia Krujë, deri tani, ka zbatuar vetëm pikën 4 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, që ka lidhje me rikthimin tim në punë, ndërsa pikën 5 të këtij vendimi, e cila ka lidhje me pagesën e pagave deri në rikthimin në punë, akoma nuk e ka zbatuar.

Gjatë punës së auditimit, personelit përgjegjës të Bashkisë Krujë iu bë prezent problemi dhe grupi i auditimit të KLSH-së u njoftua zyrtarisht nga Kryetari i Bashkisë Krujë, me shkresën nr. 3864 prot., datë 02.05.2023, nëpërmjet së cilës u informuam se:

- Me shkresën nr. 4167 prot., datë 07.7.2022 “Mbi pagesën e detyrimeve sipas VGJAA nr. 42, datë 27.01.2021”, është përlllogaritur shuma e detyrimit për z. S.M. për periudhën nga data 01.03.2017 deri me datën 31.08.2021, ku janë përfshirë 54 paga mujore në shumën 2,494,800 lekë dhe shpenzime përmbartimore në shumën 199,584 lekë, me vlerën totale të detyrimit 2,694,384 lekë, shkresë e cila është depozituar në Drejtorinë e Financës së Bashkisë Krujë si kërkesë buxhetore për likuidim.
- Deri më tani nuk ka filluar likuidimi i detyrimit të mësipërm për mungesë të burimeve financiare si pasojë e Vendimeve të formës së prerë të viteve të mëparshme të parashikuara si detyrim buxhetor, dhe të situatës së krijuar për shkak të rindërtimit pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019.
- Nga ana jonë është në proces sigurimi i burimeve financiare për fillimin e likuidimit të njohur nga Bashkia për z. S.M..

Konkluzion: Nga auditimi, u konstatua se ky detyrim i Bashkisë Krujë nuk është kontabilizuar dhe nuk ka filluar të bëhet pagesa ndaj z. S.M..

Përsa i përket detyrimit që ka bashkia Krujë ndaj z. S.M., duhet të kryhet menjëherë kontabilizimi i këtij detyrimi dhe të fillojë menjëherë shlyerja e plotë e detyrimit, sipas mundësive financiare të Bashkisë Krujë.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kërkesës së z. S.M., datë 24.04.2023, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 391 prot., datë 24.04.2023, për zbatimin e Vendimit nr. 42, datë 27.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, ku ka fituar të drejtën e pagës nga data 01.03.2017, kur është larguar nga puna, deri në rikthimin në detyrë, u konstatua se ky detyrim i Bashkisë Krujë nuk është contabilizuar dhe nuk ka filluar të bëhet pagesa.

1. Z. S.M. ka bashkëlidhur ankesës kopje të Vendimit të Gjykatës Administrative, i cili është i formës së prerë;
2. Nga Bashkia Krujë është pranuar njohja me Vendimin nr. 42 datë 27.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe është argumentuar mosfillimi i pagesës.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.8., faqe 139-141.

Rekomandimi: Nga Bashkia Krujë të contabilizohet detyrimi ndaj z. S.M., si dhe të fillojë menjëherë shlyerja e plotë e detyrimit, sipas mundësive financiare të Bashkisë Krujë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: 1. Në Bashkinë Krujë nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.

2. Kordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është caktuar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve”, pika 1.2.

3. Për vitin 2022 Bashkia Krujë nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3 “Aktivitetet e Kontrollit”.

4. Bashkia Krujë nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 12-23 të Projekt Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Krujë të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së auditimit, për hartimin e programeve të trajnimit zhvillimit profesional të stafit dhe një procedure për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizimin e tyre.

1.2. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Krujë të merren masa për të caktuar Nënpunësin Zbatues si Koordinator të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë të Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Krujë, për vitin 2022, u konstatua se:

1. Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.2 “Plani vjetor i Auditimit”, që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Plani vjetor duhet përgatitur duke marrë në konsideratë Manualin e Auditimit të

Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016 Kap III, Formati Standard nr. 5, “*Hartimi i planit strategjik dhe vjetor të NjAB*”.

2. Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.1 “*Planifikimi strategjik*” që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Planifikimi strategjik duhet të kryhet duhet përgatitur duke marrë në konsideratë Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016 Kap III, Formati Standard nr. 5, “*Hartimi i planit strategjik dhe vjetor të NjAB*”.

3. Rekrutimi i punonjësve është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, neni 11, pika 2, shkronjat “b” dhe “c”.

Struktura e NJAB funksionon me 3 punonjës konkretisht:

Znj. S.S. me detyrë përgjegjëse e NJAB; Znj. S.D. me detyrë specialiste e NJAB dhe Znj. D.P. me detyrë specialiste e NJAB, nuk janë të certifikuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, neni 11, pika 2, shkronja “c”.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 12-23 të Projekt Raportit të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga NJAB të merren masa që Plani Vjetor dhe Plani Strategjik për vitin 2023 të jenë në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016, Kapitulli III, Formatit Standard nr. 5, “*Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NjAB*”.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa që 3 punonjësit në NjAB të kryejnë çertifikimin si Auditues të Brendshëm, në mënyrë që struktura e NjAB të funksionoj në mënyrë efektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Krujë nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik. Ky veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024*”, kreu I, pika 13.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 23-36 të Projekt Raportit të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa të publikojë në faqen zyrtare Projekt Buxhetin Afatmesëm 2022-2024 sipas kërkesës së Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024*”.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 3,779,616 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 2,374,876 mijë lekë, ose në masën 63%. Vlera e mosrealizimit në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë, tregon se planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysht përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale;

Nga ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2022, rezulton:

- Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor;
- Kryetari i Bashkisë Krujë për vitin 2022.uk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njesisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 47, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë

30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore” shtojca 4, pika c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 23-36 të Projekt Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda afateve, të dokumentoj se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE, rakordohet me degën e thesarit për vlerën 17,602,310 lekë, por nuk përputhet me vlerën e në dokumentet analitike që bashkia disponon nuk rakordon as në total as sipas zërave specifik dhe rezulton që detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 të jenë në vlerën 31,581,206 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 23-36 të Projekt Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 rezultojnë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore në vlerë 652,160 lekë, si dhe Bashkia Krujë në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, ky veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” neni 40, pika 3 dhe Udhëzimin e MFE nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesari”, pika 5 dhe pika 8.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 23-36 të Projekt Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë, Drejtoria e Financës dhe Sektori i Buxhetit të hartojë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojë me rigorozitet radhën e regjistrimit të tyre në bashki kur të kryejë likuidimet e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë ka lidhur:

- 24 akt marrëveshje për vitin 2022 për të ndihmuar subjektet debitore në likuidimin e detyrimeve me këste për vitin 2022, 19 subjekte dhe familje debitore i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes dhe nuk i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes 5 prej tyre.

- Si dhe akt marrëveshje të lidhura në vitin 2021 me afat deri në vitin 2022.g.a të cilat 10 subjekte dhe familje debitorë prej këtyre akt marrëveshjeve nuk i kanë zbatuar kushtet e kontratës.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe i akt marrëveshjeve për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se ka mangësi nga ana e DTTV në lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste, përkatësisht;

- Në dy rast rezulton se, afati i aktmarrëveshjes është lidhur për një periudhë prej 24 mujore por afati nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës, pas momentit të hartimit të marrëveshjes;

Nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 2, 3, 4, 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 23-36 të Projekt Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë, gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë, të marrë masat që këto akt marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtare si dhe të plotësojë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se:

1. Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 22,672,572 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 31,836,370 lekë, me një rritje në vlerën 9,163,798 lekë. Nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se automjetet në vlerën 61,161,138 lekë, sipas Aneksit PF17 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, nuk janë mjete transporti, por makineri, të cilat duhet të regjistrohen në llogarinë përkatëse, 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”. Rrjedhimisht, llogaritë 215 “Mjete transporti” dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, nuk paraqesin vlerën reale në bilanc.

2. Nga auditimi dhe testimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, u konstatua se në regjistrat/librat e kontabilitetit të këtyre llogarive, për një pjesë të konsiderueshme të zërave nuk është pasqyruar vlera fillestare e aktiveve, por vetëm vlera e shpenzimeve të mëpasshme, për rikonstruksione ose përmirësimin e gjendjes së këtyre aktiveve. Kryesisht, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtyre AAM nuk është pajisur me titull pronësie dhe ende nuk janë në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Gjithashtu, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, etj. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Për llogaritë 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, nga Bashkia Krujë nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike. Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së aseteve. Nga ana e Drejtorisë së Financës disponohet informacion vetëm për shtesat vjetore të llogarive 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215. Fakti që nuk ka një regjistër kontabël për të gjitha AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, pika 30; UMFE nr. 8,

datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1, Pika 2, Klasa 2; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, etj.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 54-75 të Projekt Raportit të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

8.2. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, si dhe saktësimin e asetëve të inventarizuara, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë vlera fillestare dhe kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës, sipas rastit.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Krujë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si:

- Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë “I. SH.A.”, me NUIS L.....M e cila është shoqëri aksionare me objekt “Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit, etj.”. Numri i aksioneve është 2,000 me vlerë nominale 1,750 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **3,500,000 lekë**.

- Aksionare me 3,45% të aksioneve të shoqërisë “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SH.A.”, me NUIS M.....M e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij, etj.”. Numri i aksioneve është 100,000 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 10,000,000 lekë. Pjesa takuese e Bashkisë Krujë është 3,448 aksione, në vlerën totale **344,800 lekë**.

- Aksionare me 25% të aksioneve të shoqërisë “Klubi Sportiv K. SH.A.”, me NUIS L....V e cila është shoqëri aksionare me objekt “Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit, etj.”. Numri i aksioneve është 2,000 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 2,000,000 lekë. Pjesa takuese e Bashkisë Krujë është 500 aksione, në vlerën totale **500,000 lekë**.

- Aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Krujë SH.A.”, me NUIS J.....J e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij, etj.”. Numri i aksioneve është 1 me vlerë nominale 193,703,532 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **193,703,532 lekë**.

Këto vlera nuk janë paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2022, konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”.

Për sa më sipër, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” nuk paraqet vlerën reale për shumën **198,048,332 lekë** (3,500,000 lekë nga shoqëria “I. SH.A.”; 344,800 lekë nga shoqëria “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SH.A.”, 500,000 lekë nga shoqëria “Klubi Sportiv K.SH.A.” dhe 193,703,532 lekë nga shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Krujë SH.A.”, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”, me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivët afatgjata jo materiale” pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 54-75 të Projekt Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Krujë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të regjistruar dhe sistemuar në kontabilitet, në aktivët afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2023, konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, për vlerën totale 198,048,332 lekë shoqëritë:

1. “I. SH.A.”, me NUIS L.....M, për 100% të aksioneve, gjithsej 2,000 aksione, me vlerë nominale 1,750 lekë/aksion, me vlerë totale 3,500,000 lekë;
2. “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SH.A.”, me NUIS M.....M, për 3.45% të aksioneve, gjithsej 3,448 aksione, me vlerë nominale 100 lekë/aksion, me vlerë përkatëse 344,800 lekë;
3. “Klubi Sportiv K.... SH.A.”, me NUIS L.....V, për 25% të aksioneve, gjithsej 500 aksione, me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, me vlerë përkatëse 500,000 lekë.
4. “Ujësjellës Kanalizime Krujë SH.A.”, me NUIS J.....J, për 100% të aksioneve, gjithsej 1 aksion, me vlerë nominale 193,703,532 lekë/aksion me vlerë totale 193,703,532 lekë.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2022 paraqitet përkatësisht 0 lekë për llog. 230 dhe 1,542,248,174 lekë për llog. 231, në total 1,542,248,174 lekë.

Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2022 ka qenë 1,081,941,366 lekë, nga të cilat 741,265,068 lekë me fonde të deleguara dhe 340,676,298 lekë nga të ardhurat e veta. Vlera e kontraktuar (me Tvsh), për investimet në proces gjatë vitit 2022 ka qenë 991,766,258 lekë, nga të cilat 734,813,881 lekë me fonde të deleguara dhe 256,952,377 lekë nga të ardhurat e veta. Planifikimi total për vitin 2022 ka qenë 1,130,166,929 lekë, nga i cili 762,623,413 lekë me fonde të deleguara, me realizim në vlerën 732,291,956 lekë dhe 367,543,516 lekë nga të ardhurat e veta, me realizim në vlerën 179,765,285 lekë.

Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2022.uk paraqet vlerën reale, e cila duhet të përmbante shumën e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Krujë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, “Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël)”, “Aktive afatgjata materiale”, etj.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 54-75 të Projekt Raportit të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës në Bashkinë Krujë, të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

11. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 44,656,180 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 79,488,357 lekë ose me rritje në vlerën 34,832,177 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Në mënyrë analitike, Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në fund të vitit 2022 është paraqitur në Aneksin PF28, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 54-75 të Projekt Raportit të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

12. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, janë planifikuar investime të reja në buxhet në vlerën 234,590,210 dhe investime nga vitet e mëparshme në vlerën 105,704,476 lekë. Gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 94,838,015 lekë nga investimet e mbartura dhe vlera 65,101,398 lekë nga investimet e vitit. Në total janë likuiduar 159,939,413 lekë.

Me fonde Buxhetore kanë qenë gjithsej 3 objekte, në vlerën totale 103,699,945 lekë të likuiduar gjatë vitit 2022. Nga fondet e rindertimit janë 5 objekte, në vlerën totale të likuiduar 615,692,179 lekë.

Për vitin 2022 janë lidhur 87 kontrata, në vlerën totale 991,766,258 lekë për blerje aktiveve materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR, etj.

Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2022 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”. Kontratat e lidhura për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin PF39, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 32.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 54-75 të Projekt Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.

Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Me kapitalizmin e aktivitetit, (për aktivitetin e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

13. Gjetje nga auditimi: 1. Nga auditimi i 18 procedurave të prokurimit publik për vitin 2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 16 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat janë devijime nga përcaktimi në legjislacionin për prokurimin publik ose nuk janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76, pika 2, neni 77, pika 4, neni 82, pika 2 dhe pika 5, germa a), neni 89, pika 1, neni 92, pika 3, neni 98, pika 1, germa a) dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pikat 1 dhe 3, neni 74, pika 3, germa gj), neni 79, pika 3 dhe neni 82, pika 2.

2. Në të gjitha rastet e audituara, u konstatua se një pjesë e procesverbaleve dhe Dokumentet e Tenderit nuk janë protokolluar në protokollin e Bashkisë Krujë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-123 të Projekt Raportit të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e

kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

13.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Krujë dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 18 procedurave të prokurimit publik për vitin 2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 3 raste u konstatua se OE të shpallur fitues kanë pasur devijime të vogla nga kriteret e përcaktuara në DT, devijime të cilat nuk janë listuar në Raportet Përmbledhëse përkatëse dhe në 8 raste u konstatua se OE janë shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në DT, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76, pika 2, neni 77, pika 4, neni 82, pika 2 dhe pika 5, germa a), neni 89, pika 1, neni 92, pika 3, neni 98, pika 1, germa a) dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pikat 1 dhe 3, neni 74, pika 3, germa gj), neni 79, pika 3 dhe neni 82, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-123 të Projekt Raportit të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: 1. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 4159 prot., datë 06.07.2022, me objekt “Shërbim i pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane për qytetin Fushë Krujë”, të lidhur me OE R. SHPK, u konstatua se:

- **Raportimet:** Kontraktori nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi, në mospërputhje me kontratën, neni 13, pika 1 dhe pika 2.

- **Edukimi ambiental:** Kontraktori nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik, të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike, si dhe nuk ka kryer programin e edukimit ambiental nëpërmjet një spoti televiziv një herë në 6 muaj, në mospërputhje me kontratën, neni 18, pika 1 dhe pika 2. Në kushtet e mosrealizimit të programeve të edukimit publik dhe ambiental, nga mbikëqyrësi nuk janë aplikuar penaltetet ndaj kontraktorit, në mospërputhje me kontratën, neni 28.

- **Moskryerja e zërit të punimeve:** Sipas procesverbalit të datës 31.08.2022, të mbajtur nga grupi për monitorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit për qytetin e Fushë-Krujës, është konstatuar moskryerja e zërit të punimeve “grumbullim e ngarkim në mjet mbetje inerte barishte dhe transport mbetje inerte, barishte, materiale të ngurta”. Sasia e planifikuar e këtyre mbetjeve është në sasinë 91.25 ton, Këto veprime janë në mospërputhje me kontratën, neni 10, pika 1.

- **Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit:** Grupi i punës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratës së pastrimit në qytetin e Fushë-Krujës, si dhe OE mbikëqyrës, nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratë, neni 22, pikat 2, 5 dhe 6.

2. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 2208 Prot., datë 15.04.2022, me objekt “Shërbim i pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane për qytetin Krujë”, të lidhur me BOE D. SHPK & S. SHPK,

- **Raportimet:** Kontraktori nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi në mospërputhje me kontratën, neni 13, pika 1 dhe pika 2.

- **Edukimi ambiental:** Kontraktori nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike, si dhe nuk ka kryer as programin e edukimit ambiental, i cili duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj, në mospërputhje me kontratën, neni 18, pikat 1 dhe 2.

- **Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit:** Grupi i punës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratës së pastrimit në qytetin e Krujës, si dhe OE mbikëqyrës, nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratë, neni 28, germa f.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-123 të Projekt Raportit të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Grupet e punës të ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave të pastrimit dhe OE mbikëqyrës, të marrin masa për rritjen e kërkesës së llogarisë për detyrimet që kanë OE sipërmarrës, në lidhje me pasqyrimin me përpikëri të përmbushjes së specifikimeve të kontratës në të gjitha elementet, pa përjashtim.

15.2. Rekomandimi: Grupet e punës të ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave të pastrimit dhe OE mbikëqyrës, të marrin masa për mbikëqyrjen ditore të shërbimit të pastrimit duke pasqyruar në akt kontrollet përkatëse të gjithë elementet e kontratës, si dhe të japin vlerësimet përkatëse për përmbushjen e metodologjive të aplikuara si dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.

15.3. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa duke aplikuar gjobat përkatëse në raport me llojin e detyrimeve kontraktuale të papërmbushura nga OE R. SHPK për qytetin Fushë Krujë dhe BOE D. SHPK & S. SHPK për qytetin Krujë.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve për kontratat:

- “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”,

- “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”,

- “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”,

rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë, nuk ka kryer oponentin teknike për investimet për objektet e mësipërme. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, “Ndërtimet publike” germa (a).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-123 të Projekt Raportit të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Oponentë Teknike për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve për kontratat:

- “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”,

- “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”,

- “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroi i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”,

rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë, nuk ka dhënë Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-123 të Projekt Raportit të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Leje Ndërtimore Infrastrukturore për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve për kontratat:
- “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”,

- “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”,

- “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”,

rezultoi se Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë, nuk ka dhënë Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-123 të Projekt Raportit të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për pajisjen me Leje Ndërtimore Infrastrukturore për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjisllacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit si më poshtë, u konstatua se, janë lëshuar në mungesë të dokumenteve, pasi nuk është kryer bashkërendimi me institucionet, për lejet e mëposhtme:

1. “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, me nr. 8319 prot., datë 06.12.2021, e cila është miratuar me Vendimin nr. 1, datë 07.01.2022 për “Hotel 4 Kat + podrum”,

- Vërtetim nga Instituti i Ndërtimit,

- Vërtetim nga Instituti Sizmologjik,

- Në mungesë të Oponencës Teknike,

- Në mungesë të preventivit të detajuar në mënyrë të saktë,

- Vërtetim që subjekti ndërtues “P.” SHPK ka shlyer taksat dhe tarifat vendore,

- Vërtetim që subjekti ndërtues “P.” SHPK nuk ka detyrime të papaguara,

- Vërtetim që zhvilluesi z. Xh.Rr. nuk ka detyrime të papaguara,

2. “Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, me nr. 3875 prot., datë 26.06.2022, e cila është miratuar me Vendimin nr. 265/1, datë 22.09.2022, për “Strukturë 1-2 kat, për magazinim dhe tregtim të bojërave plastike”:

- Vërtetim nga Instituti i Ndërtimit,

- Vërtetim nga Instituti Sizmologjik,

- Në mungesë të Oponenca Teknike,

- Vërtetim që subjekti ndërtues “K.D.” SHPK ka shlyer taksat dhe tarifat vendore,

- Vërtetim që subjekti ndërtues “K.D.” SHPK nuk ka detyrime të papaguara

- Vërtetim që zhvilluesi bashkëpronarët S.nuk ka detyrime të papaguara.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 115-119 të Projekt Raportit të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrin masa për miratimin e Lejeve të Ndërtimit për projektet e zbatimit për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin teniko-ligjor, sipas legjisllacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes për vitin 2022, rezultoi se nga IMTV, për këto 35 Procesverbale për konstatimin e kundërvajtjes nuk është zbatuar kuadri ligjor, përkatësisht për:

1. Procesverbal nr. 120, datë 14.02.2022, subjekti “K.K.” për kundërvajtjen “Brez betoni në afërsi të banesës së shtëpisë” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
2. Procesverbal nr. 125, datë 18.03.2022, subjekti “E.S.” për kundërvajtjen “Platformë me strukturë druri” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
3. Procesverbal nr. 126, datë 22.03.2022, subjekti “I.T.” për kundërvajtjen “Hapje kanali me efekt shtrirje rrjeti interneti” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
4. Procesverbal nr. 127, datë 23.03.2022, subjekti “M.M.” për kundërvajtjen “Rrethim me shufra betoni dhe rrjet teli” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
5. Procesverbal nr. 128, datë 23.03.2022, subjekti “Gj.N.” për kundërvajtjen “Shtyllë Druri në pjesën e rrugës së fshatit” nuk është marrë asnjë masë tjetër;
6. Procesverbal nr. 135, datë 15.08.2022, për kundërvajtjen “Konstruksion metalik me panele sanduiç”, është marrë masa prishje objekti me nr. 81, datë 25.08.2022 dhe nuk është marrë masë për gjobë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 127-130 të Projekt Raportit të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: IMTV të vlerësojë me saktësi kundërvajtjet e konstatuara gjatë kontrolleve në terren dhe të sigurohet që në vazhdimësi të aplikojë masën e duhur të gjobës në përputhje me llojin e kundërvajtjes së identifikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për periudhën në auditim nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë nga gjobat e vendosura nga IMTV. Për gjobat e vendosura në vitin 2022, të cilat nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV ka njoftuar subjektet kundërvajtës me shkresat përkatëse, por nuk ka bërë kërkesë për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, për 12 masa për gjobë, përkatësisht me nr. 64, datë 21.01.2022, nr. 81, datë 06.07.2022, nr. 85, datë 28.07.2022, nr. 86, datë 10.10.2022, nr. 88, datë 07.11.2022, nr. 90, datë 14.11.2022, nr. 92, datë 14.11.2022, nr. 94, datë 28.11.2022, nr. 95, datë 28.11.2022, nr. , datë 25.11.2022, nr. 97, datë 25.11.2022 dhe nr. 98, datë 05.12.2022. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30 pika 1 pika 3 dhe pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 127-130 të Projekt Raportit të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave dhe nxjerrjen e titujve ekzekutiv për gjobat e vendosura.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara.

Bashkia Krujë ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:

a. Janë lënë 25 Rekomandime për “Masa Organizative”, të cilat janë pranuar nga subjekti, për të cilat rikërkohet zbatimi për 2 masa të zbatuara pjesërisht, për 1 masë në proces zbatimi dhe për 12 masa të cilat nuk janë zbatuar;

b. Janë lënë 4 rekomandime në vlerën totale 957,860 lekë për “Masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara”, të cilat janë pranuar nga subjekti dhe mbeten për t’u zbatuar, pasi deri tani janë zbatuar 2 masa, në vlerën 674,856 lekë dhe janë në proces zbatimi 2 masa, në vlerën 283,004 lekë.

c. Janë lënë 5 Rekomandime për “Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia”, për të cilat rikërkohet zbatimi për 1 masë të pazbatuar, 2 masa në proces zbatimi, 1 masë e zbatuar pjesërisht.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 130-139 të Projekt Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 259/7 Prot, datë 27.07.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e masave të pazbatuara dhe ato pjesërisht të zbatuara gjithashtu të përshpejtojë zbatimin e masave në proces si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat në mënyrë që, temat më problematike që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik dhe të dokumentohen takimet e realizuara nga GMS dhe vendimet e marra për diskutimet përkatëse.

Brenda vitit 2023

2.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa që në pozicionin e specialistit të NjAB, të punësohet një person që përmbush kriteret për të qenë pjesë e kësaj strukture dhe mundëson funksionimin e auditit të brendshëm në mënyrë efektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucione të tjera vendore përkatëse me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të marrë masat të ngrejë një grup pune për të identifikuar të gjithë familjet që duhet të paguajnë detyrimet e bashkisë lidhur me taksat dhe tarifatat familjare.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë gjatë hartimit të akt-marrëveshjeve me subjektet debitore të marrë masat që këto akt- marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtarë si dhe të plotësojë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimeve me këste.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Krujë të ngrejë një grup pune për të verifikuar dokumentacionin në dosjet e përfituesve të granteve të rikonstruksionit DS1/DS2/DS3 dhe përfituesve të bonusit të qirasë si dhe të bëhet plotësimi i këtyre dosjeve kur është e mundur.

Menjëherë

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sisternimit kontabël e gjendjes së llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në fund të vitit 2021 të paraqitur gabim, duke përfshirë në mënyrë të saktë vlerat e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit dhe në

rakordim me gjendjen në llog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri më 31.12.2023

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për llogaritjen e amortizimit të aktiveve jo materiale dhe kryerjen e veprimeve kontabël të sistemimit për shpërndarjen e vlerës të studimeve-projektiveve, sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiviteti afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe duke debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plote.

Deri më 31.12.2023

9.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese, Bashkia Krujë të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialistë të fushës dhe të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksiione”. Për aktivet “Ndërtesa e konstruksiione NJA Thumanë” në vlerën 104,595,727 lekë dhe për aktivet “Ndërtime para vitit 2001 NjA Fushë Krujë” në vlerën 27,146,269 lekë nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-komuna Thumanë dhe ish-Bashkia Fushë Krujë për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite dhe për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilanc e në rast pasaktësish të behën sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më 31.12.2023

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Deri më 31.12.2023

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të marrë masa që në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 të kryejë veprimet kontabël përkatëse për pasqyrimin në PF të investimeve në vlerën 4,000,000 lekë të kryera në vitet e mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në Sha “Klubi Sportiv K.” për vlerën 500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 25% të aksioneve dhe Sha “I. (Klubi i Futbollit Fushë- Krujë)” për vlerën 3,500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve.

Deri më 31.12.2023

12.1. Rekomandimi: Në të ardhmen mbikëqyrësi i zbatimit të kontratës të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogaritë për detyrimet që ka OE si dhe pasqyrimin me përpikmëri të përmbushjes së përcaktimeve të kontratës në çdo element të saj, pa anashkaluar ato detyrime që duken të një rëndësie më të ulët.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE “D.” ShPK dhe “F.” ShPK për moszbatimin e kushteve të kontratave të pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.

Menjëherë

14.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE “R.” dhe “L.” për mos përmbushjen e kushteve të kontratës së pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.

Menjëherë

C. MASA PER ULJEN E BORXHIT TATIMOR PER TE RRRITUR PERFORMANCEN NE ARKETIMIN E DETYRIMEVE PER TATIM TAKSAT VENDORE, PERFSHIRE DHE DETYRIMET NGA QIRADHENIA (TE ARDHURA TE MUNGUARA).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 614,535,969 lekë nga taksapaguesit privat dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatës për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitore. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgoje listën e subjekteve debitore të plote dhe të sakte pranë Drejtorisë së Financës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 7,166,460 lekë ndaj Bashkisë Krujë.

Menjëherë dhe në vijimësi

23 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kërkesës së z. S.M., datë 24.04.2023, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 391 prot., datë 24.04.2023, për zbatimin e Vendimit nr. 42, datë 27.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, ku ka fituar të drejtën e pagës nga data 01.03.2017, kur është larguar nga puna, deri në rikthimin në detyrë, u konstatua se ky detyrim i Bashkisë Krujë nuk është kontabilizuar dhe nuk ka filluar të bëhet pagesa.

3. Z. S.M. ka bashkëlidhur ankesës kopje të Vendimit të Gjykatës Administrative, i cili është i formës së prerë;

4. Nga Bashkia Krujë është pranuar njohja me Vendimin nr. 42 datë 27.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe është argumentuar mosfillimi i pagesës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8., faqe 139-140 të Projekt Raportit të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Krujë të kontabilizohet menjëherë detyrimi ndaj z. S.M., si dhe të fillojë shlyerja e plotë e detyrimit.

Brenda datës 01.10.2023

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronjat b dhe c, Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të Bashkisë Krujë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **607,090 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”, me vlerë 16,638,481.20 lekë me TVSH, fituar nga OE “S.U.” SHPK, rezultuan punë të pakryera për zërin e punimeve: “Zëri 7. Shtresë stabilizanti (banikë) t=10cm”, në vlerën **147,330 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2044 prot., datë 21.09.2022 të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe OE “S.U.” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-123 të Projekt Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të arkëtojë vlerën prej **147,330 lekë pa TVSh** nga shoqëria OE “S.U.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 2044 prot., datë 21.09.2022, me objekt “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Vlash Dobrozi”, “Dashamiri” dhe “Hekurudha” NjA Thumanë, Krujë”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”, me vlerë 11,201,052 lekë me TVSh, fituar nga BOE “K.D.” ShPK & “V.” ShPK, rezultuan punë të pakryera për zërat e punimeve: “Gërmim dheu kanal, ekskavator me zinxhir, dhe shkarkim në mjet”; “Transport dheu në distancë 1 km”; “Shtresë stabilizanti (banikë), t=10cm”; “Shtresë binderi, t=5 cm, gur zalli makineri”; “Shtresë asfaltobetoni, t=4 cm, gur zalli makineri”, në vlerën **154,320 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6115 prot., datë 21.09.2022 të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe BOE “K.D.” ShPK & “V.” ShPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-123 të Projekt Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të arkëtojë vlerën prej **154,320 lekë pa TVSh** nga BOE “K.D.” SHPK & “V.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës nr. 6115 prot., datë 21.09.2022, me objekt “Sistemim-Asfaltim i rrugës së lagjes së “Bakallëve” NjA Bubq, Krujë”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”, me vlerë 21,122,391.52 lekë me TVSH, fituar nga OE “B.” SHPK, rezultuan punë të pakryera për zërat e punimeve: “Mbushje me çakëll makinerie, me makineri”, në vlerën **154,320 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 6145 prot., datë 21.09.2022, të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe OE “B.” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 57-123 të Projekt Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Bashkia Krujë të arkëtojë vlerën prej **154,320 lekë pa TVSh** nga shoqëria OE “B.” ShPK, për punime të pakryera, sipas kontratës Nr. 6145 prot., datë 21.09.2022, me objekt “Sistemim-Asfaltim i rrugës Kroj i Bardhë-Kurcaj, NjA Nikël, Krujë”.

Menjëherë

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga pagesat që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se, për vitin 2022.uk ka debitorë por detyrimet e viteve të mëparshme janë në vlerë 63,700,015 dhe në vitin 2022 është paguar vlera 110,210 lekë, vlera e mbetur vazhdon të jetë detyrim që përbën në total 63,589,805 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë. Ky veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 32, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; Ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 32, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c; Ligji nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 32, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5, dhe VKB përkatëse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 23-36 të Projekt Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **63,589,805 lekë**. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Krujë të bashkëpunojnë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë IMTV-ja në Bashkinë Krujë u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 35 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Nga këto nuk kanë paguar disa subjekte vullnetarisht me vlerë totale të gjobave të vendosura për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 është 7,450,000 lekë. Pra për vitin 2022 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 7,450,000 lekë, ky veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30 pika 1 pika 3 dhe pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 23-36 të Projekt Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: IMTV dhe Drejtoria e të Ardhurave në Bashkisë Krujë të ndjekin të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **7,450,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Rezulton se nga Bashkia Krujë në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve (bizneseve) është në vlerën 83,003,806 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 613,515,626 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerë 63,589,805 lekë, debitorët familjarë janë në vlerë 109,356,149 lekë, duke rezultuar në total me vlerën e borxhit tatimor 786,461,580 lekë. Gjithashtu, Bashkia Krujë nuk ka të dhëna për numrin e familjeve debitore për periudhën objekt auditimi si dhe nuk ka dokumente analitike ku të jenë paraqitur zërat sipas taksave dhe tarifave dhe numrit të familjeve për taksat dhe tarifatat familjare. Nga Bashkia Krujë pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2022, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 23-36 të Projekt Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **786,461,580 lekë** nga taksapaguesit privatë dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatës për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitorë.

3.2. Rekomandimi: Bashkia Krujë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të marrë masat për të ngritur një grup pune i cili të identifikojë të gjithë familjarët që paguajnë detyrimet e bashkisë lidhur me taksat dhe tarifatat familjare.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 28 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 37 pika karburanti), nga

të cilat 14 subjekte për 19 pika karburanti janë të autorizuar dhe kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore dhe për 18 pika karburanti janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale 3,341,364 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë, ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre””, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2, pika 11.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 23-36 të Projekt Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa që subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet të papajisur me autorizimin përkatës, të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën **3,341,364 lekë** ndaj Bashkisë Krujë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. J.P.
2. E.K.
3. K.H.
4. S.M.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

B.D.